



FËMIJËT JASHTË SHKOLLËS NË KOSOVË

*Hajrije Devetaku-Gojani
Selim Mehmeti*

*Studim bazë për praktikat e parandalimit
dhe të reagimit ndaj braktisjes dhe
mosregjistrimit në shkollë*

FËMIJËT JASHTË SHKOLLËS NË KOSOVË

*Hajrije Devetaku-Gojani
Selim Mehmeti*

*Studim bazë për praktikat e parandalimit
dhe të reagimit ndaj braktisjes dhe
mosregjistrimit në shkollë*



//Botues
Instituti Pedagogjik i Kosovës

//Kryeredaktor
Ismet Potera

//Redaktorë
Laetitia Antonowicz
Afërdita Spahiu

//Lektor
Arif Demolli

//Përgatitja teknike:
ASHA

// FALËNDERIMET

Falënderojmë UNICEF-in për mbështetjen e dhënë në realizimin e studimit. Në mënyrë të veçantë dëshirojmë të falënderojmë znj. Afërdita Spahiu, zyrtare për arsim në zyrën e UNICEF-it në Kosovë, për ofrimin e ekspertizës gjatë procesit të studimit dhe znj. Laetitia Antonowicz, konsulente rajonale e UNICEF-it për Iniciativën Fëmijët Jashtë Shkolle dhe Adoleshentët.

Falënderojmë bashkëpunëtorët profesionalë të MASHT-it, hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës dhe mësimdhënësit bashkëpunëtorë të përfshirë në studim për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar gjatë gjithë procesit të studimit.

Ky studim nuk do të mund të realizohej me sukses pa mirëkuptimin dhe përkrahjen e drejtorive komuna të arsimit, përfaqësuesve nga drejtoritë e tjera në komuna, drejtorëve të shkollave, mësimdhënësve, nxënësve dhe të prindërve. Më këtë rast, shprehim falënderim për të gjithë ata që e përkrahën dhe e mbështetën realizimin dhe përfundimin me sukses të këtij studimi.

// PËRMBAJTJA

| | |
|--|-----------|
| Shkurtesat | 10 |
| Përmbledhje ekzekutive | 11 |
| 1. Hyrje | 17 |
| 1.1. Arsyeja për studimin | 17 |
| 1.2. Metodologjia e studimit | 18 |
| 1.3. Çështjet etike | 21 |
| 1.4. Sfidat dhe kufizimet | 22 |
| 1.5. Përkufizimi i termave kryesorë | 22 |
| 1.6. Përmbledhje e shkurtër e raportit | 23 |
| 2. Shqyrtimi i literaturës | 25 |
| 2.1. Legjislacioni dhe korniza e politikës arsimore në Kosovë për gjithëpërfshirjen në arsim | 25 |
| 2.2. Treguesit statistikorë për përfshirjen e fëmijëve në arsimin bazë | 31 |
| 2.3. Studimet në Kosovë për braktisjen e shkollës | 34 |
| 3. Gjetjet në nivel komunal | 37 |
| 3.1. Praktikat e adresimit të fëmijëve jashtë shkolle, parandalimit e reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e detyruar | 37 |
| 3.2. Regjistrimi i fëmijëve në edukimin parashkollor (5-6 vjeç) dhe parafillor | 37 |
| 3.3. Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë | 38 |
| 3.4. Të dhënat e tjera arsimore | 40 |
| 3.5. Mekanizmat për identifikimin e fëmijëve jashtë shkollës | 42 |
| 3.6. Braktisja e shkollës – praktikat e adresimit në nivel komunal | 43 |
| 3.7. Mungesat e nxënësve – mbledhja e të dhënave | 44 |
| 3.8. Ekipi komunal për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes e mosregjistrimit | 45 |
| 3.9. Bashkëpunimi ndërsektorial dhe bashkëpunimi me OJQ-të | 46 |
| 4. Gjetjet në nivel shkolle | 53 |
| 4.1. Shkalla e kënaqësisë me punën e shkollës | 53 |
| 4.2. Mungesat e nxënësve në mësim | 56 |
| 4.3. Braktisja e shkollës | 59 |
| 4.4. Ekipi shkollor për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit | 62 |
| 4.5. Gjithëpërfshirja në arsim - praktikat e adresimit në nivel shkolle | 64 |
| 4.6. Vlerësimi i nevojave të shkollës për mbështetje/përkrahje në adresimin e fëmijëve jashtë shkollës | 67 |
| 5. Konkluzionet dhe rekomandimet | 71 |
| 5.1. Përkufizimet, rregulloret dhe mekanizmat e ndërhyrjes | 71 |
| 5.2. Përfshirja e fëmijëve në edukimin parafillor | 72 |
| 5.3. Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë | 72 |
| 5.4. Të dhënat për braktisjen e shkollës dhe mundësitë e identifikimit të fëmijëve jashtë shkolle | 73 |
| 5.5. Ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes e mosregjistrimit | 74 |
| 5.6. Bashkëpunimi ndërsektorial dhe bashkëpunimi me OJQ-të | 74 |
| 5.7. Gjithëpërfshirja në arsim | 75 |
| 5.8. Përfshirja e prindërve në shkollë | 76 |
| 5.9. Mbrojtja sociale | 77 |

| | |
|---|-----------|
| 6. Plani orientues për implementimin e rekomandimeve | 79 |
| 6.1. Themelimi dhe funksionalizimi i EPRBM-ve | 79 |
| 6.2. Identifikimi i fëmijëve jashtë shkolle | 79 |
| 6.3. Mekanizmat e ndërhyrjes për fëmijët jashtë shkolle dhe për parandalim e reagim ndaj ndërhyrjes | 80 |
| 6.4. Trajnimi i ekipeve shkollore për implementimin e standardeve të Shkollave Mike për Fëmijë | 80 |
| 6.5. Regjistrimi i fëmijëve në arsimin parafillor dhe fillor | 81 |
| 6.6. Rritja e qëndrimit ditor në shkollë | 81 |
| Referencat | 83 |
| Anekset | 87 |
| Aneksi 1: Rezultatet sipas komunave | 87 |
| Aneksi 2: Rezultatet krahasuese sipas komunave | 100 |
| Aneksi 3: Informacioni për shkollat pjesëmarrëse | 103 |
| Aneksi 4: Mostra e studimit në nivel komunal dhe në nivel shkolle | 105 |

// PËRMBAJTJA E TABELAVE

32

Tabela 1. Raporti i ndryshimit të numrit të nxënësve të gjeneratës së njëjtë që në vitin shkollor 2004/2005 ka qenë në klasën e parë, kurse në vitin shkollor 2012/2013 është në klasën e nëntë

33

Tabela 2. Raporti i ndryshimit të numrit të nxënësve të klasës së 9-të (2012/2013) me klasën e 2-të (2005/2006) dhe klasën e 6-të (2009/2010)

34

Tabela 3. Raporti i ndryshimit të numrit të nxënësve të klasave 3-9 të këtij viti shkollor (2012/2013) me numrin e nxënësve të këtyre gjeneratave të regjistruara në klasë e 2-të

38

Tabela 4. Përqindja e nxënësve të klasës së parë që në dy vitet e fundit janë regjistruar në edukimin parashkollor (5-6 vjeç)

41

Tabela 5. Përqindja e nxënësve të regjistruar në klasën e 10-të (2011/2012) në raport me numrin e nxënësve që kanë përfunduar klasën e 9-të (2012/2013)

41

Tabela 6. Mesatarja e arritshmërisë së nxënësve të komunave të përfshira në studim në testin e klasës së 9-të - viti shkollor 2011/2012

42

Tabela 7. Përqindja e kalueshmërisë dhe mesatarja e arritshmërisë në provimin e maturës 2012/2013 - e nxënësve të komunave të përfshira në studim

44

Tabela 8. Numri i nxënësve braktisës të klasës 1-9 (viti shkollor 2011/2012) në komunat e përfshira në studim

53

Tabela 9. Mesatarja e shkallës së kënaqësisë së prindërve, mësimitdhënësve dhe udhëheqësve të shkollës me rezultatet e punës në shkollë (shkalla më e lartë 5 pikë)

56

Tabela 10. Përgjigjeve të nxënësve sipas numrit për faktorët që kanë ndikuar negativisht në cilësinë e mësimitdhënies dhe nxënies

56

Tabela 11. Përgjigjet e nxënësve të anketuar sipas numrit, për atë se çka duhet të bëjë shkolla me prioritet në mënyrë që të përmirësohet cilësia e mësimitdhënies dhe nxënies

57

Tabela 12. Mesatarja e mungesave të nxënësve sipas shkollave në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2012/2013

60

Tabela 13. Të dhënat për braktisjen, të ofruara nga shkollat e përfshira në studim për vitet shkollore 2011/2012 dhe 2012/2013

61

Tabela 14. Përgjigjet e drejtorëve për mbështetjen e marrë nga DKA-të në parandalimin e braktisjes sipas drejtorëve të shkollave

62

Tabela 15. Nevojat e shkollave sipas drejtorëve të shkollave për të parandaluar braktisjen dhe për të përmirësuar përfshirjen e të gjithë fëmijëve në shkollë

62

Tabela 16. Lista e shkollave që kanë ofruar dëshmi për themelimin e EPRBM-ve

65

Tabela 17. Shpeshtësia e keqtrajtimit të nxënësve nga mësimdhënësit/mësuesit e tyre në kategorinë e viktimës, sipas nxënësve

67

Tabela 18. Vlerësimet e drejtorëve të shkollave dhe të mësimdhënësve për mbështetje/përkrahje në adresimin e fëmijëve jashtë shkollës, parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe gjithëpërfshirës në arsim

// PËRMBAJTJA E FIGURAVE

34

Figura 1. Raporti i përqindjes së nxënësve, të cilët sipas viteve të regjistrimit në klasën e dytë të vitit shkollor 2005/2006 nuk e kanë vazhduar shkollimin në vitet vijuese - deri në këtë vit shkollor (2012/2013)

58

Figura 2: Përgjigjet e drejtorëve për shpeshtësinë e analizës së raporteve të mungesave të nxënësve në mësim (%)

58

Figura 3: Përgjigjet e mësimdhënësve për shpeshtësinë e analizës së raporteve të mungesave të nxënësve në mësim %)

// PËRMBAJTJA E KUTIVE

59

Kutia 1. Përkufizimi i braktisjes sipas drejtorëve të shkollave

63

Kutia 2. Të kuptuarit e rolit të EPRBM-ve sipas drejtorëve të shkollave, mësimdhënësve dhe prindërve

69

Kutia 3. Sugjerimet e nxënësve për të përmirësuar vijueshmërinë dhe për të parandaluar braktisjen e shkollës

// SHKURTESAT

| | |
|--------|---|
| CRS | Shërbimi Katolik për Ndihmë |
| DKA | Drejtoria Komunale e Arsimit |
| EPRBM | Ekipi për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit |
| ETF | Fondacionin Evropian për Trajnime |
| GIZ | Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Teknik |
| IPK | Instituti Pedagogjik i Kosovës |
| KKK | Korniza e Kurrikulës së Kosovës |
| KB | Kurrikula Bërthamë |
| KEC | Qendra për Arsim e Kosovës |
| KDF | Konventa e të Drejtave të Fëmijëve |
| KFOS | Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur |
| KN | Këshilli i Nxënësve |
| KP | Këshilli i Prindërve |
| MASHT | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë |
| OECD | Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim |
| OJQ | Organizata joqeveritare |
| OSBE | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian |
| PIA | Plani individual i arsimit |
| PPPA | Projekti për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim |
| PSAK | Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë |
| RAE | Komunitetet: romë, ashkali dhe egjiptianë |
| SIA | Sektori i Inspektimit të Arsimit |
| SMIA | Sistemi i menaxhimit të informatave në arsim |
| SNKA | Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (UNESCO-ISCED) |
| UA | Udhëzimi Administrativ |
| UNESCO | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë |
| UNICEF | Fondi i fëmijëve i Kombeve të Bashkuara |

// PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Studimi bazë për fëmijët jashtë shkollës (praktikat e parandalimit dhe të reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë) u realizua në kuadër të nismës Fëmijët Jashtë Shkolle dhe Adoleshentët, përkrahur nga zyra rajonale e UNICEF-it dhe në kuadër të projektit “Implementimi i standardeve të Shkollave Mike për Fëmijë – drejt shkollave gjithëpërfshirëse”. Studimi u realizua nga hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës me autorizimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe me përkrahjen e UNICEF-it.

Objekti i studimit ishte profili i fëmijëve jashtë shkollës dhe identifikimi i praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë. Qëllimi i studimit bazë ishte për të analizuar praktikat lidhur me: (I) identifikimin e fëmijëve jashtë shkollës dhe atyre që janë në rrezik për ta braktisur dhe (II) mbështetjen, riintegrimin, përfshirjen dhe mbajtjen e tyre në shkollë. Studimi gjithashtu synonte për të identifikuar nevojat e shkollave dhe të komunave (DKA-ve) në drejtim të identifikimit të fëmijëve

jashtë shkolle dhe në parandalimin e braktisjes dhe në përmirësimin e kapaciteteve për reagim ndaj braktisjes së shkollës dhe mosregjistrimit. Metodologjia e studimit përfshin një kombinim të qasjes kualitative dhe kuantitative. Të dhënat kualitative janë marrë nga burime të shumta, duke përfshirë të dhënat nga shqyrtimi i literaturës, raporteve statistikore dhe nga intervistat dhe takimet me fokus grupe. Të dhënat sasiore janë marrë nga pyetësorët e anketës të administruar në shkolla me përfaqësues të komunitetit të shkollës.

Studimi u realizua në gjysmën e parë të vitit 2013 dhe pati shtrirje në shtatë komuna të Kosovës: Fushë-Kosovë, Obiliq, Malishevë, Klinë, Istog, Pejë dhe Ferizaj. Në studim janë përfshirë 14 shkolla të arsimit bazë, dy shkolla të arsimit fillor dhe arsimit të mesëm të ulët për secilën komunë.

Të gjeturat më të rëndësishme nga studimi bazë janë përmbledhur në pjesën në vijim.

Fëmijët jashtë shkolle - përcaktimi. Nuk përmendet në mënyrë specifike në legjislacionin dhe në kornizën e politikave arsimore të Kosovës. Termi fëmijët jashtë shkollës kryesisht ka filluar të përdoret kur Kosova iu bashkua iniciativës Fëmijët Jashtë Shkolle të udhëhequr nga UNICEF-i

Braktisja e shkollës – përcaktimi në legjislacion dhe në kornizën e politikave arsimore të Kosovës. Sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011), me braktisje të shkollës konsiderohet vetëm ndërprerja e përkohshme e shkollimit të detyruar, në rastin e Kosovës deri në fund të klasës së nëntë (9). Mirëpo në Udhëzimin Administrativ (nr. 19/2012) Krijimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar, kemi një përkufizim më gjithëpërfshirës, sepse sipas këtij udhëzimi “braktisës” konsiderohet se është (I) ai nxënës, i cili ndërpret shkollimin para përfundimit të arsimit të obliguar me ligj, (II) ai nxënës i cili edhe pas mbarimit të arsimit të obliguar e vazhdon shkollimin, por e ndërpret atë në një periudhë të mëvonshme, para përfundimit të synuar dhe (III) ai fëmijë ose i ri, i cili nuk është regjistruar në shkollë dhe kështu nuk ndjek arsimin e obliguar me ligj.

Në legjislacion dhe në kornizën e politikave arsimore të Kosovës nuk ka një përcaktim të qartë për fëmijët që mungojnë për një kohë të caktuar në shkollë, se pas sa kohe të mungesës në shkollë mund të konsiderohet se ai fëmijë e ka braktisur shkollën.

Perspektiva e gjithëpërfshirjes në arsim nga këndvështrimi i kornizës së politikave arsimore në Kosovë. Korniza e politikave arsimore në arsimin parauniversitar në Kosovë dhe dokumentet strategjike që adresojnë gjithëpërfshirjen në arsim, marrin parasysh normat e miratuara ndërkom-bëtare për arsimin për të gjithë, të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen e grupeve të ndjeshme në shoqëri dhe avancimin e barazisë gjinore e diversitetit kulturor. Ne Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë

2011-2016 gjithëpërfshirja në arsim është njëri nga prioritetet e arsimit, gjithashtu gjithëpërfshirja në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës (2011) është njëri nga parimet kryesore mbi të cilin mbështet zhvillimi i kurrikulave.

Regjistrimi i fëmijëve në edukimin parashkollor dhe parafillor (mosha 5-6 vjeç). Regjistrimi e fëmijëve në edukimin parashkollor dhe parafillor (mosha 5-6 vjeç) dallon nga viti në vit, mirëpo në vitet e fundit trendi i përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor për çdo vit shënon një rritje relativisht të vogël. Në 10 vitet e fundit, sipas raporteve statistikore të njësisë së SMIA-s, mesatarja e regjistrimit të fëmijëve të moshës 5-6 vjeç në edukimin parashkollor dhe parafillor është rritur nga 2.5% në çdo vit.

Regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë. Shkollës nuk i dërgohen as nga Zyra e regjistrimit civil dhe as nga DKA-të listat e fëmijëve të zonës që janë në moshë për t'u regjistruar në klasën e parë. Përgatitja e regjistrave për regjistrim në klasën e parë bëhet kryesisht nga vetë shkollat, disa i plotësojnë ato nga klasa parafillore (nëse kanë), ose nga prindërit që i sjellin të dhënat për regjistrimin e fëmijëve.

Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë vazhdon të bëhet sipas një praktike të ndërtuar nga vetë shkollat, nuk ka ndonjë mekanizëm që përcakton kriteret e përgatitjes së fëmijës për të hyrë në klasën e parë dhe kjo paraqet vështirësi sidomos për shkollat që nuk kanë pedagog dhe psikolog. Edhe pse shkollat përcaktojnë afatin e regjistrimit të nxënësve në klasën e parë, në shumicën e shkollave nuk respektohen afatet e regjistrimit dhe prindërit i regjistrojnë fëmijët e tyre në shkollë pas afatit dhe kjo shkakton shpesh probleme në fillimin e mbarë të vitit shkollor për shkak të lëvizjes së nxënësve ose të rritjes së ndonjë paraleleje me nxënës që në qershor nuk është planifikuar.

Të dhënat për fëmijët jashtë shkollës dhe mundësitë e identifikimit. Si në nivelin qendror, ashtu edhe në nivelin komunal dhe në nivel shkollë, mungojnë të dhënat e plota për fëmijët jashtë shkollë, duke përfshirë fëmijët që nuk janë regjistruar asnjëherë në shkollë, fëmijët që kanë braktisur shkollën dhe ata që janë në rrezik për ta braktisur shkollën.

Hulumtimet e deritanishme janë të pakta dhe jogjithëpërfshirëse, për faktin se akoma nuk kemi ndonjë hulumtim specifik që ka trajtuar praktikën e adresimit të fëmijëve jashtë shkollës dhe parandalimit e reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës.

Karakteristika individuale të fëmijëve jashtë shkollë të identifikuar nga rastet studimore të analizuar janë: (I) fëmijë të komuniteteve RAE dhe (II) fëmijë ose adoleshentë që janë regjistruar me vonesë në shkollë dhe që kanë rezultate të dobëta në mësim. Kurse karakteristikat sociale të fëmijëve jashtë shkollë, fëmijëve braktisës të shkollës, janë: (I) U përkasin familjeve shumë të varfra; (II) Punojnë për të mbështetur veten e tyre ose familjet e tyre; (III) Kanë traditë në familje për të braktisur shkollën apo për të bërë mungesa të shumta në shkollë; (IV) Janë të familjeve të përfshira në abuzim me alkool dhe që nuk kanë kujdes ndaj fëmijëve; (V) Jetojnë pa prindër, me njërin prind ose me prindër të ndarë etj.

Braktisja e shkollës. Statistikat tregojnë për një rënie të lehtë të numrit të nxënësve që kanë braktisur shkollën, megjithatë braktisja e shkollës vazhdon të shikohet nga i gjithë komuniteti arsimor si një problem që duhet trajtuar shumë seriozisht për të parandaluar dhe për të reaguar drejt ndaj kësaj dukurie. Raportet e shkollave për katër vitet e fundit tregojnë se në të gjitha shkollat e përfshira në studim është e pranishme dukuria e braktisjes së shkollës dhe se ekziston një trend i lëvizjes së numrit të nxënësve që braktisin shkollën, kurse në disa shkolla është shënuar rënia e numrit të nxënësve që kanë braktisur shkollën në këto dy vitet e fundit, në disa shkolla të tjera ekziston një trend relativisht i vogël i rritjes së numrit të nxënësve që braktisin shkollën.

Sistemi aktual i evidencimit të nxënësve që braktisin shkollën ndjek një qasje nga poshtë-lart, ku nxënësit që braktisin evidencohen nga shkollat, pastaj përcillen në nivel komunal dhe në sistemin e SMIA-s.

Programi SMIA shihet si një mundësi e mirë për identifikimin e saktë të fëmijëve që kanë braktisur shkollën. Identifikimi i tyre deri në këtë fazë nuk është në nivelin e saktësisë. Sipas DKA-ve, nga shkollat shpesh vijnë raporte të pavërtetuara mirë për nxënësit që kanë braktisur shkollën.

Në përgjithësi, aktivitetet e nivelit komunal dhe të nivelit të shkollës nuk janë të harmonizuara për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës dhe ndaj mosregjistrimit.

Mungesat e nxënësve. Në shkollat e përfshira në studim numri më i madh i mungesave të nxënësve në mësim është në nivelin e arsimit të mesëm të ulët, përkundërt arsimit fillor. Ka shkolla ku mesatarja e mungesave në vit për një nxënës arrin deri në 25 mungesa në orë mësimore. Mesatarja e mungesave të nxënësve është më e lartë në shkollat ku janë të përfshirë fëmijët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, se në shkollat ku nuk mësojnë fëmijët e këtyre komuniteteve.

Në kornizën e politikave arsimore në Kosovë, në nivel kombëtar dhe lokal, nuk ka rregullore apo politika për mungesat në shkolla dhe kjo ka ndikuar që në asnjë dokument të rregullave të sjelljes në shkollë të miratuara nga DKA-të të mos jenë të përcaktuara qartë kriteret kur një nxënës bën mungesa të arsyeshme dhe të paarsyeshme dhe, për pasojë, në shkolla nuk ka një harmonizim se kur duhet të arsyetohen ose nuk duhet të arsyetohen mungesat e nxënësve.

Ekipi për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar në nivel komunal dhe në nivel shkolle (EPRBM). Në katër nga shtatë komuna të përfshira në studim janë themeluar EPRBM-të. Përfaqësuesit e komunave që nuk i kanë themeluar ekipet, gjatë intervistave kanë raportuar se e dinë se është detyrim që del nga Udhëzimi Administrativ për këtë çështje, por se akoma nuk kanë arritur. Edhe komunat që e kanë themeluar EPRBM-në, nuk kanë hartuar ende plane të veprimit për të përmbushur misionin e këtyre ekipeve.

Prej 14 shkollave të përfshira në studim, vetëm 6 prej tyre kanë ofruar dëshmi të shkruara për themelimin e EPRBM-ve. Në përgjithësi, respondentët në nivel shkolle rolin e EPRBM-ve më shumë e lidhin me parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe më pak me problemin e mosregjistrimit të fëmijëve dhe të rinjve të moshës shkollore në arsimin e detyruar.

Bashkëpunimi ndërsektorial dhe bashkëpunimi me OJQ-të. Bashkëpunimi ndërsektorial për adresimin e fëmijëve jashtë shkolle – për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar është pjesërisht duke ndodhur. Qendra për punë sociale mbetet sektori më i përfshirë në bashkëpunim me DKA-të dhe shkolla për adresimin e fëmijëve jashtë shkolle, kjo bëhet për faktin se nga ky sektor nxirren vendimet për mbështetje sociale të familjeve që janë në asistencë sociale dhe këto vendime në të shumtën e rasteve kushtëzohen me vërtetimet që shkollat i lëshojnë për vijueshmërinë e nxënësve/fëmijëve në shkollë. Strukturat komunale nuk kanë ndërtuar ndonjë mekanizëm të veçantë për bashkëpunim ndërsektorial për adresimin e fëmijëve jashtë shkolle.

Plani i zhvillimit të arsimit/shkollës. Si në nivelin komunal, ashtu edhe në nivel shkolle, bëhet përpjekje për të hartuar plane të zhvillimit të arsimit në nivel komune, përkatësisht plane të zhvillimit të shkollës. Mirëpo shumica e planeve përbëhen nga prioritete që lidhen me zhvillimin e infrastrukturës së shkollës dhe më pak lidhen me adresimin e cilësisë së punës së shkollës dhe adresimin e çështjeve të ndjeshme, siç janë parandalimi dhe reagimi ndaj braktisjes së shkollës dhe mosregjistrimit në shkollë. Në disa plane të zhvillimit të shkollës gjejmë përshtime, sidomos në pjesën hyrëse, se shkollat kanë identifikuar braktisjen si problem kryesor, por identifikimin e problemit të braktisjes nuk e kanë adresuar në planin zhvillimor të shkollës me asnjë prioritet dhe me aktivitete konkrete se çka do të bëjnë për të adresuar në mënyrë të drejtë çështjen e braktisjes së shkollës.

Gjithëpërfshirja në arsim. Edhe pse gjithëpërfshirja në arsim është njëra nga dy prioritetet kryesore të MASHT-it, në shumicën e planeve të zhvillimit të arsimit në nivel komunal nuk janë gjetur objektiva të qarta dhe aktivitete të cilat do të mund të tregonin se gjithëpërfshirja në arsim është prioriteti kryesor edhe në nivel komunal. Në komunën e Fushë-Kosovës një segment i gjithëpërfshirjes është adresuar përmes planit komunal të veprimit për integrimin e komuniteteve RAE. Gjithashtu, në planin e zhvillimit të arsimit në komunën e Fushë-Kosovës, ekziston një objektiv strategjik për gjithëpërfshirjen e fëmijëve parashkollorë, mirëpo këtij plani i mungojnë aktivitetet se si do të arrihet ky objektiv, cili është plani kohor i arritjes së objektivit etj.

Niveli komunal nuk ka ndonjë mekanizëm për mbajtjen e evidencave të incidenteve diskriminuese dhe të dhunës të nxënësve ndaj nxënësve, apo të mësimdhënësve ndaj nxënësve dhe rrjedhimisht nuk ka dëshmi se ndaj cilave kategori të fëmijëve është i shprehur më shumë diskriminimi, dhuna dhe çfarë lloji i diskriminimit dhe dhunës është më shumë i shprehur. Edhe në nivel shkolle nuk ka evidenca të rasteve të diskriminimit dhe të dhunës në shkollë, edhe pse nxënësit ofrojnë dëshmi të incidenteve diskriminuese ndërmjet vetë nxënësve dhe, në raste më të rralla, edhe nga ana e mësimdhënësve. Sipas nxënësve të përfshirë në hulumtim, djemtë, vajzat dhe nxënësit me rezultate më të ulëta në mësim janë më të atakuarit nga incidentet diskriminuese.

Komunat e përfshira në studim kanë identifikuar tri çështje të lidhura me gjithëpërfshirjen, që nuk kanë arritur t'i adresojnë/zgjidhin në nivelin e duhur: (I) braktisjen e shkollës, (II) punën me fëmijë me nevoja të veçanta, (III) regjistrimin dhe përfshirjen në shkollim të gjithë fëmijëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë. Kjo tregon se këto tri çështje mbesin ndër sfidat kryesore për të gjitha komunat e përfshira në studim.

Nevojat për mbështetje/përkrahje të shkollave dhe të DKA-ve për adresimin e aspekteve problematike që lidhen më fëmijët jashtë shkolle dhe me funksionimin e EPRBM-ve. Niveli komunal i arsimit ka shfaqur nevojën për mbështetje në: (I) përgatitjen e një platforme për themelimin dhe funksionalizimin e EPRBM-ve; (II) trajnimin e EPRBM-ve dhe përkrahjen e tyre në hartimin e planeve të veprimit; (III) organizimin dhe mbështetjen e EPRBM-ve komunale për monitorim të rasteve në terren dhe për të identifikuar fëmijët jashtë shkollës; (IV) organizimin e ligjëratave, debateve për vetëdijesimin me prindër, sidomos të komuniteteve RAE për rëndësinë e shkollimit të fëmijëve të tyre; (V) ofrimin e udhëzuesve praktik për identifikimin e fëmijëve jashtë shkolle, hartimin e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave për fëmijët jashtë shkolle; (VI) ofrimin e modeleve të raportimit nga zyra për regjistrim civil për fëmijët që kanë arritur moshën e regjistrimit në klasën parafillore dhe në klasën e parë të shkollës fillore dhe (VII) zhvillimin e mekanizmave lehtësues për zbatimin e politikave për përfshirjen në shkollë të fëmijëve që aktualisht janë jashtë shkollës dhe për masa ndaj prindërve që nuk i dërgojnë fëmijët në shkollë.

Kërkesat e komunitetit shkollor për mbështetje janë të lidhura me kontekstin e praktikave shkollore për adresimin e aspekteve problematike që lidhen më fëmijët jashtë shkolle, ofrimin e instrumenteve për identifikimin dhe monitorimin e fëmijëve në rrezik për ta braktisur shkollën, trajnimin e ekipeve shkollore për t'iu qasur në mënyrë të drejtë kërkesave të gjithëpërfshirjes dhe efektivitetit të mësimdhënies dhe nxënies, ofrimin e shembujve të praktikave të mira se si të përkrahen nxënësit me arritshmëri të ulët në mësim, si të zvogëlohen mungesat e nxënësve në mësim, si dhe në ofrimin e udhëzuesve dhe të doracakëve për praktikën e përdorimit të standardeve të Shkollave Mike në vetëvlerësimin e punës së shkollës

Me qëllim të promovimit të një sistemi të qëndrueshëm të praktikave të adresimit të fëmijëve jashtë shkollës dhe parandalimit e reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës në Kosovë, respondentët e përfshirë në studim rekomandojnë që fokusi i mbështetjes për nivelin komunal dhe nivelin shkollor duhet të vihet në:

- hartimin e një pakete të instrumenteve për identifikimin dhe parandalimin e fëmijëve braktisës të shkollës dhe të atyre jashtë shkolle;
- hartimin dhe implementimin e programeve për trajnimin e EPRBM-ve për të siguruar kthimin me kohë të nxënësve që kanë braktisur shkollën dhe zbatimin e instrumenteve për identifikimin dhe parandalimin e fëmijëve braktisës të shkollës dhe atyre jashtë shkolle;
- krijimin e mekanizmave që forcojnë bashkëpunimin ndërsektorial, marrëveshje mirëkuptimi në mes të institucioneve të nivelit komunal – Drejtoria Komunale e Arsimit, Qendra për Punë Sociale, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Zyra për Komunitete dhe të Kthyerit, Policia etj., duke përfshirë edhe OJQ-të që merren me fushën e edukimit, për regjistrimin e fëmijëve në klasën parafillore dhe në klasën e parë të arsimit fillor, identifikimin, raportimin dhe përkrahjen për adresimin ndërsektorial të fëmijëve jashtë shkolle;
- krijimin e mekanizmave efektivë të evidentimit, monitorimit, raportimit, ndërhyrjes dhe të llogaridhënies për identifikimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve jashtë shkolle, për të parandaluar mungesat e nxënësve, braktisjen e shkollës dhe incidentet diskriminuese;
- trajnimin e ekipeve shkollore për zbatimin në praktikë të standardeve të shkollave mike për fëmijë, si mundësi për të siguruar gjithëpërfshirjen në shkollë, zvogëlimin e mungesave në mësim dhe për të përmirësuar cilësinë në arsim;
- këshillim të nevojshëm dhe të drejtpërdrejtë për nivelin komunal dhe nivelin shkollos në bazë të kërkesave dhe të nevojave të tyre specifike;
- implementimin e programeve të trajnimit me prindër dhe organizimin e fushatave të vetëdijesimit të prindërve për rëndësinë e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollos, për regjistrimin me kohë në klasën e parë dhe vijueshmërinë e rregullt në mësim gjatë shkollimit të tyre dhe për t'i mbështetur fëmijët e tyre dhe nevojat emocionale, veçanërisht gjatë tranzicionit në mes të niveleve të shkollimit;
- publikimin e të dhënave vjetore për braktisjen e shkollës, si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel lokal dhe në nivel shkollos dhe
- fuqizimin e mekanizmave të mbrojtjes sociale për të mbështetur regjistrimin dhe vijimin e fëmijëve në sistemin e arsimit.



1. HYRJE

Ky studim u realizua në kuadër të projektit “Implementimi i standardeve të Shkollave Mike për Fëmijë – drejt shkollave gjithëpërfshirëse”. Studimi u realizua nga hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës me autorizimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe me përkrahjen e UNICEF-it.

Qëllimi i studimit bazë ishte mbledhja e të dhënave për praktikën e identifikimit të fëmijëve jashtë shkollës dhe atyre që janë në rrezik për ta braktisur shkollën, praktikën e parandalimit e reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, ku në bazë të të dhënave të siguruara dhe të vlerësimit të nevojave do të ofrohet mbështetje për ekipet e shkollave dhe të komunave nga partnerët e arsimit në Kosovë, progresi i së cilës do të vlerësohet në një fazë të mëvonshme.

Ky raport ka për qëllim të ofrojë informacione për MASHT-in, DKA-të, shkollat, UNICEF-in - zyra në Kosovë dhe organizata të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare që mbështesin zhvillimin e arsimit në Kosovë, lidhur me (I) njohuritë, qëndrimet për praktikën e adresimit të çështjes së fëmijëve jashtë shkollës dhe praktikën e parandalimit e reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, si dhe (II) dhënien e rekomandimeve konkrete për të ndihmuar në krijimin e mekanizmave dhe të praktikave të mira për strukturat në nivel komune dhe shkolle për integrimin e fëmijëve jashtë shkollës, parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës dhe mosregjistrimit.

1.1. Arsyeshmëria për studimin

Deri tash janë zhvilluar disa studime për braktisjen e shkollës në Kosovë, janë identifikuar disa nga shkaqet kryesore që e shkaktojnë braktisjen, por pjesa më e madhe e këtyre studimeve kanë qenë të fokusuar vetëm në dukurinë e braktisjes së shkollës nga nxënësit që janë regjistruar në shkollë, mirëpo pak vëmendje u është kushtuar fëmijëve që nuk janë regjistruar kurrë në shkollë, që regjistrohen me vonesë, ose fëmijëve që janë në rrezik për të braktisur shkollën.

Ky studim është i iniciuar në kuadër të Iniciativës Rajonale të UNICEF-it “Fëmijët jashtë shkolle dhe adoleshentët”, e cila mbështetet në Iniciativën Globale “Fëmijët jashtë shkolle”, e udhëhequr nga UNICEF-i dhe Instituti i UNESCO-s për statistika. Nisma globale ka për synim që të arrijë zvogëlimin e numrit të fëmijëve që janë jashtë shkolle në mbarë botën. Për të arritur këtë, është prezantuar një model, i cili hulumton apo analizon dimensionet e përjashtimit të fëmijëve gjatë tërë ciklit akademik, duke filluar nga arsimi i moshës shkollore, prej klasës parafilllore deri në shkollën e mesme të lartë. Ky model i kushton rëndësi të veçantë profilit të fëmijëve të cilët tashmë janë jashtë shkolle, por edhe të atyre të cilët janë në rrezik të braktisjes së shkollës, përfshirë kalimin prej një niveli të arsimit në nivelin tjetër të arsimit. Fillimisht 25 shtete morën pjesë në Nismën Globale, rishtas u publikua një raport për Evropën Qendrore dhe Lindore – Komenuellth - it të shteteve të pavarura (EQL/KSHP) si kontribut i Nismës Globale¹.

Bazuar në Nismën Globale, UNICEF EQL/KSHP e lansoi Nismën Rajonale me qëllim të përkrahjes së sistemeve arsimore dhe ministrive të arsimit për zvogëlim të numrit të fëmijëve jashtë shkolle. Qëllimi ishte që të rritet përfshirja në arsimin e obliguar deri në vitin 2015 dhe të përfshihen të gjithë fëmijët në të nxënit cilësor në shkollën filllore dhe të mesme deri në vitin 2030. UNICEF-i përkrah hartimin e strategjive dhe të politikave në nivel kombëtar për identifikim të fëmijëve jashtë shkolle dhe të atyre në rrezik të braktisjes dhe të implementojë intervenimet për parandalim dhe reagim ndaj mungesës në mësim dhe braktisjes së shkollës. UNICEF-i po ashtu synon të fuqizojë sistemet e të dhënave dhe informatave, shpërndarjen e tyre për të përcjellë dhe për të monitoruar fëmijët jashtë

¹ UNICEF, 2013, Barazia në arsim tani! Analizë regjionale e gjendjes së fëmijëve jashtë shkolle në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe Komenuellthit - it të shteteve të pavarura (EQL/KSHP), Zyra Regjionale e Unicefit, Gjenevë 2013 (Broshurë përmbledhëse).

² <http://education-equity.org/>

shkollë, braktisësit dhe ata në rrezik për braktisje. Në fund UNICEF-i disenjon intervenime inovative për parandalim dhe reagim në nivel lokal dhe me bazë në shkollë, përfshirë sistemet për paralajmërim të hershëm për fëmijët në rrezik të braktisjes, përkrahje në nxënie, angazhimin dhe pjesëmarrjen e familjes dhe fëmijëve në intervenime, si dhe praktikatat gjithëpërfshirëse në shkollë. Thirrja për veprim Barazi në Arsim tani! Përfshirja e të gjithë fëmijëve në të nxënit cilësor², e lansuar në dhjetor të vitit 2013 në Konferencën Rajonale të Ministrave të Arsimit në Stamboll, paraqet një platformë të re të vendeve dhe të partnerëve për ndarjen e njohurive dhe të praktikave të mira që kanë të bëjnë me fëmijët jashtë shkollë dhe me braktisjen.

Studimi bazë është kontribut i UNICEF-it për të përmirësuar të kuptuarit e barrierave në nivel kombëtar, lokal dhe në nivel shkollë, të cilat pamundësojnë që fëmijët të regjistrohen në shkollë, të vijnë në shkollë rregullisht dhe ta përfundojnë atë me sukses. Studimi i kontribuon zbatimit të Standardeve të Shkollave Mike për Fëmijë, Planit strategjik të arsimit në Kosovë 2011-2016 dhe Planit kombëtar të veprimit kundër braktisjes së shkollës 2009-2014.

1.2. Metodologjia e studimit

Studimi bazë është i bazuar në metodologjinë hulumtuese kuantitative dhe kualitative. Studimit i ka paraprirë këshillimi me akterët kryesorë të arsimit parauniversitar në Kosovë dhe shqyrtimi i literaturës relevante, gjatë së cilës janë intervistuar përfaqësues nga MASHT-ti, DKA-të dhe shkollat, pastaj janë konsultuar politikatat arsimore që janë relevante për braktisjen, statistikatat në arsim dhe studimet e deritashme në fushën e braktisjes etj. Pastaj studimi është realizuar përmes anketës, intervistave, fokus grupeve, analizës së dokumenteve dhe raporteve të punës së institucioneve shkollë dhe DKA-ve, të cilat ndihmuan në pasqyrimin e njohurive për fëmijët jashtë shkollës, qëndrimeve dhe praktikave të intervenimit lidhur me fëmijët jashtë shkollës dhe braktisjen e shkollës, si dhe ndihmuan në nxjerrjen e rekomandimeve për intervenim, mbi bazën e gjetjeve dhe nevojave të dala nga studimi.

1.2.1. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Objekti i studimit ishte profili i fëmijëve jashtë shkollës dhe praktikatat gjithëpërfshirëse në shkollë. Kurse qëllimi i studimit bazë ishte të analizojë praktikatat lidhur me: (I) identifikimin e fëmijëve jashtë shkollës dhe të atyre që janë në rrezik për ta braktisur, (II) të mbështesë ekipet komunale dhe në nivel shkollë për riintegrimin e tyre, përfshirjen dhe mbajtjen e tyre në shkollë.

Tri pyetjet kryesore të studimit janë:

- I. Cilat janë politikatat dhe programet arsimore që adresojnë gjithëpërfshirjen, me fokus fëmijët jashtë shkollë?*
- II. Cilat janë praktikatat e adresimit të çështjes së fëmijëve jashtë shkollës dhe parandalimit të braktisjes?*
- III. Cilat janë nevojat për mbështetje/përkrahje të DKA-ve dhe të shkollave në adresimin e çështjes së fëmijëve jashtë shkollës, parandalimin e braktisjes dhe mosvijueshmërisë?*

Objektivat kryesorë të studimit u vendosën:

- Të shqyrtohen dhe të analizohen aspektet e politikave arsimore, planet e veprimit, hulumtimet dhe statistikatat në arsimin bazë që reflektojnë gjithëpërfshirjen, me fokus fëmijët jashtë shkollë dhe dukurinë e braktisjes së shkollës nga nxënësit;*
- Të hulumtohen praktikatat e intervenimit sa ka të bëjë me fëmijët jashtë shkollës dhe braktisjen e shkollës;*
- Të nxirren përfundime dhe rekomandime për krijimin e mekanizmave dhe të praktikave të mira për strukturat në nivel komune dhe shkollë për integrimin e fëmijëve jashtë shkollës, parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës dhe mosregjistrimit;*

Bazuar në rezultatet e studimit, Instituti Pedagogjik i Kosovës pritet:

- të hartojë një plan të veprimit për mbështetje të shkollave dhe të DKA-ve në zbatimin e praktikave të mira të intervenimit lidhur me fëmijët jashtë shkollës dhe braktisjen e shkollës dhe
- të ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë për DKA-të dhe shkollat.

1.2.2. Fazat e realizimi të studimit

Studimi bazë u realizua në katër faza.

(I) Faza e këshillimit (shkurt – mars 2013)

Në këtë fazë u organizua një punëtori me përfaqësues të Sektorit të Inspektimit në MASHT dhe me përfaqësues të DKA-ve. Qëllimi ishte diskutimi për praktikën e adresimit të fëmijëve me mungesa të shumta në shkollë dhe çështjen e fëmijëve jashtë shkollës dhe për identifikimin e masave që do të merren për zbatimin e suksesshëm të dokumentit për Shkollat Mike për Fëmijë dhe standardet e gjithëpërfshirjes. Kjo ishte punëtorja që dha një orientim për shtrirje të studimit.

(II) Faza e shqyrtimit të literaturës (mars – maj 2013)

Në këtë fazë u analizuan politikat arsimore, planet e veprimit dhe treguesit statistikorë për gjithëpërfshirjen - me fokus çështjen e fëmijëve jashtë shkolle, u zhvilluan instrumentet e studimit - pyetësorët e strukturuar, protokollat e intervistave, formati i pyetjeve për diskutim me fokus grupe, si dhe u hartua një plan pune për realizimin e studimit në terren.

(III) Hulumtimi në terren (maj - qershor 2013)

Në këtë fazë u administruan pyetësorët e studimit në nivel shkolle, u realizuan intervistat me përfaqësues të komunave, si dhe u bënë takimet me fokus grupe të OJQ-ve.

(IV) Analiza e të dhënave dhe raportimi (korrik - shtator 2013)

Pas futjes dhe analizës së të dhënave janë prezantuar dhe janë diskutuar gjetjet preliminare në tri punëtori të veçanta me përfaqësues të shkollave, me përfaqësues të komunave dhe me përfaqësues të sektorit të inspektimit të arsimit. Bazuar në rezultatet dhe në diskutimet u finalizua raporti i studimit.

1.2.3. Mostra

Popullacionin në hulumtim e përbëjnë tri shtresa: (I) administrata komunale – relevante me temën e studimit, (II) faktorët/palët e interesit në shkollë (nxënësit, mësimmësuesit, prindërit dhe udhëheqësit e shkollës) dhe (iii) OJQ-të që veprojnë në fushën e edukimit, në komunat ku është zhvilluar studimi – Fushë-Kosovë, Obiliq, Malishevë, Klinë, Istog, Pejë dhe Ferizaj.

Mostra e studimit në nivel komunal përbëhet nga 42 drejtues dhe zyrtarë nga sektorë të ndryshëm të shtatë komunave të përfshira në studim.

Nga çdo komunë e përfshirë në studim janë përcaktuar dy shkolla - fillore dhe të mesme të ulëta. Përzgjedhja e shkollave është bërë në bashkëpunim me DKA-të e komunave përkatëse. Shkollat janë identifikuar në bazë të kritereve në vijim: (I) shkollë urbane dhe rurale; (II) mesatarja e arritjes në testin e klasës së nëntë; (III) norma e braktisjes së shkollës; (IV) shkalla e mungesave; (V) shkollë që ka fëmijët nga komunitetet RAE; (VI) shkollë me klasë të bashkangjitura; (VII) shkollë që ka fëmijët e pakicave të tjera etnike; (VIII) shkollë me ose pa mbështetje të donatorëve.

Përzgjedhja e mostrës me përfaqësues të shkollës është bërë në bazë të disa kriterëve. Kriteret për nxënës: fëmijë me nevoja të veçanta, fëmijë të komuniteteve RAE, fëmijë me rezultate të larta në mësim, fëmijë me rezultate të ulëta në mësim. Kriteret për mësime: mësime që (I) punojnë me klasë të bashkangjitura, (II) që kanë fëmijë të komuniteteve të tjera në klasë, (III) që janë në EPRBM, (IV) që janë anëtar të Këshillit Drejtues të Shkollës dhe (V) mësime të tjerë. Kriteret për përzgjedhjen e mostrës së prindërve: përfaqësues të prindërve nga: Këshilli Drejtues i Shkollës, Këshilli i prindërve, Ekipi për EPRBM, prindër të fëmijëve me nevoja të veçanta, prindër të fëmijëve nga komunitetet RAE dhe komunitetet e tjera.

Mostrën e studimit në nivel shkolle e përbëjnë 294 respondentë, prej tyre 133 nxënës nga shkolla e mesme e ulët, 81 mësime të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, 63 prindër të fëmijëve që janë nxënës në arsimin e mesëm të ulët, 15 udhëheqës të shkollave dhe 2 mediatorë në nivel shkolle.

Struktura e mostrës në nivel shkolle është e mjaftueshme për të nxjerrë përfundime të qëndrueshme për komunitetin ku është bërë studimi për praktikën e adresimit të fëmijëve jashtë shkollës dhe parandalimit e reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, si dhe rekomandimet për të ndihmuar në krijimin e mekanizmave dhe të praktikave të mira për integrimin e fëmijëve jashtë shkollës, parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës dhe mosregjistrimit. Mostra nuk mund të konsiderohet si përfaqësuese në shkallë vendi për shkak të numrit të vogël të shkollave të përzgjedhura, pavarësisht zbatimit të kriterëve në përzgjedhjen e mostrës.

Mostra e tretë përbëhet nga përfaqësuesit e OJQ-ve. Në shtatë komunitet e përfshira në studim kanë marrë pjesë 31 përfaqësues të OJQ-ve në takimet me fokus grupe të organizuara në çdo komunë. Kriteri i përfshirjes së përfaqësuesve të OJQ-ve në këto takime ka qenë pjesëmarrja e tyre në aktivitete që lidhen me edukimin në nivel komunal, veçanërisht në aktivitete të lidhura me studimin tonë. Detajet e mostrës për secilën shtesë të popullacionit të studimit janë dhënë në aneksin nr.4 - tabela me të dhënat e mostrës së përfshirë në studim.

1.2.4. Metodën, teknikat dhe instrumentet e studimit

Specifikat dhe kompleksiteti i fushës së studimit ka kushtëzuar zbatimin e një metodologjie të kombinuar, përmes së cilës kemi bërë grumbullimin, analizën dhe përpunimin e të dhënave. Trajtimin teorik të problemit të përzgjedhur e kemi bërë nëpërmjet metodës së analizës teorike, praktikën aktuale të adresimit të fëmijëve jashtë shkollës dhe parandalimit e reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës i kemi studiuar përmes metodës së analizës së dokumentacionit, metodës përshkruese, metodës statistikore dhe metodës së fokus grupit.

Teknikat e përdorura në studim janë teknika e intervistës dhe teknika e anketimit. Ndërkaq për instrumente kemi shfrytëzuar pyetësorët e anketës, pyetësorët e intervistës gjysmë të strukturuar, fletëpyetësorin e fokus grupit dhe dëshmitë e shkruara.

Pyetjet në pyetësorët e anketave janë të tipave të ndryshme: të mbyllura, të hapura dhe të kombinuara. Pyetësorët e anketës dhe të intervistave në nivel shkolle kanë përfshirë pyetje të ndara për pesë blloqe, si: (I) shkalla e kënaqësisë së akterëve kryesorë të shkollës me rezultatet e punës në shkollë; (II) mungesat e nxënësve në mësim; (III) braktisja e shkollës; (IV) ekipi i shkollës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit (EPRBM); (V) gjithëpërfshirja dhe (VI) vlerësimi i nevojave të shkollës për mbështetje/përkrahje në adresimin e fëmijëve jashtë shkollës, parandalimin e braktisjes dhe në rrugën e saj drejt shkollave gjithëpërfshirëse.

Pyetësorët e intervistave të strukturuar në nivel komune kanë përfshirë pyetje të integruara në dy blloqe. Blloku i parë i pyetjeve për praktikën e adresimit të fëmijëve jashtë shkollës dhe parandalimit të braktisjes është ndarë në shtatë pjesë: (I) përfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor – klasën parafillore; (II) regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë; (III) të dhënat për fëmijët jashtë shkollës dhe

mundësitë e identifikimit; (IV) braktisja e shkollës dhe mungesat e nxënësve; (V) ekipi për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar; (VI) bashkëpunimi ndërsektorial dhe bashkëpunimi me OJQ; (VII) gjithëpërfshirja. Ndërkaq në bllokun e dytë janë përfshirë pyetje përmes së cilave janë nxjerrë rekomandimet dhe nevojat për përkrahje të DKA-së dhe EPRBM-së në nivel komune.

1.2.5. Organizimi i studimit

Organizimi i studimit në terren është bërë me përfshirjen e tri ekipeve të hulumtuesve të IPK-së dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm.

Grupi i parë ka zhvilluar intervistat me përfaqësuesit e nivelit komunal. Organizimi i studimit në nivel komunal është bërë sipas hapave në vijim: janë përgatitur lista me të dhënat e personave që do të përfshihen në studim, janë kontaktuar (me telefon ose email) personat e përzgjedhur për përfshirje në studim, në marrëveshje me respondentët është përcaktuar data dhe ora e realizimit të intervistës, janë realizuar intervistat, janë futur të dhënat e intervistave në programin për përpunim dhe analizë, janë analizuar të dhënat e intervistave, janë përcaktuar temat kryesore që janë prekur më së shumti gjatë intervistave, është përgatitur drafti i raportit, është diskutuar drafti i raportit brenda ekipit hulumtues dhe pastaj është finalizuar, kapitulli III i këtij raporti - rezultatet e studimit në nivel komunal dhe analiza e tyre.

Një rrugë të njëjtë metodologjike kanë ndjekur edhe grupi i dytë dhe i tretë i hulumtuesve, të cilët kanë administruar instrumentet e hulumtimit në nivel të shkollës, përkatësisht kanë organizuar diskutimet me përfaqësuesit e OJQ-ve në shtatë komunat e përfshira në studim.

1.2.6. Analiza e të dhënave

Të dhënat kualitative janë nxjerrë në dy mënyra. Në rastin e parë, është bërë analiza e dokumenteve të konsultuara dhe janë evidencuar, janë shqyrtuar e janë diskutuar ato dhe pastaj janë integruar në raport gjetjet më kryesore të cilat lidhen me tematikat e studimit tonë. Në rastin e dytë, të dhënat kualitative të intervistave janë analizuar dhe janë nxjerrë modele për të arritur përfundime të përbashkëta përkitazi me çështjet specifike.

Të dhënat kuantitative nga pyetësorët janë analizuar me programin kompjuterik Microsoft Office Excel 2007 PivotTable dhe ato janë raportuar dhe janë përmbledhur në aspektin e të dhënave numerike dhe në aspektin e përqindjeve.

1.3. Çështjet etike

Çështjet etike janë marrë për bazë gjatë gjithë kohës së studimit. Fillimisht i është kushtuar kujdes përzgjedhjes së hulumtuesve për përfshirje në faza të hulumtimit, duke marrë për bazë ekspertizën e tyre. Pastaj vendosjen e parimeve etike, si ruajtjen e konfidencialitetit, shpjegimin e qartë të qëllimit dhe të objektivave të studimit, shpjegimin e qartë se si do të përdoren gjetjet/rezultatet etj.

Një aspekti tjetër që i kemi kushtuar kujdes është mbrojtja e fëmijëve. Së pari kemi marrë autorizimin e prindërve për të folur me fëmijë, pastaj

para fillimit të administrimit të pyetësorëve të gjithë fëmijët janë pyetur nëse pajtohen të marrin pjesë në studimin tonë, si dhe i kemi paralajmëruar se mund të tërhiqen nga procesi në çfarëdo kohe.

Gjuhës së komunikimit i kemi kushtuar kujdes të veçantë. Për përfaqësues të komuniteteve kemi siguruar përkthyes dhe kështu respondentët më ndihmën e tyre janë pyetur drejtpërdrejt. Prindërve, të cilët kanë pasur vështirësi në të kuptuarit e koncepteve të temës së studimit, u kemi ndihmuar me thjeshtimin e koncepteve deri në nivelin e të kuptuarit të tyre.

1.4. Sfidat dhe kufizimet

Një prej sfidave kryesore të këtij studimi ka qenë mungesa e përcaktimit/definimit të profilit të fëmijëve jashtë shkolle në kornizën e politikave arsimore dhe në dokumentet zyrtare. Kjo ka bërë që profili i fëmijëve jashtë shkolle të mos kuptohet drejt në mesin e komunitetit arsimor, me të cilin punuam gjatë realizimit të studimit. Në tejkalimin e kësaj sfide, në instrumentet e përdorura gjatë studimit e kemi përshkruar përbërjen e profilit të fëmijëve jashtë shkolles dhe e kemi përsëritur atë, sidomos gjatë intervistave.

Një tjetër sfidë ka qenë identifikimi i fëmijëve jashtë shkolle, duke përfshirë fëmijët braktisës dhe përfshirjen e tyre në intervista, për shkak se studimi në shkolla është kryer gjatë muajit maj, kur shkollat ishin në fazën e fundit të vitit mësimor dhe ka qenë e vështirë të na ndihmojnë në gjetjen e fëmijëve braktisës dhe intervistimin e tyre.

Mungesa e të dhënave statistikore, e dëshmuar në nivel shkolle dhe në nivel komune për fëmijët jashtë shkolle ka qenë një kufizim gjatë studimit, sidomos në fazën e përpunimit të të dhënave dhe në nxjerrjen e përfundimeve dhe të rekomandimeve.

1.5. Përkufizimi i termave kryesorë

Fëmijët jashtë shkolle. Në legjislacionin arsimor dhe në kornizën e politikave arsimore në Kosovë, termi fëmijët jashtë shkolle nuk përmendet në mënyrë specifike, por elementet e tij përfshihen në kuadër të përkufizimit të braktisjes së shkolles. Ky term në Kosovë ka filluar të përdoret kur Kosova iu bashkua Iniciativës Globale “Fëmijët Jashtë Shkolle”, e cila fëmijët jashtë shkolle i kategorizon në pesë dimensioneve: (I) fëmijët e moshës parafillore, të cilët nuk janë përfshirë në edukimin parafillor³; (II) fëmijët të cilët nuk kanë hyrë kurrë në shkollën fillore ose të mesme të ulët; (III) fëmijët të cilët do të hyjnë me vonesë në shkollën fillore ose të mesme të ulët; (IV) fëmijët të cilët kanë braktisur shkollimin fillor ose të mesëm; (V) fëmijët të cilët janë të regjistruar në shkollimin fillor ose të mesëm, por të cilët janë në rrezik të braktisjes.

Braktisje e shkolles nga nxënësit. Varësisht nga karakteristikat e zhvillimit të sistemit arsimor të një vendi, përkufizohet edhe termi “braktisje. Sipas Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011), me braktisje të shkolles konsiderohet vetëm ndërprerja e përkohshme e shkollimit të detyruar, në rastin e Kosovës deri në fund të klasës së nëntë (9). Ndërsa në udhëzimin administrativ (nr. 19/2012) Krijimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar, kemi një përkufizim më gjithëpërfshirës, janë dhënë tri nivele të definimit se kush është braktisës: (I) “braktisës” është ai nxënës, i cili ndërpret shkollimin para përfundimit të arsimit të obliguar me ligj, (II) “braktisës” është ai nxënës i cili edhe pas mbarimit të arsimit të obliguar e vazhdon shkollimin, por e ndërpret atë në një periudhë të mëvonshme, para përfundimit të synuar, dhe (III) “braktisës” është edhe ai fëmijë ose i ri, i cili nuk është regjistruar në shkollë dhe kështu nuk ndjek arsimin e obliguar me ligj. Siç shihet, në këto përkufizime nuk adresohen fëmijët që janë në rrezik për ta braktisur shkollën, edhe pse parandalimi i braktisjes së shkolles është një nga detyrat kryesore të EPRBM-ve.

Arsimi gjithëpërfshirës. Në dokumentin Standardet për Shkollat Mike për Fëmijë (2013), dimensionin i gjithëpërfshirjes pasqyron këtë përkufizim: Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të barabartë për arsim themelor, të obligueshëm dhe cilësor. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të kenë qasje, përkushtim, rritje të pjesëmarrjes dhe cilësi në procesin e mësimin pavarësisht mo-shës, gjinisë, përkatësisë etnike, racore, religjioze, shëndetësore, nivelit shoqëror, ekonomik dhe aftësive e mundësive të fëmijëve. Arsimi gjithëpërfshirës siguron njohje, pranim, mundësi dhe respekt për të gjithë fëmijët.

³ Në rastin e Kosovës, aktualisht fëmijët që nuk janë përfshirë në edukimin parafillor nuk konsiderohen fëmijë jashtë shkolles, sepse ende edukimi parafillor nuk është arsim i detyruar. Nga viti 2015/16 mendohet të bëhet i detyrueshëm dhe atëherë mund të themi se janë apo nuk janë fëmijë jashtë shkolles, fëmijët të cilët nuk bëhen pjesë e edukimit parafillor.

Filozofia e arsimit gjithëpërfshirës përfshin tejkalimin e pengesave në mësim dhe pjesëmarrje, duke shmangur kategorizimin, përjashtimin dhe diskriminimin e fëmijëve/nxënësve duke u bazuar në nevoja të ndryshme arsimore, përmes organizimit të punës së shkollave, qëllimit të shkollimit, planeve dhe programeve mësimore, metodologjive të mësimdhënies, që kanë në qendër të vëmendjes nxënësin. Pra arsimi gjithëpërfshirës shikohet si proces i paraqitjes dhe përgjigjes së diversitetit të nevojave të gjithë nxënësve me anë të rritjes së pjesëmarrjes në procesin e të nxënësve dhe të zvogëlimit të përjashtimit. Arsimi gjithëpërfshirës i mirëpret ndryshimet që kanë nxënësit në të mësuar dhe krijon një mjedis mikpritës për të gjithë fëmijët, duke krijuar tek ata ndjesinë se i përkasin shkollës (M.A. Merita Poni, 2010).

1.6. Përmbledhje e shkurtër e raportit

Raporti përbëhet nga gjashtë kapituj.

Kapitulli i parë është hyrja.

Në kapitullin e dytë pasqyrohen një analizë e shkurtër e politikave arsimore dhe planeve të veprimit që adresojnë gjithëpërfshirjen, me fokus problemet që lidhen me braktisjen e shkollës nga nxënësit. Në këtë kapitull pasqyrohen statistikat e përgjithshme të arsimit të detyruar, duke përfshirë edhe gjetjet nga studimet tjera për braktisjen.

Në kapitullin e tretë paraqiten gjetjet nga studimi në nivel komunal. Në këtë kapitull ofrohen gjetjet për praktikën e adresimit të çështjes së fëmijëve jashtë shkollës dhe parandalimit të braktisjes, me fokus nga: përfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor – klasën parafillore; regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë; të dhënat për fëmijët jashtë shkollës dhe mundësitë e identifikimit; braktisja e shkollës dhe mungesat e nxënësve; ekipi për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar; bashkëpunimi ndërsektorial dhe bashkëpunimi me OJQ-të; gjithëpërfshirja; rekomandimet dhe nevojat për përkrahje të DKA-së dhe EPRBM-ve në nivel komune.

Në kapitullin e katërt ofrohen gjetjet për praktikën e shkollës në adresimin e çështjes së fëmijëve jashtë shkollës dhe parandalimin e braktisjes, me fokus gjetjet nga: shkalla e kënaqësisë së akterëve kryesor të shkollës me rezultatet e punës në shkollë; mungesat e nxënësve në mësim; braktisjen e shkollës; ekipin e shkollës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit (EPRBM); gjithëpërfshirjen (regjistrimi i nxënësve në klasën e parë, bashkëpunimi me OJQ-të dhe institucione të tjera, diskriminimi i nxënësve, përfshirja në shkollë e grupeve të pafavorizuara, plani individual i arsimit, mësimi alternativ dhe mbështetja materiale e fëmijëve të familjeve të varfra) dhe vlerësimi i nevojave të shkollës për mbështetje/përkrahje në adresimin e fëmijëve jashtë shkollës, parandalimin e braktisjes dhe në rrugën e saj drejt shkollave gjithëpërfshirëse.

Në kapitullin e pestë përshkruhen përfundimet dhe rekomandimet.

Në kapitullin e gjashtë ofrohet plani orientues për implementimin e rekomandimeve të dala në bazë të gjetjeve të studimit dhe nevojave të komunave dhe shkollave për mbështetje, në të cilat pritet të kontribuojë Instituti Pedagogjik i Kosovës me mbështetjen e UNICEF-it.



2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Kjo pjesë paraqet:

(I) *Legjislacioni dhe korniza e politikës arsimore në Kosovë për gjithëpërfshirjen në arsim*

(II) *Të dhënat statistikore për përfshirjen e fëmijëve në arsimin bazë*

(III) *Gjetjet nga hulumtimet ekzistuese për braktisjen në Kosovë*

2.1. Legjislacioni dhe korniza e politikës arsimore në Kosovë për gjithëpërfshirjen në arsim

E drejta për arsimim në Kosovë bazohet në dokumentet e të drejtave ndërkombëtare, siç janë: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës.

Zbatimi i drejtpërdrejtë i dokumenteve ndërkombëtare mbi të cilat mbështetet garantimi i të drejtave të njeriut në Kosovë është i potencuar në dokumentin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht në nenin 22 të saj⁴, ndërsa e drejta për arsimim është e veçuar në nenin 47 të këtij dokumenti.⁵

Dokumentet bazë që e rregullojnë arsimin parauniversitar në Kosovë, si Ligji për arsim Parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011) dhe Korniza e Kurrikulës së Arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës (2011), janë të ndërtuara mbi parimin e gjithëpërfshirjes në arsim, që në mënyrë të drejtpërdrejtë i referohet së drejtës së secilit fëmijë dhe të ri për përfshirje të barabartë në arsim cilësor. Në dokumentin Standardet e Shkollave Mike për Fëmijë (2012) dimensionimi i gjithëpërfshirjes është përkufizuar në këtë mënyrë: *Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të barabartë për arsim themelor, të obligueshëm dhe cilësor. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të kenë qasje, përkushtim, rritje të pjesëmarrjes dhe cilësi në procesin e të mësuarit pavarësisht moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, racore, religjioze, shëndetësore, nivelit shoqëror, ekonomik dhe aftësive e mundësive të fëmijëve. Arsimi gjithëpërfshirës siguron njohje, pranim dhe respekt për të gjithë fëmijët.*

Regjistrimi i fëmijëve në edukimin parafillor - ndër vite Kosova ka zhvilluar një sërë politikash ndaj edukimit në fëmijërinë e hershme. Në këtë kontekst, është hartuar një bazë e mirë legjislative, si Ligji për edukimin parashkollor (2006), Standardet e përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor në Kosovë 3-6 vjeç (2006) dhe Kurrikula e edukimit parashkollor në Kosovë 3-6 vjeç (2006). Janë hartuar Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjet dhe janë miratuar zyrtarisht në vitin 2011, duke synuar stimulimin e zhvillimit optimal të fëmijëve, pavarësisht gjinisë, karakteristikave individuale dhe shoqërore, nivelit ekonomik të familjeve të tyre, prirjeve apo nivelit të aftësive. Ky dokument është hartuar me qasje të integruar ndaj zhvillimit në fëmijëri të hershme.

Në *Ligjin për arsim parauniversitar në Republikën e Kosovës*, të miratuar në vitin 2011, edukimi parafillor bëhet i detyrueshëm nga viti shkollor 2015/2016 - siç është paraparë në dispozitat kalimtare (neni 9, pika 2 dhe 3), kjo nënkupton se edukimi parafillor bëhet i detyrueshëm pas analizës dhe sigurimit të qëndrueshëm të burimeve financiare për të siguruar përfshirjen e të gjithë fëmijëve në këtë nivel të edukimit.

⁴ KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS: Të drejtat dhe liritë themelore, Kapitulli II, Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], fq 6

⁵ Po aty, Neni 47 [E Drejta për Arsimin] fq. 14

Regjistrimi/përfshirja e fëmijëve në arsim - është rregulluar me Ligjin për arsim parauniversitar në Republikën e Kosovës, dhe se qasja, përparimi nëpër të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimin parauniversitar mundësohet në pajtim me dispozitat e ligjit, pa diskriminim në baza ekzistuese ose të supozuara (neni 3, pika 6).

Sipas Ligjit për arsim parauniversitar në Republikën e Kosovës, arsimit parauniversitar është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore dhe aftësuese, komunave dhe qeverisë, sipas funksioneve dhe detyrave përkatëse të përcaktuara në këtë ligj. Ligji thekson përgjegjësinë dhe obligimin e institucioneve arsimore dhe aftësuese për akomodimin e të gjithë fëmijëve, pa dallim të kushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo të tjera dhe promovimin e integritetit dhe të kontaktit në mes të fëmijëve, ndërsa vijimi i shkollimit të detyruar nga ana e nxënësit është një përgjegjësi kryesore e prindit, dhe prindi i fëmijës së moshës së shkollimit të detyruar bën shkelje të ligjit nëse: (I) nuk e regjistron fëmijën në shkollë publike, institucion aftësimi, shkollë speciale ose shkollë private të licencuar dhe të përshtatshme për moshën e fëmijës dhe për nivelin e mësimin, ose nuk bën aranzhime alternative për arsimimin e fëmijës me miratim nga Ministria sipas nenit 47 të këtij ligji, ose (II) pa shkak të arsyeshem, si është sëmundja apo ndonjë shkak tjetër i pashmangshëm, nuk i siguron fëmijës vijim të rregullt në institucionin arsimor në kohën e përcaktuar nga këshilli drejtues për fillimin e mësimin. (neni 15, pika 1 dhe 2)

Masat ndaj prindit, fëmija i të cilit pa ndonjë arsye nuk regjistrohet, nuk vijon shkollimin ose e ndërpret shkollimin e detyruar janë të rregulluara me ligj, ku thuhet se prindi dënohet për kundërvajtje, nëse mungesa është rezultat i veprimit të paramenduar ose i neglizhencës së prindërve (neni 15, pika 4).

Ligji gjithashtu rregullon moshën e regjistrimit të fëmijës në arsimin e obliguar, ku mosha minimale për regjistrim në këtë nivel të arsimit është mosha 6-vjeçare (neni 9, pika 2), ndërsa regjistrimi i fëmijës, i cili në kohën e fillimit të vitit shkollor është nën minimumin e moshës së duhur për shkollimin e detyruar e rregullon në bazë të rekomandimit të shërbimit profesional pedagogjik-psikologjik në shkollë dhe vendimin për regjistrim e kalon te drejtori i shkollës (neni 9, pika 6.). Sipas Ligjit për arsim në komuna (2008) është edhe regjistrimi dhe pranimi i nxënësve në pajtim dhe me respektimin e parimeve të mosdiskriminimit sipas ligjit (neni 5, pika b), aspekt ky që ndërlikohet fuqishëm me standardet e dimensionit gjithëpërfshirja të dokumentit Standardet e Shkollave Mike për Fëmijë.

Në vitin 2011 nga MASHT është hartuar udhëzimi administrativ (nr. 9/2011) për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave statistikore nga shkollat dhe institucionet parashkollore në arsimin parauniversitar, duke përdoruar Sistemin për Menaxhimin e Informatave në Arsim (SMIA). Në nivelin e shkollës, është përgjegjësi e drejtorit të shkollës bashkëpunimi me komunën/zyrat për regjistrim civil, për sigurimin e listës së fëmijëve të moshës shkollore të zonës për regjistrim në shkollë.

Sipas ligjit për arsim parauniversitar, MASHT-i duhet të nxjerrë akte nënligjore (nuk janë nxjerrë ende) për regjistrimin, mbajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin e arsimit. Sa i përket mbrojtjes së identitetit të nxënësit, ligji në fjalë rregullon regjistrimin e të dhënave personale, sipas të cilit, të dhënat personale që kanë të bëjnë me përkatësinë etnike e fetare mund të evidencohen vetëm për shkaqe të monitorimit statistikor që ndihmon në promovimin e mundësive të barabarta dhe nuk mund të përdoren për ndonjë qëllim tjetër. Të dhënat e tilla nuk mund të regjistrohen në ndonjë mënyrë përmes së cilës individët mund të identifikohen si të tillë (neni 5, pika 3.3).

Përfshirja në arsim e nxënësve me vështirësi në të nxënë apo me aftësi të kufizuara – është e potencuar mjaft fuqishëm te parimi gjithëpërfshirës i arsimit parauniversitar, të rregulluar përmes Ligjit për arsim parauniversitar në Republikën e Kosovës. Ligji ka të definuar kur një fëmijë mund të quhet dhe trajtohet si fëmijë me vështirësi në mësim dhe sipas ligjit, „fëmija trajtohet si i tillë kur ka vështirësi dukshëm më të mëdha në mësim sesa shumica e fëmijëve të asaj moshe dhe kur ka një paaftësi e cila e ndalon ose e pengon atë nga përdorimi i pajisjeve arsimore të llojit që ofrohen në përgjithësi për fëmijët e moshës së tij në institucionet arsimore apo aftësuese” (neni 39, pika 1.1 dhe 1.2).

Sa i përket përgjegjësive për përfshirje të nxënësve me vështirësi në të nxënë apo me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor, Ligji për arsim parauniversitar në Republikën e Kosovës (neni 39), thekson përgjegjësitë e komunës, e cila, sipas ligjit, ka për obligim që t'i regjistrojë nxënësit me vështirësi në të nxënë apo me aftësi të kufizuara dhe më pas të veprojë sipas procedurave të parapara në nenin 41 të këtij ligji, ku çdo komunë duhet që vetë apo në bashkëpunim me komunat e tjera, të themelojë ekip profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore, i cili, në përputhje me parimet e arsimit gjithëpërfshirës dhe duke pasur parasysh dëshirat dhe opinionet e prindërve, shqyrton dhe përcakton nëse nxënësi ka nevojë për vijimin e shkollimit special dhe çfarë loji i mësimdhënies duhet të ofrohet, (neni 41, pika 1,2, dhe 3).

Përkrahje fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore-pedagogjike për përfshirje dhe vijim të mësimin u siguron Ligji për arsim parauniversitar në Republikën e Kosovës, në të cilin theksohen kompetencat e komunës për sigurimin e transportit për fëmijët me aftësi të kufizuara pa marr parasysh distancën shkollë-shtëpi dhe anasjelltas (neni 14., pika 5.1).

Lidhur me identifikimin dhe përkrahjen e *nxënësve me talent të veçantë*, MASHT-i ka hartuar UA për mundësinë dhe procedurat e realizimit të procesit të avancimit të nxënësve (2011) dhe sipas këtij udhëzimi, të drejtën për avancim e fitojnë: nxënësit me njohuri të përgjithshme dhe me sukses të dalluar; nxënësit me talent në ndonjë lëndë/fushë mësimore; nxënësit me nevoja të veçanta. (neni 3- E drejta për avancim). Edhe ligji për arsim parauniversitar (neni 39, pika 4) ofron mbështetje për nxënësit me talent të veçantë ,dhe sipas tij „Ofrimi i arsimit të posaçëm nuk kufizohet vetëm për fëmijët me vështirësi në mësim, por kjo gjithashtu zbatohet edhe për fëmijët me dhunti të veçanta, të cilët mund të kërkojnë modifikim të modeleve të zakonshme të progresit në sistemin e arsimit të detyruar, përfshirë edhe kurrikulumin”.

Përfshirja e fëmijëve të komuniteteve pakicë në arsimin parauniversitar – përveç se potencohet fuqishëm te parimi gjithëpërfshirës i Ligjit për arsim parauniversitar në Republikën e Kosovës, është e definuar mjaft mirë te përgjegjësitë e Ministrisë, komunave dhe institucioneve arsimore apo aftësuese, të cilat gjatë zbatimit të funksioneve dhe përgjegjësive të tyre marrin parasysh normat e miratuara ndërkombëtare për arsimin për të gjithë, përfshirë edhe mbrojtjen e grupeve të ndjeshme në shoqëri, dhe kanë për obligim të respektojnë dhe të avancojnë të drejtat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre të garantuara në Kushtetutë dhe në ligjet në fuqi (neni 3, pika 4 dhe 5). Sipas Ligjit për arsimin parauniversitar (2011), MASHT-i mban përgjegjësinë kryesore për planifikim, caktim të standardeve dhe sigurim të cilësisë në sistemin e arsimit parauniversitar dhe ndër detyrat bazë të saj është edhe promovimi i sistemit jodiskriminues të arsimit, në të cilin respektohen të drejtat e secilit person për arsim dhe aftësim, si dhe ofrohen mundësi të barabarta për arsim cilësor, promovim i mbrojtjes së grupeve të ndjeshme në kuadër të sistemit të arsimit dhe aftësimit (neni 5, pika 1.3). Ligji në fjalë mbështet gjithëpërfshirjen e komuniteteve edhe nëpërmjet përfaqësimit të prindërve në strukturat udhëheqëse të shkollës, ku sipas ligjit (neni 17, pika 2.1) „nga tre përfaqësues të prindërve sa ka gjithsej këshilli drejtues i shkollës, në këtë këshill duhet përfshirë së paku një përfaqësues i komuniteteve jo shumicë, nëse ka ndonjë nxënësi nga ato komunitete në atë institucion”.

Në mënyrë të veçantë ligjet i kushtojnë rëndësi arsimimit në gjuhën serbe, ku në mënyrë specifike përcaktohen kompetencat që kanë komunat për krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve edukativo-arsimore në gjuhën serbe (Ligji për arsim në komunat e Republikës së Kosovës, neni 12, fq. 6).

MASHT-i në përkrahje të përfshirjes në arsimin parauniversitar të gjithë fëmijëve në Kosovë, duke përfshirë edhe fëmijët e komuniteteve pakicë, me Ligjin për arsimin parauniversitar në Kosovë (neni 14.4 fq. 12), komunat i përcakton përgjegjëse për ofrimin e kushteve alternative për shkollim të gjithë fëmijëve, pra edhe fëmijëve të komuniteteve pakicë. si p.sh. transportin e subvencionuar deri në vendin ku ofrohet shkollimi ose themelimin e paraleleve të ndara në zonat në të cilat nuk ka shkolle

amë. Këto masa vlejnë veçanërisht për nxënësit që flasin gjuhë jozyrtare në shkallë vendi apo gjuhë zyrtare në nivel komune⁶ dhe që jetojnë në një zonë të mbulimit ku nuk arrihet minimumi i nxënësve⁷ për hapjen e klasave apo të shkollave në arsimin e detyruar.

Sa i përket mësimin të gjuhës shqipe nga nxënësit joshqiptarë, në të njëjtin vit MASHT-i ka nxjerrë UA për zbatimin e planit dhe të programit të gjuhës shqipe për nxënësit e komuniteteve joshqiptare në klasat 3,4,5,8,9,12 dhe 13, ndërsa për mësimin e gjuhës amtare nga nxënësit e komunitetit në vitin 2010 MASHT-i ka nxjerrë UA- *Zbatimi i planit dhe programit të rishikuar për lëndën: gjuha rome me elementet e kulturës dhe historisë*.

Në vitin 2007 MASHT-i me përkrahjen e OSBE-së dhe të KFOS-it ka hartuar *Strategjinë për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, komponenta e edukimit 2007-2017*. Objektivat strategjike të këtij dokumenti janë: (I) përmirësimi domethënës i pjesëmarrjes në arsim dhe i cilësisë së arsimit për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian; (II) parandalimi i diskriminimit dhe segregacionit në sistemin e arsimit; (III) bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes të institucioneve dhe të organizatave relevante në funksion të arsimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian; (IV) ndërgjegjësimi i komuniteteve dhe i palëve me interes për të ndihmuar arsimimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Adresimi i fëmijëve braktisës dhe braktisës potencialë të shkollimit në arsimin parauniversitar në Kosovë. Për përmirësimin e këtij aspekti, MASHT-i ka hartuar bazë legislative, përfshirë ligje, strategji dhe dokumentacion shoqërues mbështetës. Në aspektin e përkrahjes së fëmijëve që janë jashtë sistemit të arsimit, Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës ka qartësuar detyrat dhe përgjegjësitë për të gjithë për sigurimin e mësimin alternativ, shkollimit në shtëpi, arsimit privat, arsimit me nevoja të veçanta etj. dhe siguron qasje pa dallim të gjithë fëmijëve në sistemin arsimor. Aspekti i zbatimit në praktikë është adresuar në PSAK 2011-2016.

Plani kombëtar i veprimit kundër braktisjes së shkollës 2009-2014 i miratuar nga MASHT-i është një dokument, i cili synon të adresojë në mënyrë më të plotë dukurinë e braktisjes së shkollës. Në dokument janë përfshirë gjashtë objektiva, të cilët duhet të arrihen deri në vitin 2014. Secili objektivi strategjik i Planit kombëtar të veprimit kundër braktisjes së shkollës ka aktivitetet kryesore, pastaj për secilin aktivitet janë të përcaktuara institucionet përgjegjëse realizuese, partnerët, afatet kohore, burimet e financimit, treguesit dhe mekanizmat e monitorimit dhe të vlerësimit.

Përkundrajt një plani mjaft ambicioz për parandalimin e braktisjes, zbatimi i tij në praktikë nuk është duke ecur sipas afateve kohore të parapara në të. Sa për ilustrim po veçojmë disa aktivitete, të cilat kanë qenë të parapara të përmbushen në vitin 2009 dhe nuk janë përmbushur: emërimi i një zyrtari në MASHT për çështjen e braktisjes së shkollës; hartimi i udhëzimit administrativ për rishikimin e formularit për transferim të nxënësve nga një shkollë në shkollën tjetër dhe përcaktimi i masave ndëshkuese në rastet e braktisjes. etj.

Një ndër dokumentet që MASHT-i ka hartuar dhe që në mënyrë më të fuqishme adreson aspekte dhe masa për parandalimin e braktisjes është Udhëzimi Administrativ nr.19/2012 Themelimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në arsimin e obliguar. Ky udhëzim përcakton parimet e përgjithshme, përgjegjësitë dhe procedurat për krijimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar etj. dhe synon: *(I) nxitjen e komunikimit brenda dhe jashtë shkollës, në mes të nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve, nga njëra anë, dhe nxitja e komunikimit dhe bashkëpunimit me institucionet/organizatat jashtëshkollore në mes të fëmijëve, të rinjve dhe familjeve të tyre, nga ana tjetër, me synimin e zvogëlimit, të parandalimit të braktisjeve të shkollimit, si dhe me synimin e*

⁶ Sipas Kushtetutës së Kosovës (neni 5) gjuhë zyrtare në shkallë vendi janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe, ndërsa gjuhë zyrtare në nivel komune janë edhe gjuha turke, boshnjake dhe gjuha rome.

⁷ Numri minimal i hapjes së një klase për nxënësit e komuniteteve pakicë është 5 nxënës. Numri minimal i nxënësve në klasë është i përcaktuar me udhëzimin administrativ 18/2009 (datë 28.08.2009) Udhëzimi Administrativ: Raporti nxënës – mësimdhënës....., numri i nxënësve për paralele.

rritjes së numrit të regjistrimit të fëmijëve dhe të rinjve në shkollë dhe (II) zhvillimin e një strategjie në nivel shkollë, si dhe një plani pune kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve dhe të rinjve në shkollë.

MASHT-i ka nxjerrë edhe udhëzime administrative dhe vendime të veçanta për parandalimin e braktisjes. Udhëzimi Administrativ nr. MASHT [I] 13/2005: Masat ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar apo nuk vijnë në mësimin e obliguar, reflekton në parandalimin e braktisjes. Në bazë të këtij udhëzimi përcakton masat ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar apo nuk vijnë në mësimin e obliguar. Edhe pse udhëzimi është nxjerrë në vitin 2005, nuk ka të dhëna që janë ndërmarrë masa ndaj prindërve fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar në shkollë, apo që e kanë ndërprerë shkollimin, kurse numri i nxënësve që braktisin shkollimin është rritur.

Dokumente të tjera të hartuara nga MASHT-i për këtë aspekt janë edhe UA - Dokumentacioni shkollor parauniversitar (2012) që rregullon përmbajtjet në ditarin e klasës: rubrika të veçanta për braktisjen nga shkolla përmbajnë emrin dhe mbiemrin e nxënësit, gjininë, vitin shkollor dhe arsyen e braktisjes, UA - Kalimi i nxënësve të shkollës së mesme të lartë prej profilit arsimor në tjetrin ose prej një shkolle në tjetrën (2012), që rregullon të drejtat, obligimet, kriteret dhe procedurat e kalimit të nxënësit të shkollës së mesme të lartë prej profilit arsimor në tjetrin ose prej një shkolle në tjetrën; UA - Mbledhjen dhe raportimin e të dhënave statistikore nga shkollat përmes SMIA-s (2011); UA - Formimi i paraleleve të ndara.(në rastin kur largësia për udhëtim me më shumë se dhjetë km në një drejtim për të ndjekur procesin mësimor (2012), Planin kombëtar kundër braktisjes së shkollës 2009-2014, doracaku "Përsëri në shkollë", "Doracaku për mësimdhënësit "Adresimi i refuzimit dhe braktisjes së shkollës" etj.

Përveç Strategjisë për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2007/2017, PSAK 2011-2016, MASHT-i ka hartuar edhe *Strategjinë për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë 2007/2017*. Strategjia e veçantë për integrimin e komuniteteve në arsim është bërë për shkak të pjesëmarrjes jo të kënaqshme të tyre në sistemin arsimor. Përkundër faktit se strategjia është miratuar në vitin 2007, braktisja e shkollës nga nxënësit RAE është shumë e lartë, integrimi i nxënësve që kanë braktisur shkollën në shkollimin e rregullt është minimal.

MASHT-i në bashkëpunim me partnerë ka ndërmarr nismën për kthimin e nxënësve braktisës në shkollim, si nisma "Fëmijët jashtë shkolle"- MASHT- UNICEF, qëllimi së cilës është zvogëlimi i numrit të fëmijëve që janë jashtë sistemit shkollor, çështje kjo e cila është edhe njëri nga prioritetet për realizimin e qëllimeve të Arsimit për të Gjithë, por edhe të Synimeve të Mijëvjeçarit.

Në vitin 2011/2012, MASHT-i me mbështetje të GIZ/GOPA, në kuadër të programit „Zhvillimi i kapaciteteve në sektorin e arsimit fillor në Kosovë” ka arritur një memorandum mirëkuptimi mbi bashkëpunimin e vazhdueshëm për përkrahjen dhe ngritjen e cilësisë së arsimit fillor në Kosovë. Në kuadër të projektit, gjatë kësaj periudhe, në 6 komuna pilot të Kosovës është ofruar mësim kompensues (për klasat 1-5 dhe 6-9) për nxënësit deri në moshën 25-vjeçare, që më herët e kanë braktisur shkollimin, të cilat programe kanë pasur për synim rikthimin e tyre në shkollimin e rregullt, ose ofrimin e certifikimit të barasvlershëm me ato të arsimit formal për të rinjtë.⁸

Në përgjithësi, zbatimi i politikave arsimore dhe i planeve dhe i programeve të veprimit për parandalimin e braktisjes nuk kanë treguar rezultate të qëndrueshme, meqenëse kanë munguar masa mbështetëse të vazhdueshme për nxënësit dhe shkollën ku ata janë integruar (mësimdhënësit, nxënësit, prindërit etj.), prandaj edhe shkalla e braktisjes së shkollimit është në trende afërsisht të njëjta me rritje të vogla në disa gjenerata, siç do të shihet në treguesit statistikorë. Në përgjithësi, mungojnë aktivitete informuese dhe senzibilizuese përkitazi me kthimin e nxënësve në shkollë, ekipet për parandalimin e braktisjes nuk janë ende plotësisht funksionale për të ndikuar në përmirësimin e kësaj dukurie, shkollat nuk kanë plane konkrete për reagim ndaj braktisjes etj.

⁸ MASHT: Memorandumi i mirëkuptimit mbi bashkëpunimin e vazhdueshëm për përkrahjen dhe ngritjen e cilësisë së arsimit fillor në Kosovë, gjatë fazës së parë të programit CDBE, tetor, 2011. Programi CDBE pritet të zgjatë deri në vitin 2017.

Sipas raporteve të zyrës për bashkëpunim me prindër në MASHT, vendimi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore në arsimin e obligueshëm – klasa 9 siguroi mbështetje të madhe për të gjithë nxënësit në Kosovë, veçmas për nxënësit, familjet e të cilëve janë në gjendje të rëndë sociale.

Barazia gjinore. Edhe aspektet e barazisë gjinore janë të rregulluar me Ligjin për barazi gjinore (2004), qëllimi i të cilit është mbrojtja, trajtimi dhe vendosja e barazisë ndërmjet gjinive si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë së Kosovës, me mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe të meshkujve dhe për kontributin e tyre në zhvillimin politik, ekonomik, social, kulturor dhe në të gjitha fushat e jetës shoqërore (neni 1, pika 1.1). Me barazi gjinore ligji nënkupton pjesëmarrje të barabartë të femrave dhe të meshkujve në të gjitha fushat e jetës, pozitë të barabartë, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjithat të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në zhvillimin e shoqërisë si dhe të kenë përfitim të barabartë nga arritjet e këtij zhvillimi (neni 2, pika 2.1).

Edhe në dokumentin e PSAK-ut 2011/2016 prezantohet qasja e respektimit të barazisë gjinore në arsim, ku thuhet se cilësia e shkollimit të vajzave është një nga pikat e përqendrimit të përpjekjeve të autoriteteve arsimore me qëllim të përmirësimit të ngritjes së shkallës së shkollimit të vajzave në arsimin e mesëm dhe në atë terciar, sidomos për vajzat nga familjet më të varfra. Strategjia parasheh veprim përkrahës për shkollimin e vajzave nëpërmjet bursave (sidomos për të varfërit) dhe masa të tjera të ngjashme që mëtojnë eliminimin e pengesave dhe të paragjykimeve ndaj arsimimit të vajzave. Kërkohet edhe trajtimi me përparësi i çështjeve gjinore në arsim përmes programeve të aftësimit për të gjithë mësimdhënësit me qëllim të krijimit të kushteve që më shumë vajza të vijojnë mësimin dhe studimet në fushat lëndore të matematikës, shkencave dhe të teknologjisë.

Parandalimi i diskriminimit në arsim - është i potencuar në politikat arsimore që rregullojnë sistemin arsimor të Kosovës, në veçanti Ligji kundër diskriminimit e mbështet dhe e rregullon këtë aspekt dhe ka për qëllim parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, ngritjen e shkallës së barazisë efektive dhe realizimin e parimit të tra-

jtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës para Ligjit, përfshirë edhe komponentën e edukimit. Gjithashtu, Protokoli për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar rregullon në mënyrë mjaft afirmative menaxhimin e dhunës, identifikimin e referimin e fëmijëve viktime të abuzimit dhe të pambrojtur.

Pastaj udhëzimet e ndryshme administrative që specifikojnë disa lloje të diskriminimit, Kodi i etikës për mësimdhënësit, rregulloret e ndryshme të shkollave, po ashtu edhe dokumenti - Protokoli për parandalimin e dhunës në shkolla synon të adresojë çështjet e dhunës në shkolla dhe shkeljen e të drejtave

Në funksion të parandalimit të diskriminimit të nxënësve nga mësimdhënësit është edhe dokumenti i Standardeve të vlerësimit të nxënësve, i cili përcakton kriteret për vlerësimin e arritjeve të nxënësve gjatë shkollimit, ku me këto kriteret përcaktohet saktë se si mësimdhënësit të jenë të drejtë, koherentë dhe transparentë në vlerësim.

Përfshirja e popullatës rurale në sistemin arsimor të Kosovës – gjen mbështetje kryesisht në Ligjin për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, si dhe në Strategjinë e arsimit të popullsisë rurale në Kosovë 2004-2009. Sipas rezultateve të SWOT-it analizës së bërë gjatë hartimit të Strategjisë së arsimit të popullsisë rurale në Kosovë 2004-2009, është vlerësuar që në Kosovë 60% e popullsisë jeton në zonat rurale. Një prej prioriteteve të qeverisë është që të përkrahët zhvillimi rural dhe, përmes modernizimit dhe zgjerimit të bujqësisë dhe ekonomisë rurale, të ofrohen punësim dhe mjete të qëndrueshme jetese për popullsinë rurale. Arsimi i obliguar dhe trajnimet për shkathtësi janë paraparë si elemente kyçe në mundësimin e zgjerimit të aktiviteteve të popullatës rurale dhe

gjetjen e bazave për zhvillim të qëndrueshëm në zonat e largëta dhe ato rurale⁹.

Perspektiva e gjithëpërfshirjes së fëmijëve në arsimim nga këndvështrimi i politikave arsimore- përmbledhje e shkurtër. Legjislacioni dhe korniza e politikës arsimore në Kosovë, përkatësisht infrastruktura ligjore dhe dokumentet strategjike të gjithëpërfshirjes së fëmijëve në arsimim marrin parasysh normat e miratuara ndërkombëtare për arsimin për të gjithë, të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen e grupeve të ndjeshme në shoqëri dhe avancimin e barazisë gjinore e diversitetit kulturor.

Në planet dhe programet mësimore ekzistuese gjithëpërfshirjen e gjejmë si element e jo si tërësi, sepse atë ndonjëherë mund ta gjejmë si qëllim, si objektiv të ndonjë lënde mësimore, ndonjëherë si përmbajtje apo si udhëzim metodologjik që promovon llojllojshmërinë e metodave të mësimnxënies. Ndërsa sa i përket politikave kurrikulare të miratuara, si Korniza e Kurrikulës së Kosovës (2011), Kurrikulat Bërthamë (2012), aspektet e gjithëpërfshirjes²³ janë shumë më të theksuara e të prezantuara si parime, si kompetencë - rezultate (në fusha kurrikulare dhe shkallë kurrikulare), si koncept, si çështje ndërprogramore, si qasje e planifikimit, e mësimdhënies, të nxënimit dhe vlerësimit.

Edhe pse legjislacioni dhe korniza e politikës arsimore në Kosovë kanë elemente mjaft relevante për temën e studimit tonë, disa fusha të tyre duhet të forcohen, veçanërisht aspektet që lidhen me identifikimin, referimin dhe menaxhimin e fëmijëve të pambrojtur dhe aspektet që lidhen me adresimin e çështjes së fëmijëve jashtë shkolle.

Sistemi aktual i evidencimit të nxënësve që braktisin shkollën ndjek një qasje nga poshtë-lart. Nxënësit që braktisin shkollën evidentohen fillimisht nga shkollat, pastaj të dhënat për numrin e nxënësve braktisës përcillen në nivel komunal dhe në sistemin e SMIA-s. Sistemi i SMIA-s grumbullon vetëm të dhënat e numrit të nxënësve, nuk ka të dhëna me emra të fëmijëve që janë në sistem të shkollimit apo të atyre që kanë braktisur shkollën. Duke pasur parasysh se këtë sistem e shfrytëzon edhe niveli komunal, nënkuptohet se as në këtë nivel të arsimit nuk ruhet një data bazë me emra të fëmijëve që kanë braktisur shkollën.

Ndërsa evidencimi në nivel shkolle nxënësve që braktisin shkollën bëhet me të dhëna të plota për fëmijën, në bazë të disa specifikave të ditarit të klasës. Ndërkaq shkollat raportojnë të dhënat me emra të fëmijëve që kanë braktisur shkollën, vetëm nëse u kërkohet në mënyrë të veçantë nga niveli komunal (DKA) apo niveli qendror (MASHT).

2.2. Treguesit statistikore për përfshirjen e fëmijëve në arsimin bazë

2.2.1. Edukimi parashkollor dhe parafillor (5 – 6 vjeç)

Analiza e statistikave për regjistrimin e fëmijëve në edukimin parashkollor (5-6 vjeç) dhe parafillor tregon se regjistrimi i fëmijëve në këtë nivel të edukimit ndryshon nga viti në vit dhe se trendi i regjistrimit shënon një rritje relativisht të vogël nga viti në vit. Analiza e raporteve statistikore për regjistrimin e fëmijëve në edukimin parashkollor (mosha 5-6 vjeç) nga viti shkollor 2004/2005 deri në vitin shkollor 2011/2012 vërteton se brenda këtyre viteve 17% është rritur përfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor, përkatësisht rreth 2.5% në çdo vit.

Rezultatet e analizës tregojnë se në vitin shkollor 2004/2005 kishte 18018 fëmijë të përfshirë në edukimin parashkollor (klasa parashkollore dhe klasa parafillore - mosha 5-6 vjeç) ose 60% e fëmijëve të regjistruar në klasën e parë nga kjo gjeneratë, kurse në vitin shkollor 2011/2012 në edukimin parashkollor dhe parafillor janë regjistruar 21874 fëmijë ose 77.30% e fëmijëve të kësaj gjenerate që një vit më vonë u regjistruan në klasën e parë.

⁹ Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë & Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (2004): Strategjia e arsimit të popullsisë rurale në Kosovë 2004-2009, fq. 3.

2.2.2. Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët

Grumbullimi i të dhënave statistikore për fëmijët jashtë shkollë ka qenë një sfidë e madhe për ekipin hulumtues, meqë SMIA-ja nuk nxjerrë tregues të veçantë për fëmijët jashtë shkolle. Kjo do të thotë se në fokus të kësaj pjese nuk do të jetë ofrimi i të dhënave për të gjitha kategoritë e fëmijëve jashtë shkolle, por do të jenë vetëm të dhënat statistikore për fëmijët/nxënësit që janë regjistruar në arsimin fillor apo të mesëm të ulët por nuk janë në sistem të shkollimit për shkaqe të ndryshme, si braktisje të shkollës, ndërprerje e shkollimit, migrim jashtë vendit, lëvizje brenda vendit etj.

Analiza e treguesve statistikore për fëmijët/nxënësit që nuk janë në sistem të shkollimit është bërë në referim të të dhënave statistikore nga raportet e njësisë së SMIA-s për vitet shkollore 2004/2005 – 2012/2013. Për analizë në fazën e parë kemi marrë raportet statistikore të numrit të nxënësve që janë regjistruar në klasën e parë në vitin shkollor 2004/2005 dhe i kemi krahasuar me raportet statistikore për numrin e nxënësve të gjeneratës së njëjtë që në vitin shkollor 2012/2013 ishin në klasën e nëntë. Numri i fëmijëve/nxënësve që nuk janë në sistem të shkollimit nga kjo gjeneratë është relativisht i madh, mbi 12%.

Tabela në vijim pasqyron numrin e nxënësve sipas komunave dhe numrin e nxënësve në shkallë vendi, të regjistruar në klasën e parë – në vitin shkollor 2004/2005, numrin e nxënësve të gjeneratës së njëjtë që në vitin shkollor 2012/2013 ishin në klasën e nëntë, si dhe ndryshimin në numër të nxënësve nga kjo gjeneratë.

Tabela 1. Raporti i ndryshimit të numrit të nxënësve të gjeneratës së njëjtë që në vitin shkollor 2004/2005 ka qenë në klasën e parë, ndërsa në vitin shkollor 2012/2013 është në klasën e nëntë.

| Komunat | Klasa I – viti shkollor 2004/2005 | Klasa IX – viti shkollor 2012/2013 | Ndryshimi | % |
|-------------------------|-----------------------------------|------------------------------------|------------------|--------------|
| Fushë- Kosovë | 594 | 619 | 25 ¹⁰ | 4.04 |
| Obiliq | 379 | 349 | -30 | 8.6 |
| Malishevë | 1640 | 1248 | -392 | 31.41 |
| Klinë | 973 | 862 | -111 | 12.88 |
| Istog | 921 | 819 | -102 | 12.45 |
| Pejë | 1842 | 1723 | -119 | 6.91 |
| Ferizaj | 2284 | 2089 | -195 | 9.33 |
| Në shkallë vendi | 36129 | 32101 | -4028 | 12.55 |

Tabela nr. 1 tregon se numri i nxënësve të regjistruar në klasën e parë në vitin shkollor 2004/2005 me numrin e nxënësve të së njëjtës gjeneratë që në këtë vit shkollor (2012/2013) janë në klasën IX është zvogëluar për 4028 nxënës¹¹ ose mbi 12 %. Sipas statistikave numri më i madh i nxënësve të komunave të përfshira në studim që nuk janë të regjistruar në sistem të shkollimit (ose që kanë emigruar), janë nga Malisheva (31.41%), Klina (12.88%) dhe Istogu (12.45%).

Ndërkaq kur numrin e nxënësve të klasës së nëntë të këtij viti shkollor e kemi krahasuar me numrin e nxënësve të vitit shkollor (2005/2006), kur kjo gjeneratë ka qenë në klasën e dytë, mësojmë se menjëherë në klasën e dytë nuk janë regjistruar 2117 nxënës ose 6.22% e të gjithë nxënësve të regjistruar në klasën e parë. Ne supozojmë se ky ndryshim kaq i madh i numrit të nxënësve që nuk janë regjistruar nga klasa e parë në klasën e dytë, mund të jetë për dy arsye: (I) është rritur artificialisht numri i nxënësve për të krijuar vende pune më shumë, meqë është klasë fillestare e arsimit fillor dhe me këtë numër mund të jenë mbajtur në sistem së paku 64 mësues klasorë; ose (II) një numër i nxënësve janë regjistruar pa e mbushur moshën e regjistrimit dhe gjatë vitit shkollor janë ndalur nga

¹⁰ Ndryshimi në komunën e Fushë-Kosovës është pozitiv, pasi në këtë komunë është një koncentrim i madh i vendosjes së popullsisë nga rajone të ndryshme të Kosovës dhe Luginës së Preshevës.

¹¹ Në këtë numër të nxënësve përfshihen të gjithë ata nxënës që janë regjistruar në klasën e parë në vitin shkollor 2004/2005 dhe që tash nuk janë në asnjë nga shkollat e Kosovës, d.m.th. janë fëmijë që kanë braktisur shkollën dhe më asnjëherë nuk janë regjistruar në shkollë, apo janë fëmijë që kanë migruar jashtë vendit, por nuk janë raportuar se atje ku kanë migruar vazhdojnë shkollimin etj.

prindërit për të vazhduar serish në vitin vijues, apo ka pasur një migrim të theksuar në këtë vit, apo raste të vdekjes së një numri të fëmijëve. Kërkohet një studim i veçantë për të vërtetuar dy supozimet tona.

Në analizën tjetër krahasuese (prezantohet në tabelën nr.2) që i kemi bërë raporteve statistikore të SMIA-së për të njëjtën gjeneratë të nxënësve, kemi vërtetuar se numri i nxënësve që janë regjistruar në klasën e dytë (34012 nxënës të regjistruar) dhe nuk kanë vazhduar shkollën deri në përfundim të klasës së pestë është shumë më i vogël (328 nxënës) se numri i nxënësve të së njëjtës gjeneratë që nuk e kanë vazhduar shkollimin nga klasa VI deri në klasën IX, sepse statistikat tregojnë se nga kjo gjeneratë janë regjistruar në klasën VI 33684 nxënës, mirëpo nuk e kanë vazhduar shkollimin apo nuk janë në sistem të shkollimit nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë 1583 nxënës.

Në bazë të analizës së raporteve statistikore të njësisë së SMIA-s për vitin 2011/2012 dhe 2012/2013, shohim se nga numri total i fëmijëve/nxënësve që ishin të regjistruar në klasën e tetë (8) në vitin shkollor 2011/2012, 706 prej tyre nuk janë në sistem të shkollimit në klasën e nëntë (9) në vitin shkollor 2012/2013. Kjo tregon se numri i nxënësve që mbesin jashtë sistemit të shkollimit (duke përfshirë edhe emigrimin) nga klasa e tetë në klasën e nëntë është më i lartë së ndërmjet klasës së 6 në klasën e 7 apo ndërmjet klasës së 7 në klasën e 8.

Tabela në vijim i pasqyron ndryshimin e numrit të nxënësve të gjeneratës së njëjtë kur ishte në klasën e dytë, përkatësisht në klasën e gjashtë me numrin e nxënësve në klasën e nëntë.

Tabela 2. Raporti i ndryshimit të numrit të nxënësve të klasës IX (2012/2013) me klasën II (2005/2006) dhe klasën VI (2009/2010).

| Komunat | Klasa II ¹² – viti shkollor 2005/2006 | Klasa IX – viti shkollor 2012/2013 | Ndryshimi | % | Klasa VI – viti shkollor 2009/2010 | Klasa IX – viti shkollor 2012/2013 | Ndryshimi | % |
|-------------------------|--|------------------------------------|------------------|-------------|------------------------------------|------------------------------------|--------------|-------------|
| Fushë -Kosovë | 558 | 619 | 61 ¹³ | 9.85 | 624 | 619 | -5 | 0.81 |
| Obiliq | 390 | 349 | -41 | 11.75 | 386 | 349 | -37 | 10.6 |
| Malishevë | 1446 | 1248 | -198 | 15.87 | 1330 | 1248 | -82 | 6.57 |
| Klinë | 919 | 862 | -57 | 6.61 | 902 | 862 | -40 | 4.64 |
| Istog | 815 | 819 | 4 | 0.49 | 876 | 819 | -57 | 6.96 |
| Pejë | 1814 | 1723 | -91 | 5.28 | 1746 | 1723 | -23 | 1.33 |
| Ferizaj | 2175 | 2089 | -86 | 4.12 | 2105 | 2089 | -16 | 0.77 |
| Në shkallë vendi | 34012 | 32101 | -1911 | 5.95 | 33684 | 32101 | -1583 | 4.93 |

Në një analizë tjetër krahasuese që i kemi bërë numrit të nxënësve të klasave III-IX të vitit shkollor 2012/2013 me numrin e nxënësve në vitet shkollore kur nxënësit e gjeneratës (2012/2013) ishin të regjistruar në klasën e dytë, mësojmë se në përgjithësi trendi i numrit të nxënësve që janë jashtë sistemit të shkollimit nga e njëjta gjeneratë është në rritje nga viti në vit, sepse në çdo vit shkollor mesatarisht 315 nxënës dalin jashtë sistemit të shkollimit. Kështu klasa e 9-të e vitit shkollor 2012/2013 ka humbur më së shumti nxënës, sepse nga kjo gjeneratë mungojnë 1911 nxënës nga sistemi i shkollimit, kur krahasohen me numrin e nxënësve të kësaj gjenerate, të cilët në vitin shkollor 2005/2006 ishin në klasën e 2-të. Klasa e 7-të e vitit shkollor 2012/2013 radhitet e dyta që ka humbur me shumë nxënës (1586 nxënës) që nga viti i regjistrimit të kësaj gjenerate në klasën e 2-të (viti shkollor 2007/2008), më shumë se klasa e 8-të, edhe pse klasa e 8-të ka një vit shkollor më shumë. Tabela në vijim i pasqyron këto ndryshime.

¹² Analizën e raporteve e filluam nga klasa e dytë, sepse raportet statistikore ndërmjet klasës së parë dhe klasës së dytë nuk pasqyronin tregues realë të ndryshimit të numrit të nxënësve ndërmjet këtyre dy klasave.


¹³ Ndryshimi në komunën e Fushë-Kosovës është pozitiv, pasi që në këtë komunë është një koncentrim i madh i vendosjes së popullsisë nga rajone të ndryshme të Kosovës dhe të Luginës së Preshevës

Tabela 3. Raporti i ndryshimit të numrit të nxënësve të klasave (III-IX) të këtij viti shkollor (2012/2013) me numrin e nxënësve të këtyre gjeneratave të regjistruara në klasë II

| Vitet shkollore | “Numri i nxënësve të regjistruar në klasën e dytë” | Numri i nxënësve të kësaj gjenerate ne këtë vit shkollor (2012/2013) | “Ndryshimi në numër të nxënësve” | % |
|-----------------|--|--|----------------------------------|-------------|
| 2005/2006 | 34012 | 32101 (klasa 9) | -1911 | 5.62% |
| 2006/2007 | 31188 | 30088 (klasa 8) | -1100 | 3.53% |
| 2007/2008 | 37453 | 35867 (klasa 7) | -1586 | 4.24% |
| 2008/2009 | 37146 | 36604 (klasa 6) | -542 | 1.46% |
| 2009/2010 | 34127 | 33497 (klasa 5) | -630 | 1.85% |
| 2010/2011 | 30858 | 30526 (klasa 4) | -332 | 1.08% |
| 2011/2012 | 29761 | 29460 (klasa 3) | -301 | 1.02% |
| Totali | 234545 | 228143 | -6402 | 2.73 |

Figura në vijim paraqet përqindjen e nxënësve, që sipas viteve të regjistrimit në klasën e dytë nuk e kanë vazhduar shkollimin në vitet vijuese - deri në këtë vit shkollor (2012/2013).

Figura 1. Raporti i përqindjes së nxënësve që sipas viteve të regjistrimit në klasën e dytë të vitit shkollor 2005/2006 nuk e kanë vazhduar shkollimin në vitet vijuese - deri në këtë vit shkollor (2012/2013).



Grafiku tregon një trend të zvogëlimit të numrit të nxënësve që nga viti në vit kanë mbetur jashtë shkollimit. Mirëpo, pavarësisht trendit të zvogëlimit të numrit të nxënësve që janë jashtë shkolle për shkak të braktisjes dhe migrimit (por që nuk ka të dhëna për përfshirje në shkollat e vendeve ku familjet e tyre kanë migruar), situata mbetet e ndjeshme sepse fjala është për 6402 fëmijë që në shtatë vitet e fundit nuk janë në sistem të shkollimit të obligueshëm dhe për të cilët nuk ka informata se ku janë, sepse nuk ka sistem të qëndrueshëm të monitorimit dhe raportimit të lëvizjes së nxënësve.

2.3. Studimet për braktisjen e shkollës në Kosovë

Braktisja e shkollimit në Kosovë është dukuri mjaft e shprehur dhe e ndjeshme. Për t'u njohur dhe për të plotësuar më mirë këtë fushë në kuadër të studimit Praktikant e adresimit të fëmijëve jashtë shkollës dhe parandalimit e reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, shfletuam dhe hulumtuam dokumentet dhe materialet e tjera në të cilat është trajtuar braktisja. Pothuajse në të gjitha studimet dhe hulumtimet e kësaj natyre të bëra deri sot në Kosovë, braktisja paraqitet si dukuri e dëmshme shoqërore, sidomos për brezin e ri, edhe pse nuk hasim në ndonjë hulumtim më specifik sa i përket profilit të fëmijëve jashtë shkolle.

Të dhënat e marra nga MASHT-i dhe nga studime të tjera tregojnë se përqindja e braktisjes rritet në varësi me nivelin e shkollimit. Frekuencën më të lartë të braktisjes në arsimin e detyrueshëm e hasim në arsimin e mesëm të ulët, përkatësisht në klasën e 9-të, “megjithëkëtë, nuk ka një tendencë konstante të braktisjeve pasi që ato ndryshojnë në bazë të kohës, gjinisë dhe përkatësisë etnike.(...) Arsyet kryesore të braktisjeve të konstatuara në botimet e tjera të viteve të fundit në nivel fillor dhe atë të mesëm në Kosovë janë: *niveli i ulët i të ardhurave familjare, distanca e madhe prej shtëpisë në shkollë, sidomos mungesa e transportit, nevoja familjeve për ndihmën e fëmijëve dhe besimi se fëmijët nuk mund të kenë kurrfarë dobie prej shkollimit.*¹⁴

Sipas studimit të zhvilluar në vitin 2004 nga UNICEF-i dhe MASHT-i¹⁵, shkaqet kryesore që ndikojnë në braktisje të shkollës janë: (I) gjendja e vështirë ekonomike; (II) mungesa e dëshirës nga ana e fëmijëve dhe (III) punësimi i hershëm i fëmijëve dhe i të rinjve.

Në vitin 2008 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë në bashkëpunim me Ekipin Koordinues të Projektit PPPA II¹⁶ dhe me financim të Bankës Botërore realizoi studimin: “Braktisja e shkollës nga nxënësit në Kosovë”. Në këtë studim janë përmbledhur të dhëna për çështjet që lidhen me braktisjen, faktorët që ndikojnë në braktisje dhe rekomandimet përkitazi me parandalimin e braktisjes së shkollës nga nxënësit. Hulumtimi është shtrirë në pesë komuna të Kosovës. Është hartuar raporti i hulumtimit dhe është shpërndarë në institucione të ndryshme arsimore. Plani kombëtar i veprimit kundër braktisjes së shkollës 2009-2014, doli si rezultat i këtij hulumtimi, ku sipas këtij hulumtimi janë identifikuar këta faktorë të braktisjes¹⁷:

Në vitin 2010, Instituti Pedagogjik i Kosovës, në mbështetje të Fondacionit Evropian për Trajnime (ETF), realizoi hulumtimin: Braktisja e shkollimit në arsimin e mesëm profesional në Kosovë. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se në rastet më të shpeshta braktisja e shkollimit në arsimin profesional ndodh për shkak të mungesës së performancës së nxënësve që regjistrohen në arsimin profesional dhe për shkak të mungesës së përkrahjes dhe mbështetjes e inkurajimit të nxënësve për tejkalimin e problemeve dhe sfidave në mjedisin e ri social (në klasën e 10-të).

- kushtet e vështira ekonomike;
- mungesa e kapaciteteve shkollore dhe e infrastrukturës, veçanërisht mungesa e shkollave të mesme të larta;
- distanca e gjatë e udhëtimit për nxënësit;
- interesimi i ulët i nxënësve ose niveli i ulët i njohurive për profilet e caktuara në arsimin e mesëm të lartë dhe
- vetëdijesimi i ulët i prindërve për rëndësinë e arsimit të mesëm dhe profileve arsimore në dispozicion.”

Në përgjithësi, hulumtimet e bëra për braktisjen e shkollës kanë bërë që institucionet arsimore të sensibilizohen më shumë për trajtimin e kësaj dukurie. Mirëpo hulumtimet e deritanishme janë të pakta dhe jogjithëpërfshirëse, për faktin se nuk kemi ende ndonjë hulumtim specifik që ka trajtuar praktikën e adresimit të fëmijëve jashtë shkollës dhe parandalimit e reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës. Hulumtimet që trajtojnë profilin e fëmijëve jashtë shkolle janë më së të nevojshme. Ato ofrojnë ekspertiza të ndryshme dhe alternativa të reja për adresimin e drejtë dhe me kohë të praktikave të parandalimit e të reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës. Këtë pritet ta reflektojë edhe studimi ynë në nivel komunal dhe në nivel shkolle për praktikën e adresimit të fëmijëve jashtë shkolle dhe parandalimin e braktisjes.

14. Instituti RINVEST (2009): , *Arsimi joformal në Kosovë, Hulumtim dhe analiza e braktisjes nga arsimi i obliguar dhe arsimi i mesëm i lartë në Kosovë, Prishtinë, fq. 5*

15. MASHT&UNICEF., (2004). *Regjistrimi dhe braktisja e shkollës nga vajzat në Kosovë, Prishtinë, fq. 4.*

16. PPPA – Projekti për Përmirësimin e pjesëmarrjes në arsimin e financuar nga Banka Botërore. Projekti është zhvilluar në dy faza: në fazën e parë: 2003-2005 dhe në fazën e dytë 2006-2008.

1. Granti për zhvillimin e shkollës – ka ofruar financim për shkollën në mënyrë që të arrihet përmirësimi i qasjes/përfshirjes së nxënësve në shkollë dhe suksesit në arsim.

2. Sistemi informativ për menaxhim të arsimit – ka ofruar ndihmë në forcim dhe qëndrueshmëri të të dhënave për nxënësit dhe shkollën.

3. Menaxhimi i projekteve – ka ofruar ndihmë të drejtpërdrejtë shkollës në planifikim dhe menaxhim të projekteve.

17. Braktisja e shkollës nga nxënësit në Kosovë, MASHT, Prishtinë, 2008, fq. 10.



3. GJETJET NË NIVELIN KOMUNAL

3.1. Praktikët e adresimit të fëmijëve jashtë shkollës, parandalimit dhe reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar

Ligji për arsim në komunat e Republikës së Kosovës (2008), neni 5, pika b, tregon se një nga kompetencat e komunave në nivelet 0, 1, 2 dhe 3 të arsimit publik (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë) është edhe regjistrimi dhe pranimi i nxënësve në pajtim dhe me respektimin e parimeve të mosdiskriminimit sipas ligjit. Ndërsa kompetenca të veçanta për komunat përkitazi me aktivitetet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes së shkollës dhe mosregjistrimit të fëmijëve në shkollë janë përcaktuar me udhëzimin administrativ (nr.19/2012): *Krijimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar.*

Në kuadër të rezultateve të studimit në nivel komunal për praktikët e adresimit të fëmijëve jashtë shkollës – praktikët për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar, janë hulumtuar çështjet në vijim dhe për to do të pasqyrohen rezultatet e gjetura: (I) *Regjistrimi i fëmijëve në edukimin parashkollor – klasën parafillore; (II) regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë; (III) Të dhënat për fëmijët jashtë shkollës dhe mundësitë e identifikimit; (IV) Braktisja e shkollës dhe mungesat e nxënësve; (V) Ekipi për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar; (VI) Bashkëpunimi ndërsektorial dhe bashkëpunimi me OJQ; (VII) Gjithëpërfshirja; dhe (VIII) Vlerësimi i nevojave për mbështetje/përkrahje të DKA-ve për adresimin e aspekteve problematike që lidhen me fëmijët jashtë shkolle dhe me funksionimin e EPRBM-ve.*

3.1.1. Regjistrimi i fëmijëve në edukimin parashkollor dhe parafillor (5-6 vjeç)

Komunat kanë kompetenca të plota në organizimin e sistemit të edukimit në nivelin ISCED 0 – edukimin parashkollor. Dokumentet dhe raportet e analizuara nga DKA-të e përfshira në studim tregojnë se ekzistojnë disa dallime të vogla në praktikët e DKA-ve për përfshirjen e fëmijëve në edukimin parashkollor. Shumica e komunave në planet e tyre vjetore kanë planifikuar aktivitete për përfshirjen, mbikëqyrjen dhe organizimin e edukimit parashkollor, si: (I) *trajnime të edukatorëve për gjithëpërfshirje, indeksin e gjithëpërfshirjes etj.; (II) mbikëqyrje e regjistrimit të fëmijëve në klasat parafillore; (III) analizë regjistrimit të fëmijëve në arsimin parafillor sipas moshës, gjinisë dhe etnisë etj.*

Mirëpo në asnjë nga komunat e përfshira nuk kemi gjetur plane të veprimit të shkoqitura me aktivitete konkrete për rritjen e regjistrimit të fëmijëve në edukimin parashkollor. Komuna e Fushë-Kosovës në Planin zhvillimor të Drejtorisë së Arsimit 2012-2014, ka përcaktuar objektiv të veçantë gjithëpërfshirjen e fëmijëve në edukimin parashkollor, mirëpo përveç përkrahjes së gjendjes në këtë nivel të edukimit, nuk është përcaktuar asnjë aktivitet që duhet ndërmarrë për arritjen e këtij objekti.

Kjo situatë është e njëjtë edhe në komuna të tjera të përfshira në studim. Përfaqësuesit e intervistuar në DKA mungesën planeve të veprimit për regjistrimin dhe mosrritjen e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor e arsyejnë me mungesën e buxhetit për të rritur përfshirjen e fëmijëve në këtë nivel të edukimit dhe me aspektin ligjor, meqë edukimi parashkollor me ligj nuk është bërë ende i obligueshëm.

Megjithatë analiza e treguesve statistikorë të regjistrimit të fëmijëve në arsimin parafillor tregon se dy nga shtatë komunat e përfshira në studim (Malisheva dhe Ferizaj) kanë arritur që 100% të fëmijëve të kësaj moshe t'i përfshijnë në arsimin parafillor, kurse komunat e tjera kanë shkallë më të ulët të regjistrimit të fëmijëve në arsimin parafillor. Shkalla e regjistrimit në arsimin parafillor, krahasuar me regjistrimin një vit më vonë në klasën e parë, do të prezantohen në tabelën në vijim.

Tabela 4. Përqindja e nxënësve të klasës së parë që në dy vitet e fundit janë regjistruar në edukimin parashkollor (5-6 vjeç).

| Komunat | Të regjistruar në arsimin parafillor (2010/2011) | Të regjistruar në klasën e parë(2011/2012) | % E nxënësve të regjistruar ne klasën e parë që e kanë ndjekur edukimin parashkollor | Të regjistruar në arsimin parafillor (2011/2012) | Të regjistruar në klasën e parë (2012/2013) | % E nxënësve të regjistruar ne klasën e parë që e kanë ndjekur edukimin parashkollor |
|------------------|--|--|--|--|---|--|
| Fushë Kosovë | 113 | 644 | 17.55% | 128 | 633 | 20.22% |
| Obiliq | 324 | 410 | 79% | 328 | 351 | 93.45% |
| Malishevë | 1283 | 1287 | 99.69% | 1228 | 1170 | 104.70% |
| Klinë | 408 | 689 | 59.22% | 443 | 687 | 64.48% |
| Istog | 445 | 615 | 72.36% | 388 | 561 | 69.16% |
| Pejë | 1041 | 1450 | 71.79% | 998 | 1450 | 68.93% |
| Ferizaj | 1744 | 1997 | 87.33 % | 1909 | 1868 | 102.19% |
| Në shkallë vendi | 20352 | 29481 | 69% | 21874 | 28285 | 77.30% |

Paraqitja e të dhënave tregon se në dy komuna, Malishevë dhe Ferizaj, numri i fëmijëve që në këtë vit shkollor janë në klasën e parë të arsimit fillor është më i vogël se në një vit paraprak kur kjo gjeneratë e fëmijëve ka qenë në arsimin parafillor. Numri nuk përputhet për faktin se ka lëvizje të popullsisë brenda Kosovës dhe se disa nga fëmijët e këtyre dy komunave që kanë ndjekur arsimin parafillor janë regjistruar në klasën e parë në komuna të tjera të Kosovës, që nuk kanë qenë të përfshira në studimin tonë, ose kanë migruar jashtë vendit, ose kanë përsëritur për dy vite edukimin parashkollor në grupin e njëjtë (5-6 vjeç).

3.1.2. Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë

Korniza ligjore

Në bazë të Ligjit për Arsim Parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011) dhe ndarjes së shkallëve të shkollimit në Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (2011), fëmijët që kanë arritur moshën 6 vjeç deri në shtator janë të detyruar të regjistrohen në klasën e parë të arsimit fillor dhe vetëm me rekomandimet e një komisioni profesional regjistrimi mund të shtyhet për një vit. Me kërkesën e prindit, një fëmijë mund të regjistrohet në klasën e parë edhe nëse nuk i ka mbushur 6 vjeç duke pasur një vlerësim të mjekut dhe të psikologut.

Zonat e mbulimit

Shkollat kanë zonën e vet të mbulimit, të cilën e përcakton komuna dhe të gjithë fëmijët që kanë arritur moshën 6 vjeç dhe që banojnë në atë zonë kanë të drejtë të regjistrohen dhe të ndjekin shkollën e nivelit përkatës. Sipas Ligjit për Arsim Parauniversitar në Republikën e Kosovës, prindërit janë

të detyruar që të regjistrojnë fëmijët për të vijuar arsimin e detyruar 9-vjeçar. Të gjithë të intervistuarit në DKA-të e komunave të përfshira në studim tregojnë se komunat tashmë e kanë ndarë zonën e mbulimit për çdo shkollë dhe regjistrimi i nxënësve në shkollë sipas zonës së mbulimit bëhet në shkallë të kënaqshme. Katër nga shtatë të intervistuarit në DKA raportuan për vështirësitë në regjistrimin e fëmijëve në përputhje me zonat e përcaktuara të mbulimit. Vështirësitë më të mëdha u raportuan për zonat që kanë më shumë se një shkollë në dispozicion për shkak të presioneve nga prindërit për fëmijët e tyre për t'i regjistruar në shkollat më të mira. Në përgjithësi, komunat një gjë të tillë nuk e kanë ndaluar me qëllim që të mos ndikojnë në mosregjistrimin eventual të fëmijëve në shkollë.

Regjistrimi me vonesë në klasën e parë

Në komunat e Obiliqit, Fushës-Kosovës dhe të Istogut, për dallim prej komunave të tjera, është më shumë i shprehur regjistrimi me vonesë i fëmijëve në arsimin e detyruar, përkatësisht në klasën e parë. Kjo situatë sipas të intervistuarve në komuna është e shprehur më shumë me fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Analiza e disa raporteve të ofruara nga DKA-të për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë tregon se një numër i konsiderueshëm i fëmijëve në këtë vit shkollor është regjistruar në klasën e parë në mosha të ndryshme: 9-10-vjeçare, disa të tjerë në moshën 8 vjeç dhe disa të tjerë në moshën 7 vjeç. P.sh. në një raport të komunës së Obiliqit për nxënësit e regjistruar në klasën e parë në shkollën P.S., 1 fëmijë është i moshës 10-vjeçare, 2 fëmijë janë të moshës 9-vjeçare, 4 të moshës 8-vjeçare, mbi 10 fëmijë janë të moshës 7-vjeçare.

Aktivitetet e DKA-ve për të përmbushur regjistrimin në klasën e parë

Në kohën kur u realizua studimi në nivel komunal, drejtoritë komunale të arsimit ishin në fazën e planifikimit të paraleleve për nxënës të klasës së parë, kishin marrë disa raporte për numrin e nxënësve të regjistruar, edhe pse sipas tyre deri në fillim të vitit (shtator) asnjëherë nuk mund të dimë numrin e saktë të të regjistruarve në klasën e parë, pasi një numër i prindërve i regjistrojnë fëmijët në shkollë edhe pas afatit të përcaktuar. Kjo i ka mobilizuar DKA-të dhe disa shkolla që në disa zona të zhvillojnë aktivitete shtesë për të rritur ndërgjegjësimin e prindërve rreth respektimit të afatit të regjistrimit dhe nevojën për të regjistruar fëmijët e tyre në kohë.

Në pyetjen: *Cilat janë aktivitetet që i ka bërë DKA-ja për të inkurajuar prindërit që t'i regjistrojnë me kohë fëmijët në klasën e parë?* përfaqësuesit e intervistuar në nivel komune, kryesisht iu referohen aktiviteteve që i ndërmarrin shkollat që sipas tyre janë të koordinuara me DKA-të, si për planin e regjistrimit, ashtu edhe për mënyrën e informimit. Të intervistuarit nuk ofruan ndonjë dëshmi të veçantë për ndonjë aktivitet qendror që ndërmerr DKA-ja për të inkurajuar prindërit që t'i regjistrojnë me kohë fëmijët në klasën e parë, siç janë fushatat e informimit dhe të sensibilizimit përmes takimeve të veçanta dhe përmes mjeteve lokale të informimit, organizimi i diskutimeve me këshillin e prindërve në nivel komunal etj.

Bashkëpunimi me zyrat e regjistrimit civil për krijimin e listave të fëmijëve për regjistrim në klasën e parë

Asnjëra nga shtatë komunat e përfshira në studim nuk ka ofruar dëshmi të shkruara për modalitetet e bashkëpunimit me zyrën për regjistrim civil për të dhënat e fëmijëve që kanë mbushur moshën shkollore dhe duhet të regjistrohen në klasën e parë. Sipas DKA-ve, bashkëpunimi me këtë zyrë është i lidhur për

ndonjë kërkesë individuale të regjistrimit të fëmijëve në klasën e parë dhe nuk mund të flasim për një raportim zyrtar të të dhënave për fëmijë që mbushin moshën për të shkuar në shkollë. Të njëjtën gjë e thonë edhe përfaqësuesit e zyrës për regjistrim civil. Ata shprehen se nuk e kanë për detyrë të përgatisin një raport të tillë. Megjithatë ata ofrojnë dokumentacionin e lindjes për prindërit të cilët i kërkojnë për fëmijët e tyre të cilët do të regjistrohen në klasën e parë.

Sipas të intervistuarve në nivel komunal, zyra e regjistrimit civil raporton në Agjencionin për Regjistrim Civil (në bazë elektronike në softuer) si dhe në Agjencinë për Statistika (në muaj). Sipas tyre, listat e regjistrimit që i kanë këto zyra shpesh nuk janë të plota, sepse ka shumë raste kur fëmijët kanë lindur në spitale të komunave të tjera dhe atje janë regjistruar në librin e lindjes. Dy nga shtatë të intervistuarit e zyrave për regjistrim civil u shprehen se, meqë sistemi për regjistrim civil është unik në gjithë Kosovën, është mirë që DKA-ja të marrë statistika me të dhënat e fëmijëve që duhet të hyjnë në klasë të parë nga Agjencia për Regjistrim Civil.

Në pyetjen: Çfarë do të bëni si DKA për të bashkëpunuar me ngushtë me zyrën e regjistrimit civil, në mënyrë që të keni me kohë të dhënat për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë? të intervistuarit në DKA u shprehen se dëshirojnë të provojnë që të rrisin bashkëpunimin me këtë zyrë që të marrin raporte me kohë për fëmijët që kanë arritur moshën e regjistrimit në klasën e parë, edhe nëse ata nuk ishin ende konkretë përkitazi me përmbajtjen e mundshme të këtyre raporteve.

3.1.3 Të dhëna të tjera arsimore

Regjistrimi në klasën e gjashtë (6) dhe në klasën e dhjetë (10)

Regjistrimi i nxënësve në klasën e 6-të bëhet nga vetë shkollat, në bazë të numrit të nxënësve që kanë përfunduar me sukses arsimin fillor, përkatësisht klasën e fundit të arsimit fillor – klasën e pestë. Regjistrimi bëhet me strukturë të njëjtë të nxënësve që vijnë nga e njëjta paralele e klasës së 5-të. Struktura e nxënësve të regjistruar në klasën e 6-të ndryshon vetëm në rastet kur numri i nxënësve është rritur ose është zvogëluar në shkollë.

Asnjëra nga shtatë komunat e përfshira në studim nuk ka ofruar dëshmi të shkruara se si mbështeten shkollat në regjistrimin e nxënësve në klasën e gjashtë, si angazhohen zyrtarët komunalë për t'u dhënë përkrahje nxënësve në adaptimin nga një ose dy mësimdhënës në më shumë se 10 mësimdhënës.

Për dallim prej regjistrimit të nxënësve në klasën e 6-të, regjistrimi në klasën e 10-të – në nivelin e tretë të arsimit bëhet me një qasje tjetër. Fillimisht nxënësit të cilët kanë përfunduar me sukses klasën e nëntë (9) përfshihen në testin e arritshmërisë, të cilin e përgatit MASHT-i dhe në bazë të rezultateve nga ky vlerësim nxënësit orientohen për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze ose në shkolla profesionale.

Paraprakisht komunat përgatisin planin e regjistrimit për klasën e 10-të, në të cilin përfshijnë drejtimet e gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, në të cilat mund të regjistrohen nxënësit dhe numrin e paraleleve dhe të nxënësve që do të pranohen në çdo drejtim.

Komunat raportuan se për vitin shkollor 2012/2013 plani i regjistrimit është përgatitur me kohë dhe janë në pritje të organizimit të testit të klasës së 9-të dhe pastaj për të realizuar planin e regjistrimit të nxënësve në klasën e 10-të.

Raportet e shumicës së komunave nuk ofrojnë dëshmi për aktivitete të DKA-s që lidhen me informimin dhe orientimin profesional të nxënësve. Përfaqësuesit nga komuna e Fushës-Kosovës dhe komuna e Klinës raportuan për aktivitetet në kuadër të shkollave që ka zhvilluar GIZ-i për programin e edukimit në karrierë, program i cili është duke u bërë përpjekje të ofrohet si lëndë zgjedhore në klasën e 8-të dhe të 9-të.

Raportet e komunave për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të tregojnë se shumica e komunave janë afër përfshirjes së të gjithë nxënësve në nivelin e tretë të shkollimit. Tabela në vijim pasqyron shkallën e tranzicionit (në përqindje) të nxënësve nga klasa e 9-të në klasën e 10-të.

Tabela 5. Përqindja e nxënësve të regjistruar në klasën e 10-të (2011/2012), në raport me numrin e nxënësve që kanë përfunduar klasën e 9-të (2012/2013)

| Komunat | Shkalla e tranzicionit nga klasa e 9-të klasën e 10-të |
|---------------|--|
| Fushë -Kosovë | 87% ¹⁸ |
| Obiliq | 60% ¹⁹ |
| Malishevë | 100% |
| Klinë | 83% |
| Istog | 77% ²⁰ |
| Pejë | 100% |
| Ferizaj | 100% |

Nga të dhënat e pasqyruara shihet se tri nga shtatë komunat e përfshira në studim kanë përfshirje të të gjithë nxënësve nga klasa e 9-të në klasën e 10-të.

Shkalla e diplomimit në klasën e 9-të dhe të 12-të

Të gjithë nxënësit që mbarojnë me sukses klasën e 9-të i nënshtrohen testit të arritshmërisë, që organizohet nga MASHT-i. Pavarësisht numrit të pikëve – rezultateve të testit të arritshmërisë, secili nxënës që merr pjesë në këtë test merr diplomën e arsimit të mesëm të ulët, sepse testi i arritshmërisë nuk ka pasoja në diplomim, por shërben për orientim të nxënësve për regjistrim në klasën e 10-të, përkatësisht në shkolla profesionale apo gjimnaze.

Në kohën e realizimit të studimit në komuna nuk ka qenë ende i organizuar testit i arritshmërisë 2012/2013, mirëpo komunat raportuan për rezultatet e testit të arritshmërisë 2011/2012. Raportet e shumicës së komunave nuk ofrojnë asgjë më shumë se të dhënat numerike të shkallës së arritshmërisë në nivel komunal.

Tabela 6. Mesatarja e arritshmërisë së nxënësve të komunave të përfshira në studim në testin e klasës së 9-të - viti shkollor 2011/2012.

| Komunat | Mesatarja e arritshmërisë në testin e klasës së 9-të (2011/2012) ²¹ |
|---------------|--|
| Fushë -Kosovë | 63.10% |
| Obiliq | 64% |
| Malishevë | 58.20% |
| Klinë | 55.20% |
| Istog | 60.90% |
| Pejë | 60.70% |
| Ferizaj | 52.90% |

Vetëm raportet nga komuna e Istogut tregojnë për një analizë të rezultateve të bëra nga komuna për secilën shkollë dhe për secilën lëndë mësimore të përfshirë në testin e arritshmërisë.

Për dallim të diplomimit në klasën e 9-të, diplomimi në klasën e 12-të është i karakterizuar me provimin e maturës, ku nxënësi i cili i përfundon me sukses pozitiv tri vitet e shkollës së mesme të lartë, i nënshtrohet provimit të maturës, ku pragu minimal i kalimit është 50% e totalit të pikëve të provimit të maturës. Nxënësit që nuk i arrijnë 50% të pikëve, e kanë edhe afatin e dytë – në gusht të vitit përkatës dhe, nëse edhe në këtë afat nuk e kalojnë pragu minimal, detyrohen të presin deri në afatin e rregullt të vitit tjetër shkollor.

¹⁸ Nga komuna e Fushë-Kosovës një numër i konsiderueshëm i nxënësve pas klasës së 9-të regjistrohet në klasën e 10-të në Prishtinë, mirëpo ne nuk kishim të dhëna në dispozicion se sa është numri i nxënësve nga komuna e Fushë-Kosovës që shtë regjistruar në shkollat e arsimit të mesëm të lartë në Prishtinë.

¹⁹ Nga komuna e Obiliqit një numër i konsiderueshëm i nxënësve pas klasës së 9-të regjistrohet në klasën e 10-të në Prishtinë, mirëpo ne nuk kishim të dhëna në dispozicion se sa është numri i nxënësve nga komuna e Obiliqit që regjistrohet në shkollat e arsimit të mesëm të lartë në Prishtinë.

²⁰ Edhe nga komuna e Istogut një numër i konsiderueshëm i nxënësve pas klasës së 9-të regjistrohen në klasën e 10-të në Pejë, mirëpo ne nuk kishim të dhëna në dispozicion se sa është numri i nxënësve nga komuna e Istogut që regjistrohet në shkollat e arsimit të mesëm të lartë në Pejë.

²¹ Në kohën kur është bërë studimi nuk ka qenë ende i realizuar testi i arritshmërisë me nxënësit e klasës së 9-të (2012/2013), prandaj janë vendosur rezultatet e testit të vitit 2011/2012.

Ashtu sikur në raportet e testit të arritshmërisë, edhe në raportet e provimit të maturës, shumica e komunave ofruan vetëm të dhënat numerike të rezultateve të provimit të maturës, përkatësisht shkallën mesatare të arritshmërisë dhe shkallën e kalueshmërisë.

Tabela 7. Përqindja e kalueshmërisë dhe mesatarja e arritshmërisë në provimin e maturës 2012/2013 - e nxënësve të komunave të përfshira në studim .

| Komunat | Përqindja e numrit të nxënësve që e kanë kaluar provimin e maturës | Mesatarja e arritshmërisë në provimin e maturës |
|--------------|--|---|
| Fushë-Kosovë | 79.50% | 58.90% |
| Obiliq | 76.90% | 58.50% |
| Malishevë | 84.80% | 61.60% |
| Klinë | 85% | 59.30% |
| Istog | 87.30% | 64.90% |
| Pejë | 79.30% | 60.40% |
| Ferizaj | 70.50% | 57% |

Rezultatet tregojnë se në katër komuna të përfshira në studim, mbi 20% e nxënësve nuk kanë arritur ta kalojnë provimin e maturës, kurse në tri komunat e tjera rreth 14% e nxënësve të tyre nuk kanë arritur ta kalojnë provimin e maturës në afatin e qershorit.

3.1.4. Mekanizmat për identifikimin e fëmijëve jashtë shkollës

Si në nivelin qendror, ashtu edhe në nivelin komunal, mungon niveli i informimit për fëmijët jashtë shkolle, mungon baza e të dhënave për këtë kategori të fëmijëve . Të intervistuarit në nivel komunal si nga DKA-ja, ashtu edhe nga qendra për punë sociale, Zyra për të Kthyerit, zyrtarët policorë dhe përfaqësuesit e tjerë të intervistuar deklarojnë se janë në dijeni se ka fëmijë jashtë shkolle, por nuk posedojnë të dhëna statistikore të kësaj kategorie të fëmijëve dhe nuk janë në dijeni për kohëzgjatjen e mungesës, mospërfshirjes së tyre në shkollë. Vetëm përfaqësuesit e intervistuar të DKA-s e shohin si përgjegjësi të tyre mbledhjen e të dhënave për fëmijët jashtë shkolle, ndërkaq institucionet e tjera në nivel komunal pranojnë se mund të kontribuojnë në mbledhjen e këtyre të dhënave, por në përkrahjet e detyrave të tyre nuk u është dhënë kjo përgjegjësi. Kjo tregon qartë për mungesën e sistemeve gjithëpërfshirëse për t'u reaguar ndaj rasteve të fëmijëve që janë jashtë shkolle dhe një mungesë e përgjithshme e bashkëpunimit në mes të mbrojtjes së fëmijëve, shërbimeve sociale dhe arsimore.

Vetëm DKA-ja e komunës së Obiliqit na ofroi një listë me të dhëna për fëmijët jashtë shkolle. Ajo, me përkrahjen edhe të OJQ-ve, ka përgatitur një listë me të dhëna për fëmijët jashtë shkolle, ku janë të evidencuar 90 fëmijë jashtë shkolle, të dhënat e të cilëve janë mbledhur nga janari i këtij viti (2013). Te dhënat janë me emër, mbiemër dhe me adresë të vendbanimit. Ndërkaq komunat e Fushë-Kosovës dhe e Pejës kanë raportuar se kanë zhvilluar disa aktivitete për identifikimin e fëmijëve jashtë shkolle me ndihmën e partnerëve mbështetës, si: ECMI, Health for All, Balkan Sunflowers, Terre des Hommes, Kultura Multietnike në Kosovë etj., mirëpo nuk na kanë ofruar të dhëna apo dokumente të shkruara për fëmijët jashtë shkolle. Të dhënat në këto komuna dhe në disa komuna të tjera janë mbledhur në kuadër të Task Forces për përmirësimin e arsimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

DKA-të kanë raportuar se drejtorët e shkollave kanë kontribuar në identifikimin e fëmijëve jashtë shkollës. Megjithatë, sipas tyre, të dhënat e mbledhura më së shumti përfshijnë informacione për braktisjen e shkollës nga nxënësit. Informacionet për fëmijët të cilët kurrë nuk kanë qenë të regjistruar

apo që kanë braktisur shkollën shumë vite me përpara ka te ngjarë që nuk janë ruajtur nga komunat, sepse ne nuk arritëm të sigurojmë dëshmi, me përjashtim të komunës së Obiliqit. DKA-ja dhe drejtuesit e shkollave nga kjo komunë identifikimin e fëmijëve jashtë shkolle e bëjnë në bashkëpunim me komunitetin, përmes vizitave në familje, përmes të cilave kanë siguruar të dhëna të sakta për fëmijët, të cilët e kanë moshën shkollë, por që nuk janë regjistruar fare dhe për ata të cilët e kanë braktisur shkollën.

Karakteristikat individuale dhe sociale të fëmijëve jashtë shkolle

Të intervistuarve në qendrat për punë sociale, psikologëve dhe pedagogëve që punojnë në DKA dhe shkolla iu kërkua që të plotësojnë një formular të rasteve studimore për fëmijët jashtë shkolle apo për nxënësit që kanë braktisur shkollën dhe të cilët i njohin. Të intervistuarit kanë identifikuar dy karakteristika individuale që kryesisht janë më të shprehura në këtë grup të fëmijëve:

- janë fëmijë të komuniteteve RAE,
- janë fëmijë ose adoleshentë, që për arsye të ndryshme janë regjistruar me vonesë në shkollë dhe
- janë fëmijë që kanë rezultate të dobëta në mësim.
- fëmijë që u përkasin familjeve shumë të varfra;
- fëmijë që punojnë për të mbështetur veten e tyre ose familjet e tyre;
- fëmijë që kanë traditë në familje për të braktisur shkollën apo për të bërë mungesa të shumta në shkollë;
- fëmijë të familjeve që janë të përfshira në përdorimin e alkoolit dhe që nuk kanë kujdes ndaj fëmijëve dhe
- fëmijë që jetojnë pa prindër, me njërin prind ose me prindër të ndarë.

Sipas respondentëve nga qendrat për punë sociale, pedagogëve dhe psikologëve, karakteristikat sociale të fëmijëve jashtë shkollës janë:

Të intervistuar në nivel komunal, si mundësi të vetme për mbledhjen e të dhënave të plota dhe të sakta për fëmijët jashtë shkolle e shohin përmes bashkëpunimit të ngushtë ndërsektorial, përfshirjes së OJQ-ve dhe shoqatave të ndryshme që merren me çështje të përfshirjes në edukim, si dhe nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të përbashkëta të identifikimit të fëmijëve jashtë shkolle dhe raportimit të tyre në një qendër të vetme në komunë, ku shumica i referohen DKA-s, që duhet të jetë e ngarkuar me mbajtjen e informacionit dhe të të dhënave statistikore për fëmijët që kanë braktisur shkollën dhe për fëmijët jashtë shkolle.

3.1.5. Braktisja e shkollës – praktikat e adresimit në nivel komunal

Në formularët dhe në dokumentet për raportim nuk është përcaktuar mirë me kolona të veçanta si të raportohen nxënësit e panotuar dhe nxënësit braktisës. Zyrtarët komunalë shprehen se shpesh nga shkollat nxënësit braktisës i raportohen të panotuar dhe ndonjëherë nxënësit e panotuar raportohen si nxënës braktisës. Kjo sidomos vërehet në raportimin e fëmijëve që janë ende në listën e shkollës, por që kanë lëvizur brenda Kosovës apo kanë migruar jashtë vendit, ata nuk e ndjekin shkollën, nuk marrin dëshmi për të shkuar në shkollën tjetër dhe nuk kanë ofruar dëshmi se janë duke ndjekur mësimin në shkolla të tjera. Kjo situatë ka shkaktuar vështirësi edhe në përkufizimin që përfaqësuesit e DKA-ve e bëjnë për “braktisjen e shkollës”, sepse 3 nga 7 përfaqësuesit e DKA-ve gjatë intervistës në temën për braktisjen e shkollës shpesh herë iu referohen nxënësve që kanë mbetur të pabotuar. Kjo ngatërresë ishte e theksuar edhe në intervistat me drejtorë të shkollave. Megjithatë të gjithë përfaqësuesit e DKA-ve kanë deklaruar në intervistë se një nxënës e konsiderojnë nxënës braktisës kur përfundimisht është larguar nga shkolla edhe pas përpjekjes së shkollës për kthimin e tij/saj në shkollë.

Të dhënat për braktisjen. Raportet statistikore për braktisjen e shkollës që i kemi marrë nga DKA-të kanë dallime nga komuna në komunë në formën e të dhënave dhe në vitet e raportimit. Jo të gjitha komunat i kanë ruajtur të dhënat për braktisjen në tri vitet e fundit dhe në këtë vit shkollor nuk janë përfunduar ende raportet në nivel komunal.

Në tabelën në vijim do të pasqyrojmë statistikën e braktisjes në arsimin e detyruar (klasat 1-9) për vitin shkollor 2011/2012, të ofruara nga zyrtarët arsimorë të komunave të përfshira në studim.

Tabela 8. Numri i nxënësve braktisës të klasave 1-9 / viti shkollor 2011/2012 – në komunat e përfshira në studim

| Komuna | “Numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën” | Femra |
|---|---|----------------------|
| Fushë-Kosovë | 22 | 11 |
| Obiliq | 4 | 3 |
| Malishevë | 144 | 66 |
| Klinë | 87 | 53 |
| Istog | 30 | 14 |
| Pejë | 111 | 69 |
| Ferizaj | 137 | 65 |
| Gjithsej në komunat²² | 535 | 281 ose 52.0% |

Vlen për t'u theksuar se të gjithë përfaqësuesit e DKA-ve që u intervistuan theksuan se braktisja e shkollës në arsimin e detyruar është një shqetësim për komunën e tyre dhe se janë duke bërë përpjekje për parandalimin e saj dhe për kthimin e fëmijëve braktisës në shkollë, mirëpo shumica prej tyre nuk treguan se çfarë janë duke bërë personalisht në këtë drejtim. Vetëm tre nga shtatë përfaqësuesit e DKA-ve të intervistuar theksuan se vetë kanë qenë të përfshirë në biseda me prindër dhe sidomos me përfaqësues të komuniteteve RAE për kthimin në shkollë të fëmijëve që kanë braktisur shkollën.

Fëmijët që janë braktisës të shkollës dhe që mungojnë shpesh nga shkolla janë të prirur të shkaktojnë më shumë sjellje delikvente, këtë e thonë 3 nga 6 zyrtarët e policisë të intervistuar në komunat ku është realizuar studimi. Zyrtarët e policisë nuk ishin në gjendje të ofronin evidenca statistikore që lidhen me ndërhyrjet e policisë në situata të ndryshme, ku aktorë të ngjarjeve kanë qenë nxënës braktisës ose nxënës që kanë munguar shpesh në shkollë. Të gjithë zyrtarët e policisë të intervistuar e pranojnë faktin se janë në dijeni për një numër të caktuar të fëmijëve që janë braktisës, por nuk ofrojnë ndonjë dëshmi se si janë raportuar rastet e tilla në shkolla apo në DKA. Kjo tregon mungesën e mekanizmave koherent të ndërhyrjes dhe të mekanizmave të qartë të raportimit dhe të bashkëpunimit ndërsektorial.

3.1.6. Mungesat e nxënësve – mbledhja e të dhënave

DKA-të kanë qasje në të dhënat për mungesat e nxënësve në secilën shkollë të komunës. DKA-të marrin raporte nga shkollat dy herë në vit. Këto raporte integrohen në raportin komunal për mungesat e nxënësve dhe për të dhënat e tjera që janë në formularët statistikorë të SMIA-s. Edhe pse DKA-të pranojnë nga shkollat dy herë në vit raporte që lidhen me mungesat e nxënësve, ne nuk gjetëm ndonjë dëshmi në formë të raportit të shkruar për analizën e bërë lidhur me shkaqet e mungesave, diskutimet dhe masat e ndërmarra për zvogëlimin e tyre përmes formave të ndryshme që mund të aplikohen, varësisht nga specifikat e shkollave. Gjatë intervistave, 4 nga 7 përfaqësuesit e DKA-s të intervistuar theksuan se mesatarja e mungesave të nxënësve është më e lartë në shkollat ku janë të përfshirë fëmijët e komuniteteve RAE, krahasuar me shkollat e tjera. Ata gjithashtu theksuan se një

²² Në shkallë vendi, raportet e SMIA-s tregojnë se janë 1339 nxënës që e kanë braktisur shkollën në vitin shkollor 2011/2012. Kjo nënkupton se 40% e nxënësve që kanë braktisur shkollën në këtë vit shkollor vijnë nga komunat e përfshira në studimin tonë.

numër i fëmijëve të këtyre komuniteteve është i prirur të mungojë shumë nga shkolla ose të braktisë shkollën pasi të regjistrohet në shkollë dhe të marrë certifikatën e regjistrimit të kërkuar nga qendra për punë sociale, në mënyrë që të marrë përfitime sociale. Kjo është konfirmuar edhe nga të intervistuarit në qendrat për punë sociale dhe në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Çështje Sociale. Sipas tyre, qendrat për punë sociale e kanë rregull të kërkojnë dëshmi nga familjet në asistencë për vijueshmërinë e shkollimit të fëmijëve të moshës shkollë, por pasi që QPS-ja të marrë vendimin për asistencë, sipas informacioneve që kanë ata, disa fëmijë serish ikin nga shkolla. Këto dy institucione pranojnë se nuk kanë ndonjë mekanizëm të ndërtuar se bashku me DKA-të për të monitoruar vijueshmërinë e këtyre fëmijëve në shkollë.

Rregullat e vijueshmërisë në shkollë. Drejtoritë komunale të arsimit janë përgjegjëse për miratimin e rregullave të sjelljes në shkollë dhe për masat disiplinore të hartuara nga këshillat drejtues të shkollave. Disa DKA se bashku me përfaqësues të shkollave i kanë hartuar rregullat e sjelljes për të gjitha shkollat dhe mbi bazën e tyre punojnë shkollat. Në asnjë dokument të rregullave të sjelljes në shkollë, të miratuara nga DKA-të, nuk kemi identifikuar kritere të cilat përcaktojnë mënyrat e arsimit ose joarsimit të mungesave të nxënësve. Raportet statistikore tregojnë për numër të madh të mungesave të paarsyeshme, por edhe për numër të madh të mungesave të arsyeshme, të cilat në mungesë të kriterëve mund të supozojmë se janë arsyetuar pa u mbështetur në kritere bazë, meqë ato nuk ekzistojnë në formë të shkruar.

DKA-të nuk kanë plane ose strategji të ndërhyrjes për zvogëlimin e mungesave të nxënësve. Komuna e Obiliq në Planin Zhvillimor të Drejtorisë së Arsimit ka përcaktuar si mision: Ngritjen e cilësisë në procesin edukativo-arsimor, vijueshmërinë e rregullt, si dhe parandalimin e braktisjes së shkollës. Ndërkaq në tregues objektivisht të verifikueshëm ka përcaktuar se do të zvogëlohet numri i mungesave dhe i braktisjes së shkollës për 12 %. Mirëpo në listën e masave për intervenim mbi 70% e tyre lidhen me infrastrukturën, rreth 20% me pajisjen e shkollave me mjete të konkretizimit dhe pajisjen e bibliotekave, kurse rreth 10 % lidhen me aftësimin e mësimeve për përdorimin e metodave të reja mësimore. Në planin zhvillimor të kësaj komune nuk gjejmë asnjë aktivitet që e arsyeton misionin dhe treguesit për zvogëlimin e mungesave dhe të braktisjes. Komunitet e tjera në planet e tyre për zhvillimin e arsimit në nivel komunal nuk kanë përcaktuar ndonjë objektiv për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe zvogëlimin e mungesave të nxënësve nga shkolla.

Të intervistuarit e DKA-ve përkitazi me pyetjen tonë për nevojën për të hartuar një plan të ndërhyrjes për zvogëlimin e mungesave të nxënësve, kryesisht janë përgjigjur se hartimi i një plani të tillë është përgjegjësi e shkollave. Sipas tyre, DKA-të kanë përgjegjësi të marrin masa ndaj nxënësve që mungojnë në mësim për më shumë se 30 orë të paarsyeshme dhe të ngritin procedura për masa ndëshkuese ndaj prindërve të tyre në bazë të procedurave ligjore. Megjithatë, nga komunitet nuk u ofruan shembuj që tregojnë se ka filluar të merren masa konkrete ndaj këtyre prindërve, përveç rasteve me ndërprerjen e asistencës sociale në rast të mosdërgimit të fëmijës/ëve në shkollë.

3.1.7. Ekipi komunal për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit

Korniza ligjore. udhëzimi administrativ (nr.19/2012) Themelimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar përcakton se EPRBM-ja në nivel komunal duhet të themelohet nga DKA-ja dhe se anëtar të ekipit duhet të jenë përfaqësues të prindërve, nxënësve dhe drejtorëve të shkollave që janë pjesë e EPRBM-së në nivel shkollë, pastaj përfaqësues të tjerë të EPRBM-së në nivel komunal duhet të jenë ekspertë të institucioneve/organizatave qeveritare dhe joqeveritare, që punojnë me fëmijë, të rinj dhe familjet e tyre. Përkitazi me themelimin dhe funksionin e EPRBM-së në nivel komunal kemi shtruar pyetje për të gjithë përfaqësuesit e intervistuar në nivelin komunal.

EPRBM-të në nivel komunal. Në kohën e realizimit të studimit, 3 nga 7 komunat e përfshira në studim e kanë themeluar EPRBM-të: Fushë-Kosova, Obiliqi dhe Malisheva, kurse përfaqësuesit e DKA-ve që nuk i kanë themeluar ekipet, gjatë intervistave kanë pranuar se janë në dijeni për këtë detyrim ligjor që del nga udhëzimi administrativ për këtë çështje, por se nuk kanë arritur ende ta themelojnë ekipin në nivel komunal. Të intervistuarit në komunat në të cilat nuk janë themeluar EPRBM-të nuk kanë dhënë ndonjë arsye relevante për mosthemelimin e ekipeve, që tregon se DKA-të e këtyre komunave janë treguar më pak të kujdesshme ndaj respektimit të detyrimeve ligjore.

Prej tri komunave që kanë themeluar EPRBM-të, vetëm komuna e Obiliqit ka hartuar planin e veprimit dhe nga intervistat me zyrtarë komunalë nga kjo komunë shihet se ekipi komunal është në përpjekje për ta zbatuar atë, por, sipas përfaqësuesve të komunës, kanë disa ngecje në disa aktivitete që lidhen me kosto financiare.

Komunat që e kanë themeluar EPRBM-në i kuptojnë relativisht mirë rolin dhe përgjegjësitë që i ka EPRBM-ja në nivel komunal, edhe pse ky ekip më shumë shihet si vazhdim i punës së Task Forces për përmirësimin e arsimit të komuniteteve RAE, sidomos kjo vërehet në komunat Ferizaj, Fushë-Kosovë, Obiliqi dhe Pejë. Në këto komuna paraprakisht kanë funksionuar ekipet e Task Forces për përmirësimin e arsimit të komuniteteve RAE. Të intervistuarit në DKA konfirmuan se nuk kanë pasur trajnime të veçanta që lidhen me aspektin praktik të funksionimit të EPRBM-së dhe se këtë e konsiderojnë si nevojë për mbështetje në mënyrë që të bëjnë aktivitete ndërsektoriale për këtë temë dhe të kenë rezultate evidente.

Bashkëpunimi në mes të EPRBM-ve në nivel komunal dhe shkollë. Përfaqësuesit e DKA-s, të intervistuar në Pejë dhe në Ferizaj, raportuan se nuk janë në dijeni se ku qëndrojnë shkollat e komunës së tyre me themelimin e EPRBM-ve në nivel të shkollës. Ndërkaq përfaqësuesit e komunave të tjera konfirmuan se në shkollat ku është më e theksuar braktisja dhe ku janë të përfshirë fëmijët e komuniteteve RAE janë themeluar ekipet, kurse në shkollat e tjera ka iniciativa dhe se shkollat janë në përpjekje e sipër për t'i themeluar këto ekipe.

Përfaqësuesit e DKA-ve që janë intervistuar thonë se shkollave u është shpërndarë udhëzimi administrativ përkatës dhe u është kërkuar që të fillojnë me zbatimin e tij. Komunat që kanë themeluar ekipin komunal, si bashkëpunim konkret me ekipet shkollore marrin përfshirjen e përfaqësuesve të ekipeve shkollore në ekipin komunal. Përfaqësuesit e komunave që kanë themeluar ekipet komunale shprehen se në shumicën e shkollave ku janë themeluar ekipet shkollore nuk janë duke funksionuar ekipet në nivelin e duhur për shkak se shkollat kanë mungesë të buxhetit për realizimin e disa aktiviteteve që lidhen me mbështetjen e fëmijëve në kthimin e tyre në shkollë, apo në mbulimin e terrenit për identifikimin e nxënësve që nuk janë regjistruar në shkollë.

3.1.8. Bashkëpunimi ndërsektorial dhe bashkëpunimi me OJQ-të

Bashkëpunimi ndërsektorial

Qeveritë komunale funksionojnë në bazë të dispozitave ligjore që kryesisht dalin nga Kuvendi i Kosovës dhe nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Qeveritë komunale përbëhen nga drejtori të ndryshme, varësisht nga numri i banorëve në nivel të komunës. Ne në studimin tonë kemi përfshirë sektorë të ndryshëm të drejtorive komunale dhe OJQ-të që lidhen drejtpërdrejt dhe tërthorazi me temën tonë të studimit. Kjo është bërë për të parë se cilat janë praktikat e bashkëpunimit ndërsektorial në të drejtim të identifikimit, referimit dhe të menaxhimit të fëmijëve jashtë shkollës dhe të fëmijëve që janë në rrezik për ta braktisur.

Paraqitja e evidencave në nivel komunal, si dhe përgjigjet e marra gjatë intervistave me përfaqësues komunalë tregojnë se bashkëpunimi ndërsektorial në drejtim të identifikimit, referimit dhe menaxhimit të fëmijëve jashtë shkollës dhe të fëmijëve që janë në rrezik për ta braktisur është duke ndodhur pjesërisht.

Të intervistuarit në nivel komunal pranojnë faktin se nuk kanë ndërtuar ndonjë mekanizëm të veçantë për bashkëpunim ndërsektorial për adresimin e fëmijëve jashtë shkolle. Vetëm në komunën e Obiliqit dhe në komunën e Fushë-Kosovës na ofruan disa informacione për praktikën e bashkëpunimit ndërsektorial. Në këto dy komuna bashkëpunimi më i mirë qëndron me Qendrën për Punë Sociale dhe Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Pastaj bashkëpunimi ndërsektorial është duke u zhvilluar edhe me Zyrën për Komunitete dhe të Kthyer, në dy vitet e fundit është intensifikuar një bashkëpunim më i mirë përkthazi me përpjekjet për të përmirësuar koordinimin e aktiviteteve në mes të nivelit lokal dhe qendror për komunitetet pakicë dhe të kthyerit për të mbështetur integrimin dhe përfshirjen e tyre në edukim. Përfaqësuesit e intervistuar raportuan se bashkëpunimi ndërsektorial ka pasur efekt, sidomos në integrimin e fëmijëve të kthyer nga diaspora, mirëpo nuk paraqiten evidencë me numrin e fëmijëve që janë kthyer nga diaspora dhe janë integruar në shkolla.

Një bashkëpunim tjetër ndërsektorial që është duke ndodhur lidhet me Task Force-në lokale - Terre des home për parandalimin e fëmijëve në punë të rënda e të rrezikshme, ku në këtë bashkëpunim janë të përfshirë zyrtarë policorë, shëndetësorë, socialë dhe zyrtarë nga drejtoria e arsimit në komunë. Të intervistuarit që kanë specifikuar këtë fushë të bashkëpunimit shprehin mendim se nuk mund të flasim për suksese të mëdha në këtë fushë për dy shkaqe: (I) për shkak të gjendjes ekonomike dhe (II) për shkak të mungesës së mekanizmave për monitorimin e fëmijëve të identifikuar se janë të përfshirë në punë të rënda e të rrezikshme.

Në përgjithësi, shihet se format e komunikimit ndërmjet sektorëve janë ad hoc në shumicën e komunave, që është duke u reflektuar për mungesë të mekanizmave të nevojshëm ndërsektorialë për identifikimin, referimin dhe menaxhimin e fëmijëve jashtë shkollës dhe të fëmijëve që janë në rrezik për ta braktisur shkollën.

Bashkëpunimi me OJQ-të

Diskutimet e zhvilluara me fokus grupe të përfaqësuesve të OJQ-ve në shtatë komunat e përfshira në studim nxorën rezultatet në vijim: OJQ-të që veprojnë në komuna bashkëpunojnë pjesërisht me përfaqësuesit e arsimit në nivel të komunës për të adresuar fëmijët jashtë shkolle; OJQ-të në komunat ku janë formuar EPRBM-të janë të informuara se ka EPRBM në nivel komunal dhe OJQ-të që kanë qenë të përfshira në forma të ndryshme për identifikimin e rasteve të braktisjes dhe për përkrahje në edukimin e fëmijëve të komuniteteve RAE kanë përfaqësues të tyre në këtë ekip; vetëm OJQ-të që janë të përfshira në EPRBM e kanë të qartë rolin e EPRBM-ve; të gjitha OJQ-të e përfshira në diskutimet me fokus grupe kanë mbledhur në mënyra të ndryshme informacione për fëmijët jashtë shkollës, sidomos për fëmijët braktisës dhe për fëmijët e komuniteteve RAE që nuk janë të përfshirë në edukim; OJQ-të ofrojnë dëshmi se kanë punuar dhe janë duke punuar në parandalimin e braktisjes; në komunat e Pejës, Obiliqit dhe të Fushë-Kosovës OJQ-të raportuan se kanë përfaqësuesit e tyre edhe në ekipe/komisione të tjera për arsim, por sipas tyre prezenca e tre është ad hoc.

Sfida e identifikuar nga OJQ-të për regjistrimin dhe vazhdimin e shkollës lidhet me: nivelin e ulët të arsimit të prindërve, nivelin e ulët të vetëdijes për rëndësinë e shkollimit, kushtet ekonomike, përkrahjen jo të mjaftueshme për integrim të të kthyerve, lëvizjen e fëmijëve të komuniteteve RAE nga shkollat me mësim në gjuhën shqipe në shkollat me mësim në gjuhën serbe (në Obiliq) për përfitime financiare (sipas të intervistuarve në këtë komunë fëmijët e komuniteteve RAE që regjistrohen në shkollat me mësim në gjuhën serbe përfitojnë 10 euro në muaj).

23 Të intervistuarit në nivel komunal para fillimit të intervistave janë vënë në dijeni se kur flasim për aspektet e gjithëpërfshirjes në shkollat e Kosovës, u referohemi: (I) nxënësve me nevoja të veçanta, (II) nxënësve me dhunti-talent, (III) nxënësve të komuniteteve RAE, (IV) fëmijëve të varfër, (V) fëmijëve me familje problematike, (VI) nxënësve që kanë braktisur shkollën, (VII) nxënësve të komuniteteve të tjera etj.

3.1.9. Gjithëpërfshirja në arsim – praktikat e adresimit në nivel komunal

Aspektet e gjithëpërfshirjes në arsim me të cilat është duke u punuar më shumë në nivel komunal

Drejtoritë komunale të arsimit janë në dijeni se me cilat aspekte të gjithëpërfshirjes janë duke punuar shkollat e komunës, ndryshe nga sektorët e tjerë në nivel komune. DKA-të dhe shkollat për gjithëpërfshirjen në arsim më së shumti janë duke punuar me nxënës me nevoja të veçanta²⁴ dhe me nxënës të komuniteteve RAE.

“Në shkollat e komunës sonë është duke u punuar në të gjitha aspektet, sidomos në mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta dhetë fëmijëve të komunitetit RAE, sepse aty është e shprehur më shumë braktisja dhe mosvijimi i mësimi. Me përkushtim i mbështesim sidomos fëmijët e komunitetit RAE” (Një përfaqësues i intervistuar në DKA).

Edhe pse ka të dhëna së komunat që kanë komunitetet RAE kanë realizuar disa aktivitete për përfshirjen në shkollë të fëmijëve RAE, vërehet se ka mungesë të rezultateve në këtë aspekt.

Një përfaqësues i intervistuar në DKA shprehet kështu: *“Nuk kemi arritur ta adresojnë në mënyrë të drejtë çështjen e regjistrimit dhe të qëndrimit në shkollim të fëmijëve nga komuniteti RAE për arsye se vetëdijesimi i një pjese të këtyre komuniteteve për shkollimin e fëmijëve nuk është në nivelin e duhur. Sapo arrijmë njëfarë sukesi në regjistrimin e fëmijëve të këtyre komuniteteve, menjëherë shfaqet problemi i largimit nga shkolla, i rritjes së mungesave etj”.*

Një përfaqësues nga qendra për punë sociale shprehet kështu: *“Komuna nuk ka pasur sukses në mbajtjen në shkollë të fëmijëve të komuniteteve RAE, sepse një numër i madh i prindërve të këtyre komuniteteve regjistrimin e fëmijëve në shkollë më shumë e bën për punë të dokumentacionit që ua kërkon qendra për punë sociale për të marrë asistencën sociale, sesa që është i vetëdijësuar për rëndësinë e shkollimit të fëmijëve të vet”.*

Megjithatë, sipas DKA-ve, sukseset më të mëdha në adresimin e gjithëpërfshirjes në arsim lidhen me praktikat e suksesshme të përfshirjes në shkollë, përkrahjen e shkollave që kanë klasë të bashkangjitura, përmirësimin e infrastrukturës për përfshirjen e të gjithë fëmijëve në shkollë, formimin e ekipit komunal profesional vlerësues dhe përkrahës për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Shumica e komunave të përfshira në hulumtim kanë prezantuar vendimet e tyre për formimi e ekipeve, vendime të cilat mbështeten në udhëzimin administrativ nr. 07/2012 të nxjerrë nga MASHT për vlerësimin profesional të fëmijëve me nevoja të veçanta edukativo – arsimore.

Në përgjigjet e pyetjes drejtuar përfaqësuesve të DKA-së: “Si organizohet mësimi për fëmijët me nevoja të veçanta në shkollat e komunës suaj?” ata përmendin praktikat e organizimit të mësimi në klasat e bashkangjitura, mbështetjen që u ofrojnë shkollave përmes përkrahjes së mësimdhënësve përfshirës etj.

Përfaqësuesit e tjerë të komunës të intervistuar nuk ishin shumë të sigurt se në cilat aspekte të gjithëpërfshirjes në arsim komuna ka arritur më shumë suksese, përveç përfaqësuesve të QPS-së, ku shumica prej tyre kanë theksuar se suksesin më të madh e kanë arritur në përkrahjen e familjeve të varfra dhe, rrjedhimisht, edhe të fëmijëve të tyre.

Përfshirja e OJQ-ve. OJQ-të treguan se ato ishin pjesërisht në dijeni për implementimin e aktiviteteve për përfshirjen e fëmijëve në shkollë. Ato më së shumti u referohen aktiviteteve të tyre, që promovojnë gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe të fëmijëve të komuniteteve RAE.

24 Të intervistuarit në nivel komunal nxënës me nevoja të veçanta kryesisht i quajnë (I) nxënësit që janë në klasë të bashkangjitura, nxënësit që janë të përfshirë në qendrat burimore dhe që shkollat synojnë t'i integrojnë në klasa të rregullta dhe (II) nxënësit që janë të përfshirë në shkolla speciale.

Ndër sukseset e listuara nga OJQ- të në aspektin e arsimit gjithëpërfshirës gjejmë: fëmijët braktisës i kthejnë suksesshëm në shkollë; punojnë detyra me nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë; organizojnë mësim intensiv për klasat e fëmijëve të komuniteteve RAE dhe integrimin e tyre në klasë të rregullta.

Organizimi i mësimin shtues, mësim plotësues dhe mësim kompensues. Ka të dhëna se niveli lokal i arsimit nuk ka ndërtuar mekanizma të qëndrueshëm për mbështetje të shkollave në organizimin, monitorimin dhe vlerësimin e mësimin shtues, plotësues dhe kompensues. Vetëm nga komuna e Obiliqit u siguruan disa të dhëna për mënyrat e mbështetjes së shkollave nga DKA-ja për të ofruar mësim shtues, mësim plotësues dhe mësim kompensues për nxënës, përfaqësuesit e komunave të tjera të intervistuar këtë përgjegjësi e shohin të shkollave dhe nuk vlerësojnë se DKA-të duhet t'u ofrojë përkrahje shkollave në këtë segment. Iniciativa dhe kërkesa drejtuar shkollave që të organizojnë mësim shtues, apo mësim plotësues dhe mësim kompensues për nxënës është mbështetja që një nga DKA-të e konsideron se është bërë.

Përfaqësuesit e DKA-ve theksojnë se ka nevojë që niveli komunal i arsimit të ndërtojë mekanizma që përkrahin shkollat në ofrimin e këtyre modaliteteve të mësimin. Vështirësi kryesore për implementimin e këtyre formave të mësimin e shohin mungesën e buxhetit dhe mungesën e hapësirës shkollore në shkollat e qytetit.

Diskriminimi në shkollë

Përfaqësuesit e DKA-ve dhe akterët e tjerë në nivel të shkollës tregojnë se niveli komunal nuk ka ndonjë mekanizëm për mbajtjen e evidencave të incidenteve diskriminuese të nxënësve ndaj nxënësve, apo të mësimdhënësve ndaj nxënësve dhe, rrjedhimisht, nuk ka dëshmi se ndaj cilave kategori të fëmijëve është i shprehur më shumë diskriminimi. Zyrtarët policorë të intervistuar kanë treguar se policia ka evidencat e veta që lidhen me çështjet e diskriminimit, mirëpo nuk i kanë të ndarë me ne për çështje procedurale. Ndërkaq ndërhyrjet e nivelit komunal për të mënjeluar diskriminimin ndaj fëmijëve/nxënësve kryesisht janë të lidhura me përkrahjen e OJQ-ve që merren me këtë fushë dhe në komunat që kanë komunitet RAE me formimin e Task Forces për përmirësimin e arsimit të fëmijëve të këtyre komuniteteve.

Sfidat në arsimin gjithëpërfshirës

Përfaqësuesit e nivelit komunal kanë listuar disa probleme të gjithëpërfshirjes në arsim, që nuk janë adresuar në mënyrë të drejtë në komunat e tyre. Tri janë problemet e ngritura nga shumica e pjesëmarrësve të intervistuar:

- (I) çështjen e braktisjes së shkollës të gjithë e shohin si një problem që nuk kanë arritur ta trajtojnë në mënyrë të duhur;*
- (II) puna me fëmijë me nevojë të veçanta është çështje tjetër, për të cilën përfaqësuesit e nivelit komunal shprehen se është një nga problemet që nuk kanë arritur ta adresojnë në mënyrë të kënaqshme dhe*
- (III) regjistrimi dhe përfshirja në shkollim e fëmijëve të komuniteteve RAE vazhdon të jetë një sfidë për të gjitha komunat ku jetojnë këto komunitete.*

OJQ-të kanë një zë më kritik ndaj problemeve të gjithëpërfshirjes në arsim, të cilat ato mendojnë se nuk janë adresuar në mënyrë të drejtë nga niveli komunal.

Bazuar në përvojën e punës së tyre për aspekte të ndryshme të gjithëpërfshirjes, OJQ- të kanë listuar disa probleme të gjithëpërfshirjes në arsim që nuk janë adresuar nga komuna: (I) braktisja e shkollës vazhdon të jetë një sfidë, komunat nuk kanë arritur që t'i parandalojnë të gjithë faktorët që po e nxisin

braktisjen, në vitet e fundit po shtohet numri i nxënësve braktisës edhe për shkak të moslejimit të bartjes së uniformes fetare dhe për shkak të martesave të hershme në mesin e fëmijëve të komuniteteve RAE; (II) regjistrimi dhe përfshirja në shkollim e fëmijëve të komuniteteve RAE vazhdon të jetë një sfidë për faktin se komunat nuk kanë arritur të kenë rezultate të mjaftueshme; (III) integrimi i plotë në shkollë i fëmijëve të kthyer nga diaspora, sidomos i atyre që nuk e njohin gjuhën amtare; (IV) mosvetëdijesimi i prindërve të fëmijëve me nevoja të veçanta për regjistrim, vijueshmëri dhe përkrahje të fëmijëve në shkollë dhe (V) puna me fëmijë/nxënës problematikë – OJQ-të prezantojnë shembuj të sjelljeve devijante të disa fëmijëve problematik si në shkollë, ashtu edhe në mjedise të ndryshme publike.

Edhe pse gjithëpërfshirja në arsim është njëra nga dy prioritet kryesorë të MASHT-it, në shumicën e planeve të zhvillimit të arsimit në nivel komunal që ne kemi pasur rastin t'i analizojmë, nuk kemi gjetur objektiva të qartë dhe aktivitete të cilat do të mund të tregonin se gjithëpërfshirja në arsim është prioriteti kryesor edhe në nivel komunal. Vetëm në planin e zhvillimit të arsimit në komunën e Fushë-Kosovës ekziston një objektiv strategjik për gjithëpërfshirjen e fëmijëve parashkollor, mirëpo këtij plani i mëngojnë aktivitetet se si do të arrihet ky objektiv, cili është plani kohor i arritjes së objektivit etj.

Vlerësimi i nevojave për mbështetje/përkrahje të DKA-ve për adresimin e aspekteve problematike që lidhen më fëmijët jashtë shkolle dhe me funksionimin e EPRBM-ve. Të gjitha DKA-të dakordohen për llojin e mbështetjes që do të jetë e nevojshme në nivelin komunal për t'i rritur praktikat e përfshirjes në shkollë të gjithë fëmijëve që kanë arritur moshën shkollore, për të zvogëluar braktisjen dhe parandalimin e saj. Të gjitha kërkesat e DKA-ve për mbështetje janë të përafërta dhe japin mesazh se kanë nevojë të mbështeten në:

- përgatitjen e një platforme për themelimin dhe funksionalizimin e EPRBM-ve;
- trajnimin e EPRBM-ve dhe përkrahja e tyre në hartimin e planeve të veprimit;
- organizimin dhe mbështetjen ekipeve komunale për të dalë në terren dhe për të identifikuar fëmijët jashtë shkollës;
- organizimin e ligjëratave, debateve të vetëdijesimit me prindër, sidomos të komuniteteve RAE për rëndësinë e shkollimit të fëmijëve të tyre;
- ofrimin e udhëzuesve praktikë për identifikimin e fëmijëve jashtë shkolle, instrumenteve për mbledhjen e të dhënave për fëmijët jashtë shkolle;
- ofrimin e modeleve të raportimit nga zyra për regjistrim civil për fëmijët që kanë arritur moshën e regjistrimit në klasën parafillore dhe në klasën e parë të shkollës fillore dhe
- zhvillimin e mekanizmave lehtësues për zbatimin e politikave për përfshirjen në shkollë të fëmijëve që aktualisht janë jashtë shkollës dhe për masa ndaj prindërve që nuk i dërgojnë fëmijët në shkollë

Përfaqësuesit e komunës së Obiliqit kanë adresuar edhe kërkesën për mbështetje financiare për të adresuar fëmijët jashtë shkolle: *“Në komunën tonë kemi nevojë për një buxhet të veçantë për të mbështetur fëmijët e komuniteteve RAE me mjete higjienike, sepse këto janë kërkesa të shkollave ku mësojnë fëmijët e këtyre komuniteteve. Gjithashtu në komunën tonë kemi nevojë për përkrahje për ndarjen e bursave për fëmijët që kanë nevojë për mbështetje sociale, motivim për shkollë etj”.* Ndërkaq përfaqësuesit e komunës së Malishevës kanë adresuar edhe kërkesën për mbështetje financiare për të siguruar transport të qëndrueshëm për fëmijët me nevoja të veçanta.



4. GJETJET NË NIVEL SHKOLLE

4.1 Shkalla e kënaqësisë me punën e shkollës

Shkalla e kënaqësisë së akterëve kryesorë të shkollës me rezultatet e punës në shkollë u hulumtua nëpërmjet dy formave. Forma e parë përfshin një listë prej më shumë se 20 kërkesave specifike, që lidhen me rezultatet e punës në shkollë, të vendosura në një tabelë me mundësi të vlerësimit prej pesë shkallëve (p.sh. shumë i/e kënaqur apo aspak i/e kënaqur), kurse forma e dytë përfshin pyetje për nxënës dhe mundësi për përgjigje në bazë të alternativave të ofruara për *Pikëpamjet e nxënësve për cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në shkollën e tyre.*

Rezultatet e studimit tregojnë se shkalla e kënaqësisë së prindërve, mësimdhënësve dhe udhëheqësve të institucioneve shkollore me punën e shkollës është relativisht e lartë. Vlerësimet më të larta janë dhënë nga ana e mësimdhënësve, pastaj drejtorëve të shkollave dhe prindërve. Tabela në vijim pasqyron mesataren²⁵ e shkallës së kënaqësisë së prindërve, mësimdhënësve dhe udhëheqjes së shkollës me rezultatet e punës në shkollë.

Tabela 9. Mesatarja e shkallës së kënaqësisë së prindërve, mësimdhënësve dhe udhëheqësve të shkollës me rezultatet e punës në shkollë (shkalla më e lartë 5 pikë)

| Nr. | Aspektet që lidhen me rezultatet e punës në shkollë | Prindërit | Mësimdhënësit | Udhëheqja e shkollës |
|-----|--|-----------|---------------|----------------------|
| 1 | Niveli i përgatitjes së mësimdhënësve | 4.43 | 4.58 | 4.8 |
| 2 | Planifikimi i punës nga mësimdhënësit | / | 4.54 | 3.87 |
| 3 | Angazhimi i mësimdhënësve me nxënës | 3.79 | 4.27 | 3.87 |
| 4 | Vijueshmëria e nxënësve | 3.52 | 3.92 | 3.4 |
| 5 | Interesimi i nxënësve për mësim | 3.6 | 3.88 | 3.64 |
| 6 | Përfshirja e prindërve në shkollë | 2.89 | 3.12 | 2.93 |
| 7 | Përfshirja e komunitetit në shkollë | 2.78 | 3.28 | 2.93 |
| 8 | Zbatimi i metodologjive të mësimdhënies dhe e vlerësimit | / | 4.19 | 3.67 |
| 9 | Pajisjet dhe kabinetet që ka shkolla | 2.35 | 2.63 | 3 |
| 10 | Shfrytëzimi i mjeteve mësimore | 2.7 | 3.71 | 3.27 |
| 11 | Zbatimi i përvojave të trajnimeve në praktikat e klasës | 3 | 4.18 | 3.4 |
| 12 | Rezultatet e nxënësve në vlerësimet e jashtme | 2.67 | 3.75 | 3.53 |

²⁵ Nota 5 (shumë i/e kënaqur) është shkalla më e lartë e vlerësimit të aspekteve që lidhen me rezultatet e punës në shkollë të hulumtuara me pyetësorë të strukturuar me prindër dhe mësimdhënës, si dhe me intervista gjysmë të strukturuar me ë udhëheqës të institucioneve shkollore).

| Nr. | Aspektet që lidhen me rezultatet e punës në shkollë | Prindërit | Mësimdhënësit | Udhëheqja e shkollës |
|-----|---|-------------|---------------|----------------------|
| 13 | Funksionimi i Këshillit Drejtues të Shkollës | 3.19 | 4.32 | 4 |
| 14 | Funksionimi i aktiveve profesionale | / | 4.01 | 3.27 |
| 15 | Respektimi i nxënësve me nevoja të veçanta | 3.48 | 4.21 | 3.62 |
| 16 | Respektimin e nxënësve të komuniteteve të tjera dhe aspekteve të tjera të gjithëpërfshirjes | 3.71 | 4.26 | 4.21 |
| 17 | Udhëheqjen dhe menaxhimin e shkollës | 4 | 4.54 | 4 |
| 18 | Respektimin e rregullave të sjelljes së nxënësve në shkollë | 3.32 | 4.03 | 3.67 |
| 19 | Respektimin e rregullave të sjelljes së mësimdhënësve në shkollë | 3.92 | 4.45 | 3.8 |
| 20 | Përfshirjen e nxënësve në aktivitete të lira dhe në aktivitete ekstrakurrikulare | 2.79 | 4.16 | 4 |
| 21 | Hartimin e planeve zhvillimore të shkollës | 3.46 | 4.32 | 3.67 |
| 22 | Zbatimin e planeve zhvillimore të shkollës | 3.4 | 4.08 | 3.73 |
| | Totali | 3.32 | 4 | 3.65 |

Të dhënat e prezantuara në tabelë tregojnë se prindërit kanë shkallë më të ulët të kënaqësisë me pajisjet dhe kabinetet që kanë shkollat, shfrytëzimin e mjeteve mësimore, rezultatet e nxënësve në vlerësimet e jashtme, përfshirjen e nxënësve në aktivitete të lira dhe në aktivitete ekstrakurrikulare, përfshirjen e prindërve dhe të komunitetit në shkollë. Drejtorët e shkollave kanë shkallë më të ulët të kënaqësisë me përfshirjen e prindërve dhe të komunitetit në shkollë, me pajisjet dhe kabinetet që ka shkolla, si dhe me shfrytëzimin e mjeteve mësimore. Ndërkaq mësimdhënësit kanë shkallë më të ulët të kënaqësisë me pajisjet dhe kabinetet që ka shkolla, si dhe me përfshirjen e prindërve dhe të komunitetit në shkollë. Analiza dhe krahasimi i rezultateve në këtë fushë tregon se mungesa e pajisjeve dhe e kabineteve në shkolla, përfshirja e prindërve dhe e komunitetit në shkollë janë shqetësimet kryesore si të vetë prindërve, ashtu edhe të mësimdhënësve dhe të udhëheqjes së shkollës.

Nivelet e kënaqësisë së prindërve sa ka të bëjë me angazhimin e prindërve dhe të komunitetit në jetën e shkollës janë të ulëta, por janë të ulëta edhe me angazhimin e nxënësve në aktivitetet ekstrakurrikulare, që shpreh një kërkesë të fortë nga prindërit për shkollat që të jenë me shumë të drejtuara drejt përfituesve të tyre, përkatësisht, prindërve, fëmijëve dhe nevojave të tyre. Edhe niveli i kënaqësisë i ulët me mësimdhënien dhe nxënien, përkatësisht me pajisjet e materialet mësimore dhe performancën e ulët të nxënësve dëshmon se disa prindër janë të shqetësuar me cilësinë e arsimin dhe me përvojën që kanë me shkolla.

Edhe me nxënës është hulumtuar shkalla e kënaqësisë së tyre me punën e shkollës. Rezultatet e studimit me nxënës kanë ngritur diskutime dhe analiza krahasuese për të nxjerrë një mesazh përfundimtar të nxënësve për këtë aspekt, pasi në disa raste nxënësit nuk kanë qenë konsistent në përgjigjet e tyre për shkallën e kënaqësisë lidhur me cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies. Rezultatet tregojnë se ekziston një përqindje relativisht e lartë e nxënësve që janë shumë të kënaqur (mbi 48%) dhe mesatarisht të kënaqur (mbi 45%) me cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies në shkollë.

Po ashtu analiza e rezultateve nxjerr edhe një përqindje relativisht të ulët të nxënësve që janë pak të kënaqur (rreth 5%) ose aspak të kënaqur (rreth 2%) me cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies në shkollë.

Në krahasimin e bërë në mes të përgjigjeve të nxënësve pyetjes “*Sa jeni të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në shkollën tuaj?*” me vlerësimin e nevojave të tyre për mbështetje/përkrahje për integrim më të mirë në shkollë dhe për rezultate më të mira në mësim, rezultatet tregojnë se 33 nxënës ose 87% prej 48 nxënësve që janë shprehur se plotësisht janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies në shkollë, kanë theksuar se është jashtëzakonisht i nevojshëm “*organizimi i orëve mësimore shtesë për lëndët që kemi vështirësi në të nxënë*”. Kjo e dhënë tregon se nxënësit në parim shprehen se janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies, por njëkohësisht tregojnë se kanë nevojë për një mësimdhënie më cilësore, sidomos në lëndët ku nxënësit kanë rezultate jo të mira.

Në raportet e rezultateve të testit të arritshmërisë 2011/2012 të ofruara nga disa shkolla, shohim se në disa shkolla rezultatet e nxënësve në disa lëndë mësimore janë nën nivelin e kalueshmërisë, si p.sh. në lëndën e kimisë, ku mesatarja e arritshmërisë është 36.98% , ndërsa në lëndën e matematikës mesatarja e arritshmërisë është 37.71%. Edhe pse disa nga shkollat kanë raportuar gjendjen, nuk kanë dhënë shpjegime se çka ka ndikuar që rezultatet në këto dy lëndë të jenë nën nivelin e kalueshmërisë, nuk kanë dhënë informacione për masat që janë marrë apo që duhet të merren për të përmirësuar rezultatet në këto dy lëndë dhe për të ngritur rezultatet edhe në lëndët e tjera mësimore. Vlen të theksohet se mbi 50% e shkollave të përfshira në studim raportet për rezultatet e testit të arritshmërisë i kanë dërguar për analizë te grupi hulumtues i këtij studimi, ashtu si i ka dërguar në shkolla zyra e vlerësimeve e MASHT-it, që nënkupton se shkollat, në përgjithësi, rezultatet e vlerësimeve të jashtme pak i shfrytëzojnë fare si pikënisje për të ndërmarrë masa drejt përmirësimit të cilësisë së punës në shkollë.

Kur u pyetën nxënësit për të dhënë një vlerësim të përgjithshëm për shkaqet që kanë ndikuar që cilësia e mësimdhënies dhe e nxënies të mos jetë në nivelin e kënaqshëm, ata dhanë përgjigje të ndryshme për disa nga shkaqet e ofruara në pyetësor, përgjigje këto të cilat duhet merren parasysh, sepse tregojnë se të gjitha aspektet e hulumtuara në këtë pikë meritojnë trajtim të veçantë nga shkollat, në mënyrë që vërtet të mënjanohej të gjitha shkaqet që ndikojnë që cilësia e mësimdhënies dhe të nxënies të mos jetë në nivelin e duhur.

Shkaqet kryesore që sipas nxënësve kanë ndikuar që cilësia e mësimdhënies dhe nxënies të mos jetë në nivelin e kënaqshëm, janë:

(I) mungesa e interesimit të nxënësve për mësim (mbi 71%);

(II) mungesa e kabineteve dhe mjeteve mësimore (mbi 57%) dhe

(III) mungesa e disiplinës në klasë (rreth 43%).

Dy shkaqet e fundit lidhen me komponentën e mësimdhënies dhe të nxënies. Kjo tregon një kërkesë të nxënësve për mësimdhënës që ata duhet të sigurojnë mjete dhe materiale mësimore për realizimin e mësimdhënies në klasë, në mënyrë që mësimdhëniet të bëhet interesante. Gjithashtu, sipas kërkesës së nxënësve, mësimdhënësit duhet të menaxhojnë mirë disiplinën në klasë, sepse ajo ndikon drejtpërdrejt në nxënësit që janë në rrezik për të bërë mungesa apo për ta braktisur shkollën. Në pjesën në vijim prezantohen me të dhëna numerike përgjigjet e nxënësve të anketuar për shkaqet që kanë ndikuar që cilësia e mësimdhënies dhe e nxënies të mos jetë në nivelin e kënaqshëm.

Tabela 10. Përgjigjeve të nxënësve sipas numrit për faktorët që kanë ndikuar negativisht në cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies

| “Faktorët që kanë ndikuar negativisht në cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies “ | Totali i respondentëve | PO | JO |
|---|------------------------|----|-----|
| a) Mosangazhimi i mësimdhënësve | 131 | 14 | 117 |
| b) Përgatitja jo e duhur e mësimdhënësve | 130 | 16 | 114 |
| c) Numri i madh i nxënësve në paralele | 133 | 12 | 121 |
| d) Nxënësit e painteresuar për mësim | 131 | 95 | 36 |
| e) Mungesa e mësimi shtues për lëndë mësimore që kemi nevojë” | 130 | 28 | 102 |
| f) Prindërit e painteresuar për të bashkëpunuar me shkollën” | 133 | 26 | 107 |
| g) Vlerësimi i nxënësve pa kritere | 133 | 13 | 120 |
| h) Mungesa e kabineteve dhe e mjeteve mësimore” | 133 | 76 | 57 |
| i) Mungesa e aktiviteteve të lira në shkollë | 132 | 29 | 103 |
| j) Mungesat e shumta në mësim | 130 | 31 | 99 |
| k) Mungesa e disiplinës në klasë | 132 | 56 | 76 |

Nxënësit u pyetën edhe për atë se çka duhet të bëjë me prioritet shkolla e tyre që të përmirësojë cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies. Nxënësit i dhanë përgjigje të ndryshme edhe kësaj pyetjeje. Përsëri përgjigjet e tyre na tregojnë se një numër i madh i aspekteve organizative dhe të mësimdhënies e të nxënies duhet të ndryshohet, në mënyrë që të përmirësohet dhe të avancohet cilësia e mësimdhënies dhe e nxënies. Përgjigjet e nxënësve të anketuar nxorën si prioritet (I) sigurimin e rendit dhe të disiplinës në shkollë dhe (II) organizimin e mësimi plotësues për nxënësit që kanë vështirësi në të mësuar, në mënyrë që të përmirësohet dhe të avancohet cilësia e mësimdhënies dhe e nxënies.

Tabela 11. Përgjigjet e nxënësve të anketuar sipas numrit për atë se çka duhet të bëjë shkolla me prioritet, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e mësimdhënies dhe e nxënies

| Çka mendoni se duhet të bëjë me prioritet shkolla juaj që të përmirësojë cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies? | Totali i respondentëve | PO | JO |
|--|------------------------|----|----|
| a) Të organizojë më mirë punën në shkollë | 133 | 45 | 88 |
| b) Të mbikëqyrë punën e mësimdhënësve në orë mësimore | 133 | 40 | 93 |
| c) Të sigurojë rend dhe disiplinë në shkollë | 131 | 74 | 57 |
| d) Të përfshijë më shume nxënësit në aktivitete shkollore | 130 | 43 | 87 |
| e) Të organizojë mësim plotësues për nxënësit që kanë vështirësi në të mësuar | 132 | 67 | 65 |
| f) Të sigurojë mjete të konkretizimit për mësim në klasë dhe kabinet | 131 | 47 | 84 |
| g) Të organizojë gara të diturisë në nivel të shkollës | 132 | 43 | 89 |

4.2. Mungesat e nxënësve në mësim

Pyetjet e studimit për mungesat e nxënësve në mësim: Sa shpesh shkolla i analizon të dhënat/raportet për mungesat e nxënësve? A mendoni se shkolla implementon aktivitete të duhura për zvogëlimin e shkallës së mungesave të nxënësve në shkollë?

Mungesa e nxënësit në mësim është ndër treguesit e parë se nxënësi/ja është në rrezik për ta braktisur shkollën. Për të bërë një ndërlidhje në mes të trendit të mungesave të nxënësve në mësim dhe

braktisjes së shkollës, në instrumentet e hulumtimit kemi vendosur pyetje të cekura me lart për mungesat e nxënësve në mësim, si dhe kemi analizuar raportet e shkollave që adresojnë mungesat e nxënësve në mësim.

Shumica e raporteve të shkollave për mungesat e nxënësve në mësim tregojnë se numri më i madh i mungesave të nxënësve në mësim është në nivelin e arsimit të mesëm të ulët, përkundrajt arsimit fillor.

Tabela 12. Mesatarja e mungesave të nxënësve sipas shkollave në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2012/2013.

| Nr. | Shkollat | Komunat | Mesatarja e mungesave të nxënësve në orë mësimi në gjysmëvjetorin e parë 2012/2013 |
|-----|-----------------------------|--------------|--|
| 1 | SHFMU "Pjetër Budi" Dardani | Pejë | 13 |
| 2 | SHFMU "Xhemajl Kada" | Pejë | 18 |
| 3 | SHFMU "Gjon Sereqi" | Ferizaj | 9 |
| 4 | SHFMU "Tefik Çanga" | Ferizaj | 8.2 |
| 5 | SHFMU "Trepça" | Istog | 4 |
| 6 | SHFMU "Avni Rrustemi" | Istog | 9 |
| 7 | SHFMU "Pandeli Sotiri" | Obiliq | 13 |
| 8 | SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova" | Obiliq | 3 |
| 9 | SHFMU "Selman Riza" | Fushë-Kosovë | 14.7 |
| 10 | SHFMU "Daut Bugujevci" | Fushë-Kosovë | 14 |
| 11 | SHFMU "Nëna Terezë" | Klinë | 12.75 |
| 12 | SHFMU "Emin Duraku" | Klinë | 12.7 |
| 13 | SHFMU "Ibrahim Mazreku" | Malishevë | 12 |
| 14 | SHFMU "Naim Frashëri" | Malishevë | 13.7 |

Siç shihet nga të dhënat e tabelës, më shumë se gjysma e shkollave të përfshira në studim mesataren e mungesave në shkollë për një nxënës e kanë mbi 10 mungesa dhe nëse i shtojmë kësaj mesatareje edhe mungesat e gjysmëvjetorit të dytë, që përfshin një periudhë më të gjatë kohore, del se mesatarja e mungesave për një nxënës në nivel shkolle të jetë relativisht e lartë dhe ky nivel i mungesave ka ndikim negativ në vijueshmërinë e nxënësve, në rezultatet e tyre në mësim dhe në rritjen e rrezikut të nxënësve për ta braktisur shkollën.

Analiza e raporteve të shkollave që lidhen me mungesat e nxënësve tregon se mesatarja e shkollës së mungesave të nxënësve është më e lartë në shkollat ku numri i nxënësve të komuniteteve RAE është më i madh, se në shkollat ku nuk mësojnë fëmijët e këtyre komuniteteve.

Shkollat raportojnë në DKA dhe në MASHT për mungesat e nxënësve dy herë në vit. Raporti është i ndarë për mungesa të arsyeshme dhe për mungesa të paarsyeshme. Në rregullat e sjelljes së nxënësve në shkollë janë të përcaktuara masat disiplinore ndaj nxënësve, në varësi të numrit të mungesave të paarsyeshme, mirëpo në asnjë dokumente të rregullave të sjelljes në shkollë nuk patëm rastin të shihnim se në cilat raste nxënësve u arsyetohen mungesat dhe në cilat raste nuk u arsyetohen. Në të vërtetë për këtë edhe nuk u pyetën të intervistuarit dhe të anketuarit në nivel të shkollës. Mirëpo fakti se numri i mungesave të arsyeshme dhe të paarsyeshme është gati në proporcion dhe fakti se të dy llojet e mungesave përbëjnë rrezik për të nxitur braktisjen, kërkon që shkollat të definojnë saktë se cilat mungesa të nxënësve në mësim mund të arsyetohen dhe cilat nuk mund të arsyetohen, sepse kjo i bën nxënësit më të kujdesshëm që të mos bëjnë mungesa të paarsyeshme.

Analiza e mungesave në nivel shkolle

Rezultatet tregojnë se shpeshtësia e analizës së të dhënave/raporteve të mungesave të nxënësve ndryshon në mes të shkollave dhe në mes të mësimdhënësve të shkollës së njëjtë. Kjo pasqyrohet në raportet e shkollave për mungesat e nxënësve, por edhe në intervistat me drejtorë dhe mësimdhënës. Figurat në vijim pasqyrojnë përgjigjet e drejtuesve të shkollave dhe të mësimdhënësve për shpeshtësinë e analizës së raporteve të mungesave të nxënësve në mësim.

Figura 2. Përgjigjet e drejtorëve për shpeshtësinë e analizës së raporteve të mungesave të nxënësve në mësim





Figura 3. Përgjigjet e mësimdhënësve për shpeshtësinë e analizës së raporteve të mungesave të nxënësve në mësim



Analiza që u kemi bërë raporteve të shkollave për mungesat e nxënësve tregojnë se nuk mund të flasim ende për një vendimmarrje në nivel të shkollës se sa herë duhet të analizohen mungesat e nxënësve nga kujdestarët e klasave dhe sa herë duhet të bëhet analiza e raporteve të mungesave në nivel të shkollës, si dhe çfarë aktivitete duhet ndërmarrë për zvogëlimin e shkallës së mungesave në nivel të klasës, apo të shkollës. Gjithashtu, nuk mund të flasim ende për plane strategjike dhe aktivitete konkrete të shkollave që kanë probleme me mungesat e nxënësve. Këtë e vërtetojnë edhe përgjigjet e prindërve e pyetjes: A mendoni se shkolla implementon aktivitete të duhura për zvogëlimin e shkallës së mungesave të nxënësve në shkollë? Përgjigjet e tyre janë të ndryshme. Mbi rreth 32% e prindërve shprehen se shkolla ka strategji të mirë dhe ndërmerr aktivitete efektive për të zvogëluar mungesat e nxënësve në shkollë, mbi 28% shprehen se shkolla ndërmerr vetëm disa aktivitete për të zvogëluar mungesat e nxënësve, rreth 16% e prindërve shprehen se shkolla nuk ka kurrfarë strategjie dhe nuk ndërmerr kurrfarë aktivitete për të zvogëluar mungesat e nxënësve. Në mundësinë për të shtuar ndonjë aspekt tjetër sa ka të bëjë me mungesat e nxënësve

në mësim, mbi 15% e prindërve janë shprehur se shkolla shumë shpesh vonohet në informimin e prindërve për mungesat e nxënësve në mësim.

4.3. Braktisja e shkollës

Të kuptuarit e braktisjes

Drejtorët e shkollave tregojnë një nivel të kuptuarit relativisht mirë të definimit që duhet bërë nxënësve që braktisin shkollën, edhe pse në disa definime shohim se ka ndërlidhje me faktorët që kanë nxitur braktisjen dhe me nxënësit që mbesin të panotuar dhe kryesisht u referohen nxënësve të regjistruar e jo edhe nxënësve të cilët nuk janë regjistruar në shkollë dhe nuk kanë ndjekur arsimin e obliguar sipas dispozitave ligjore. Në pjesën në vijim po i pasqyrojmë përkufizimet për nxënësit braktisës që i kanë dhënë udhëheqësit e shkollave të përfshira në studimin tonë.

Kutia 1. Përkufizimi i braktisjes sipas drejtorëve të shkollave

“Definojmë nxënësit që nuk vijojnë mësimin në asnjë shkollë të rrethit tonë, komuna të tjera dhe jashtë shtetit.”

“Fëmijët me raste sociale dhe raste të tjera që e braktisin shkollën nuk e vijojnë mësimin dhe largohen përgjithmonë nga shkolla.”

“Nxënësi braktisës definohet nxënësi që e fillon shkollën, por pastaj e ndërpret shkollën dhe mbetet i pabotuar.”

“Nxënësit që nuk i vijojnë 2/3 e mësimin në shkollë. Nxënësit që nuk janë regjistruar në klasën e parë deri në moshën 12-vjeçare”

Të dhënat e shkollave për braktisjen

Raportet e shkollave të përfshira në studim tregojnë se në të gjitha shkollat ekziston dukuria e braktisjes së shkollës dhe se ekziston një trend i lëvizjes së numrit të nxënësve që braktisin shkollën. Deri sa në disa shkolla është shënuar rënia e numrit të nxënësve që kanë braktisur shkollën në këto dy vitet e fundit, në disa shkolla të tjera ekziston një trend relativisht i vogël i rritjes së numrit të nxënësve që braktisin shkollën. Mirëpo shumica e shkollave nuk kanë raporte që kanë përcjellë trendin e braktisjes nga viti në vit dhe se ekziston një ngatërresë në raporte në mes të nxënësve që kanë mbetur të panotuar dhe nxënësve braktisës.²⁶

²⁶ Nxënësit e panotuar definohen nxënësit të cilët për arsye shëndetësore kanë munguar për një kohë në mësim ose për arsye të tjera nuk kanë qenë prezent në klasë në kohën e vlerësimit me notë. Ndërkaq, sipas udhëzimit administrativ (2011): Krijimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar, “braktisës” është ai nxënësi i cili e ndërpret shkollimin para përfundimit të arsimit të obliguar me ligj. Braktisës është ai nxënësi, i cili edhe pas mbarimit të arsimit të obliguar e vazhdon shkollimin, por e ndërpret atë në një periudhë të mëvonshme, para përfundimit të synuar; “braktisës” është ai fëmijë ose i ri, i cili nuk është regjistruar në shkollë dhe kështu nuk ndjek arsimin e obliguar me ligj.

Tabela 13. Të dhënat për braktisjen, të ofruara nga shkollat e përfshira në studim për vitet shkollore 2011/2012 dhe 2012/2013.

| Shkollat | Komunat | Numri i nxënësve braktisës – viti shkollor 2011/2012 | Numri i nxënësve braktisës – viti shkollor 2012/2013 |
|---------------------------|-----------------|--|--|
| SHFMU “Pjetër Budi” | Pejë | 4 | 13 |
| SHFMU “Xhemajl Kada” | Pejë | 41 | 43 |
| SHFMU “Gjon Sereqi” | Ferizaj | 3 | 2 |
| SHFMU “Tefik Çanga” | Ferizaj | 14 | 15 |
| SHFMU “Trepça” | Istog | 10 | 5 |
| SHFMU “Avni Rrustemi” | Istog | 6 | 5 |
| SHFMU “Pandeli Sotiri” | Obiliq | 11 | 4 |
| SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova” | Obiliq | 5 | 4 |
| SHFMU “Selman Riza” | Fushë-Kosovë | 67 | 60 |
| SHFMU “Daut Bugujevci” | Fushë-Kosovë | 3 | 2 |
| SHFMU “Nëna Terezë” | Klinë | 17 | 20 |
| SHFMU “Emin Duraku” | Klinë | 9 | 3 |
| SHFMU “Ibrahim Mazreku” | Malishevë | 6 | 2 |
| SHFMU “Naim Frashëri” | Malishevë | 3 | 1 |
| | Gjithsej | 199 | 179 |

Nga të dhënat e paraqitura shohim se në secilën shkollë ka pasur nxënës që kanë braktisur shkollën në këto dy vitet e fundit. Trendi i braktisjes së shkollës në vitin e fundit ka shënuar një rënie të lehtë në krahasim me vitin paraprak në 10 shkolla, kurse në 4 katër shkolla të tjera ka pasur rritje të numrit të nxënësve që kanë braktisur shkollën. Në përgjithësi, braktisja e shkollës në shumicën e shkollave të përfshira në studim përbën një shqetësim të madh, për tejkalimin e të cilit kërkohet koordinim dhe angazhim i përbashkët i të gjithë komunitetit arsimor në nivel shkollë dhe me gjerë.

Nga analiza e raporteve statistikore dhe narrative të shkollave për braktisjen vërehet se disa drejtorë i ngatërrojnë në raportet e tyre nxënësit që kanë braktisur shkollën me nxënësit që kanë pasur ndërrim të shkollës gjatë vitit shkollor. P.sh. shkolla “Emin Duraku” në dokumentet e bashkangjitura raporton se ka listën e nxënësve që e kanë braktisur shkollën gjatë vitit 2012/2013. Lista përfshin 38 nxënës. Brenda listës sqarohet se prej tyre 13 nxënës kanë shkuar jashtë vendit, 7 nxënës kanë ndërruar vendbanimet dhe jetojnë në komuna të tjera të Kosovës, kurse 18 janë në shtëpi dhe konsiderohen se janë nxënës braktisës. Disa prej nxënësve që nuk kanë mbaruar arsimin fillor (12 prej 18 nxënësve) që janë braktisës, shënon se janë të lindur në vitet 1995-1998. Sipas raportit, shihet se në raportimet për numrin e nxënësve që kanë braktisur shkollën, të njëjtit nxënës raportohen çdo vit se janë braktisës, edhe pse ata nuk janë regjistruar në shkollë.

Masat që i ndërmarrin shkollat për kthimin në shkollë të nxënësve braktisës

Aktivitetet kryesore që i ndërmerr shkolla janë: biseda me prindër të nxënësve braktisës, biseda me nxënës, kontakte me përfaqësues të komunitetit dhe informim zyrtar në DKA për nxënësit që kanë braktisur shkollën. Dy prej udhëheqësve të shkollave nga komunat Obiliq dhe Fushë-Kosovë janë përgjigjur se në bashkëpunim me MASHT-in dhe organizatën Terre des Hommes kanë zhvilluar aktivitete të cilat kanë nxitur disa nxënës braktisës që të kthehen në shkollë, si lojëra të ndryshme kreative, ku secili nxënës shpreh talentin e vet. Janë organizuar edhe gara të diturisë në mes të nxënësve dhe nxënësit kanë marrë mirënjohje për rezultatet e tyre.

Identifikimi i fëmijëve në rrezik për ta braktisur shkollën

Shumica e mësimeve dhe e udhëheqësve të shkollave të përfshirë në studim (mbi 60%) deklaruan se praktiket kryesore të shkollës në identifikimin e nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollës janë: (I) monitorimi i vazhdueshëm i vijueshmërisë së nxënësve; (II) analiza e shkaqeve të mungesave të nxënësve në mësim dhe (III) analiza e kushteve sociale dhe ekonomike të nxënësve. Përkundrejt këtyre përgjigjeve, vetëm në 2 nga 14 shkolla të përfshira në studim kanë ofruar raporte të shkruara për praktikën e lartcituara në identifikimin e nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollës. Në asnjë shkollë nuk kemi gjetur një sistem gjithëpërfshirës të monitorimit të fëmijëve në rrezik të braktisjes së shkollës. Raportet e dy shkollave tregojnë se shkollat marrin veprime mbi bazën rast-për-rast. Veç kësaj, rreth 80% e mësimeve nuk e kanë praktikë të hulumtojnë shkollën e kënaqësisë së nxënësve në mësim, për të kuptuar nëse ata janë të kënaqur me mësime dhe nxënien, me klimën që ofron shkolla/klasa, me rezultatet e të nxënësve dhe për të identifikuar fëmijët që janë në rrezik të braktisjes së shkollës, 35% e mësimeve nuk i analizojnë rezultatet e nxënësve në mësim, këtë nuk e bëjnë as 46% e drejtorëve të përfshirë në hulumtim.

Sipas udhëheqësve të shkollave, aktivitetet që janë bërë nga shkolla për të mbështetur fëmijët në rrezik për braktisje të shkollës nuk dallojnë shumë nga aktivitetet e ndërmarra për kthimin e nxënësve që kanë braktisur shkollën. Kurse te mësimeve vërehen disa dallime të vogla, sepse mbi 30% e mësimeve shprehën se për nxënësit që janë në rrezik të braktisjes së shkollës *organizojnë mësim shtesë dhe i përfshijnë me shumë në aktivitete të lira*. Aktivitet i përbashkët i ndërmarrë nga mësime dhe drejtorët e shkollave është përkrahja materiale e siguruar në formë të ndryshme për nxënës me kushte të vështira ekonomike dhe sociale.

Mbështetja e shkollave nga DKA

Sipas drejtorëve të shkollave, DKA-të nuk kanë alokuar resurse financiare shtesë për aktivitete për parandalimin e braktisjes në shkolla. DKA-të zakonisht sigurojnë këshilla dhe udhëzime verbale, në vend se të japin udhëzime të shkruara se si të veprojnë shkollat për të parandaluar braktisjen.

Tabela 14. Përgjigjet e drejtorëve për mbështetjen e marrë nga DKA-të në parandalimin e braktisjes sipas drejtorëve të shkollave

| Çfarë mbështetjeje keni marrë nga DKA-ja për të parandaluar braktisjen? | PO | JO | GJ |
|---|----|----|----|
| a) Këshilla dhe udhëzime | 11 | 4 | 15 |
| b) Mbështetje logjistike | 3 | 12 | 15 |
| c) Mjete financiare shtesë | 0 | 14 | 14 |
| d) Trajnime ²⁷ për EPRBM | 4 | 11 | 15 |
| e) Formular për të dhëna | 2 | 12 | 14 |

Përgjigjet e drejtorëve të shkollave tregojnë se DKA-të nuk janë duke i mbështetur në masën e kërkesave dhe të nevojave të shkollave, sidomos në fazën e themelimit dhe të funksionalizimit të EPRBM-ve.

²⁷ Në analizën e dokumenteve të shkollës kemi vërtetuar se trajnimet për EPRBM që janë realizuar në Fushë-Kosovë dhe në Klinë, nuk janë bërë nga DKA-të, por nga GIZ-i që i mbështet këto komuna. DKA-ja ka mbështetur trajnimet në këtë fushë vetëm përmes miratimit të kërkesës së shkollave dhe GIZ-i për të realizuar trajnimet për EPRBM-të.

Nevojat që ka shkolla për të parandaluar braktisjen dhe për të përmirësuar përfshirjen e të gjithë fëmijëve në shkollë janë pasqyruar në përgjigjet e drejtorëve të shkollës të paraqitura në tabelën nr.15.

Tabela 15. Nevojat e shkollave sipas drejtorëve të shkollave për të parandaluar braktisjen dhe për të përmirësuar përfshirjen e të gjithë fëmijëve në shkollë

| Për çfarë mbështetjeje ka nevojë shkolla e juaj për të parandaluar braktisjen dhe për të përmirësuar përfshirjen e të gjithë fëmijëve në shkollë? | PO | JO | GJ |
|---|----|----|----|
| a) Doracakë për praktikatat e parandalimit të braktisjes | 12 | 3 | 15 |
| b) Shembuj nga praktikat e mira të shkollave të tjera | 10 | 5 | 15 |
| c) Trajnime për praktikatat e parandalimit të braktisjes | 11 | 3 | 14 |
| d) Mbështetje logjistike | 9 | 5 | 14 |
| e) Mjete financiare shtesë | 11 | 4 | 15 |

Përgjigjet e drejtorëve të shkollave tregojnë se shkollat duhet të mbështetën/përkrahen me doracakë për praktikatat e parandalimit të braktisjes, praktikatat e mira në këtë fushë, trajnimet e ekipeve shkollore, mbështetjen logjistike, meqë kanë pak përvojë në këtë fushë, por edhe me mjete financiare, meqë janë disa aktivitete të cilat kanë kosto financiare, si p.sh. vizitat në shtëpi të fëmijëve që kanë braktisur shkollën.

4.4. Ekipi i shkollës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit (EPRBM)

Situata në shkollë

Udhëzimi administrativ (nr.19/2012) Krijimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar përcakton se EPRBM-ja në nivel shkolle duhet të themelohet nga secila shkollë dhe themelimi të bëhet nga këshilli i shkollës.

Udhëheqësit e 9 shkollave prej 14 shkollave kanë theksuar gjatë intervistave se tashmë në shkollat e tyre janë themeluar EPRBM-të, mirëpo vetëm gjashtë shkolla kanë ofruar dëshmi të shkruara për themelimin e tyre.

Tabela 16. Lista e shkollave që kanë ofruar dëshmi për themelimin e EPRBM-ve

| Shkolla | Komuna |
|----------------------------|--------------|
| SHFMU " Gjon Sereqi" | Ferizaj |
| SHFMU " Tefik Çanga" | Ferizaj |
| SHFMU " Avni Rrustemi" | Istog |
| SHFMU " Pandeli Sotiri" | Obiliq |
| SHFMU " Dr.Ibrahim Rugova" | Obiliq |
| SHFMU " Selman Riza" | Fushë-Kosovë |

Vendimet e themelimit të EPRBM-ve, të bashkangjitura në mesin e dokumentacionit shkolle për analizë cilësore, tregojnë se shkollat që e kanë themeluar EPRBM-në, në përgjithësi, kanë ndjekur udhëzimet e përcaktuara në udhëzimin administrativ për këtë çështje.

Edhe prindërit dhe mësuesit janë pyetur për themelimin e EPRBM-ve. Prindërit më se paku janë të informuar për themelimin e EPRBM-ve, kurse pas tyre vijnë mësuesit. Mbi 53% e

prindërve nuk janë në dijeni se janë themeluar në nivel shkolle EPRBM-të, kurse mbi 26 % e mësimeve nuk e dinë a është themeluar apo nuk është themeluar EPRBM-ja në shkollën e tyre, 13 % janë të sigurt se ekipi nuk është themeluar, kurse përqindja tjetër shprehen se në shkollën e tyre është themeluar ekipi.

Drejtorët dhe mësimeve të shkollave, në të cilat janë themeluar EPRBM-të, tregojnë se ekipet janë themeluar relativisht vonë dhe se nuk mund të flasim ende për funksionimin efektiv të tyre. Vetëm 32% e mësimeve dhe drejtuesve të shkollave përgjigjen pozitivisht se EPRBM-të janë duke funksionuar në mënyrë efektive, kurse 54% përgjigjen se deri diku është duke funksionuar ekipi, 14% përgjigjen se ekipi nuk është duke funksionuar në mënyrë efektive. Ndërkaq përgjigjet e prindërve dallojnë për disa nuanca. Mbi 26% u përgjigjen me PO – ekipi funksionon në mënyrë efektive, mbi 30% përgjigjen me JO , mbi 25% përgjigjen me nuk e di, kurse mbi 17% nuk kanë dhënë përgjigje se a është duke funksionuar në mënyrë efektive EPRBM-ja në nivel të shkollës. Nga analiza e raporteve të shkollave që trajtojnë dukurinë e braktisjes kemi mësuar se shkollat e mbështetura nga programi i GIZ-it për themelimin e EPRBM-ve janë duke funksionuar pak më mirë se në shkollat e tjera ku nuk ka pasur asnjë mbështetje për këtë fushë.

Roli i EPRBM-ve

Ekziston një perceptim deri diku i qartë për rolin e EPRBM-ve. Sipas pjesëmarrësve të përfshirë në studim, roli i EPRBM-ve më shumë është i lidhur me parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe më pak përfshin rolin e EPRBM-ve për problemin e mosregjistrimit të fëmijëve dhe të rinjve të moshës shkollore në arsimin e obliguar. Prindërit treguan se fare pak janë të informuar me rolin e EPRBM-ve. Në pjesën në vijim, po prezantojmë, pa ndërhyrje perceptimet e udhëheqësve të shkollave, mësimeve dhe të prindërve për rolin që ka EPRBM-ve.

Kutia 2. Të kuptuarit e rolit të EPRBM-ve sipas drejtorëve të shkollave, mësimeve dhe prindërve

| |
|--|
| Drejtorët e shkollave |
| <i>“EPRBM-ja këshillon, sugjeron dhe ndihmon parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit në shkollë.”</i> |
| <i>“Ekipi ka rol në identifikimin e rasteve të braktisjes, shkaqeve dhe mundësive për përzgjedhjen e aktiviteteve për parandalimin e braktisjes”.</i> |
| <i>“Të marrë masa për parandalimin e dukurisë së braktisjes së shkollës”.</i> |
| Mësimeve |
| <i>“EPRBM-ja luan një rol të rëndësishëm në kthimin e nxënësve në mësim”.</i> |
| <i>“EPRBM-ja sipas perceptimit tim është një ekip i qëlluar, por duhet të funksionojë rregullisht që t'i ndalojmë këto dukuri negative”.</i> |
| <i>“Identifikimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe i minoriteteve, puna me këta fëmijë, angazhimi i tyre për parandalimin e braktisjes së shkollës”.</i> |
| <i>“Ka rol të veçantë dhe shumë të rëndësishëm për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe mos regjistrimit të nxënësve në shkollë”.</i> |
| <i>“Ka rol të veçantë në parandalimin e kësaj dukurie dhe ndihmon në sensibilizimin e kësaj çështjeje”.</i> |
| <i>“Perceptimi im është se duhet të punojë EPRBM-ja, sepse në viset rurale shumë nxënës e braktisin shkollën”.</i> |
| <i>“Roli i EPRBM-së është jashtëzakonisht me vlerë për arsye të ndihmës së nxënësve për mosbraktisje dhe kthim në shkollë dhe bashkëpunim me stafin e shkollës”.</i> |
| <i>“Roli i këtij ekipi është pozitiv, sepse merret kryesisht me nxënësit dhe vijueshmërinë e tyre në shkollë”.</i> |
| <i>“Të parandalohen mungesat, braktisja, mosregjistrimi i fëmijëve në shkollë”</i> |

Prindërit

“Duhet të jetë aktiv dhe të reagojë shpejt për parandalimin e braktisjes”.

“Ky ekip është i domosdoshëm që ta kenë parasysh komunitetet (RAE) të angazhohen më shumë”.

“Roli i këtij këshilli është i dukshëm për arsye, sepse ndikon drejtpërdrejt në pengimin e braktisjes dhe përfshirjen e gjithë fëmijëve në shkollë”.

“Te prindërit e komunitetit RAE ka mungesë , nuk vijnë në takime dhe si arsyetim për mungesat e fëmijëve janë kushtet ekonomike”.

Përveç perceptimit të rolit që ka EPRBM-ja, për përfaqësuesit e shkollave që tash më kanë themeluar EPRBM-në kemi shtruar pyetjen: Çka ka bërë EPRBM-ja gjatë këtij viti? Përgjigjet e marra sintetizojnë perceptimin e përfaqësuesve të shkollave për rolin e EPRBM-ve, ku sipas tyre të gjitha aktivitetet lidhen me biseda me prindër dhe me nxënës për parandalimin e braktisjes dhe për kthimin në shkollë të nxënësve që paraprakisht kanë braktisur shkollën. Aktivitetet e listuara tregojnë se nuk mund të flasim ende për ndonjë plan konkret që EPRBM-të kanë zhvilluar dhe janë duke punuar pas themelimit. Prej nëntë shkollave ku, sipas drejtorëve, janë themeluar EPRBM-të, vetëm pesë prej tyre kanë deklaruar se shkolla ka hartuar një dokument në të cilin është shpjeguar qartë roli dhe misioni i EPRBM-së. Mirëpo në analizën që u kemi bërë dokumenteve të shkollës, planeve të zhvillimit të shkollave, nuk kemi gjetur dëshmi, në të cilat është shpjeguar qartë roli dhe misioni i EPRBM-ve, si dhe nuk kemi gjetur plane të veprimit.

4.5. Gjithëpërfshirja në arsim – praktikat në nivel shkollë

Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë. Dëshmitë tregojnë se deri tash shkollës nuk i dërgohen as nga zyra e regjistrimit civil dhe as nga DKA-ja listat e fëmijëve të zonës që janë në moshë për t'u regjistruar në klasën e parë.

Përgatitja e regjistrave për regjistrim në klasën e parë bëhet kryesisht nga vetë shkollat, disa i plotësojnë ato nga klasa parafillore (nëse kanë), nga prindërit që i sjellin të dhënat për regjistrimin e fëmijëve. Shkollat e qytetit bashkëpunojnë me institucionet parashkollore për të siguruar të dhëna për nxënësit që duhet të regjistrohen në klasën e parë. Shkollat prezantojnë instrumente me kritere për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë. Analiza e tyre tregon se vetëm 4 (ato me psikolog ose pedagog) nga 14 kanë zhvilluar instrumente dhe kritere më të qarta për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë. Në analizën e kritereve të shkollave për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë, te 1/3 e shkollave të përfshira në studim kemi identifikuar tri kritere të regjistrimit :

- i. Regjistrimi pa e ditur emrin e mësuesve të klasës së parë – prindërve u rekomandohet që vetëm ta regjistrojnë fëmijën pa e përcaktuar mësuesin/en, kurse këtë e bënë më vonë shkolla dhe i njofton prindërit;*
- ii. Regjistrimi me dëshirën e prindërve për të zgjedhur mësuesin e klasës së parë, deri të një numër i caktuar – mirëpo nuk përcaktohet deri në cilin numër rendor të regjistrimit për paralelen “X” prindërit mund të përzgjedhin mësuesin/en;*
- iii. Kompletimi i paraleles me nxënës sipas kërkesave të prindërve.*

Përgjigjet e nxënësve në pyetëtorin e strukturuar për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë tregojnë se shkollat bashkëpunojnë pak me nxënësit e regjistruar për mbledhjen e informatave për fëmijët që kanë mbushur moshën për t'u regjistruar në shkollë dhe nuk janë regjistruar ende. Nxënësit i pyetem: Në rrethin tuaj shoqëror, familjar apo miqësor a njihni ndonjë fëmijë që e ka moshën për të

shkuar në shkollë (mbi 6 vjeç) dhe nuk është regjistruar deri me tani në asnjë shkollë? Mbi 18 % e nxënësve të përfshirë në studim u përgjigjen se njohin nga një rast të fëmijëve që nuk është regjistruar në shkollë, rreth 9 % njohin nga dy raste, kurse rreth 8% njohin më shumë se tri raste. Në fazën e parë do të ishte e mjaftueshme që shkollat t'i mbledhin të dhënat e këtyre fëmijëve dhe pastaj në bashkëpunim me prindër dhe kujdestarë të fëmijëve do të mund të identifikonin arsyet pse këta fëmijë nuk janë regjistruar dhe cilat masa duhet marrë për regjistrimin e tyre.

Lidhur me regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë drejtorët e shkollave dhe mësimitdhënësit e theksuan nevojën për përfshirjen e stafit pedagogjik dhe psikologjik, në mënyrë që të identifikohen me kohë aspektet hyrëse të fëmijëve në shkollë dhe fëmijët të kenë përkrahje adekuate. Në shumë shkolla nuk ka pedagog dhe psikolog, edhe pse si pozita profesionale janë të lejuara me normativin e personelit në shkolla.

Bashkëpunimi i shkollave me OJQ-të dhe me institucione të tjera. Sipas udhëheqësve të shkollave dhe mësimitdhënësve, bashkëpunimi me OJQ-të dhe me institucione të tjera për të siguruar përfshirjen e të gjithë fëmijëve në shkollë është relativisht i shpeshtë dhe se shkollat janë të hapura për bashkëpunim me të gjitha OJQ-të që kanë për synim përkrahjen e gjithëpërfshirjes në shkollë. Ndërkaq analiza e gjetjeve për bashkëpunimin e shkollës me mjekë dhe psikologë për nxënësit që kanë nevojë për mbështetje shtesë tregon se ekzistojnë dallime në mes të përgjigjeve të udhëheqësve të shkollave dhe mësimitdhënësve. Derisa rreth 50% e udhëheqësve të shkollave të përfshirë në studim thonë se bashkëpunojnë sipas nevojës me mjekë dhe psikologë për nxënësit që kanë nevojë për mbështetje shtesë, këtë e thonë edhe 26% e mësimitdhënësve të përfshirë në studim. Ndërsa rreth 50 % e udhëheqësve të shkollave dhe 29% e mësimitdhënësve shprehen se kanë bashkëpunim të shpeshtë me mjekë dhe psikologë, që dëshmohet fare pak në raportet e punës së shkollës dhe në dokumentet e tjera të shkollës të analizuar për këtë studim. Përqindja tjetër e mësimitdhënësve, mbi 45% e tyre, thonë se asnjëherë nuk bashkëpunojnë me mjekë dhe me psikologë.

Diskriminimi i nxënësve. Përkitazi me incidentet diskriminuese të nxënësve ndaj nxënësve dhe të mësimitdhënësve ndaj nxënësve janë pyetur nxënësit, prindërit, mësimitdhënësit dhe udhëheqësit e shkollës. Rreth 34% e nxënësve (ose 45 nxënës prej 133 nxënësve të përfshirë në hulumtim) thonë se kanë qenë dëshmitarë kur ndonjë mësimitdhënës i shkollës së tyre ka trajtuar keq ndonjë nga nxënësit e shkollës/klasës së tyre. Prej nxënësve që janë përgjigjur me PO se kanë qenë dëshmitarë të rasteve të keqtrajtimit të nxënësve kemi kërkuar që të tregojnë shpeshhtësinë e grupeve të nxënësve që janë trajtuar keq nga mësimitdhënësit e tyre dhe shumica e nxënësve që kanë dhënë përgjigje PO janë përgjigjur edhe për grupet e nxënësve që janë trajtuar keq nga mësimitdhënësit e tyre. Tabela nr.15 paraqet rezultatet e përgjigjeve sipas numrit të nxënësve për shpeshhtësinë e grupeve të nxënësve që janë keqtrajtuar nga mësimitdhënësit e tyre.

Tabela 17. Shpeshhtësia e keqtrajtimit të nxënësve nga mësimitdhënësit e tyre mësuesit në kategorinë e viktimës, sipas nxënësve

| Grupet e nxënësve | Shpesh | Nganjëherë | Rrallë | Asnjëherë | Gjithsej |
|---|--------|------------|--------|-----------|----------|
| Djemtë | 12 | 17 | 11 | 1 | 41 |
| Vajzat | 3 | 12 | 12 | 10 | 37 |
| Nxënësit me aftësi të kufizuara | 1 | 1 | 2 | 27 | 31 |
| Nxënësit shumë të varfër dhe të rrezikuar | 2 | 5 | 7 | 17 | 31 |
| Nxënësit me rezultate të ulëta në mësim | 12 | 9 | 5 | 5 | 31 |
| Nxënësit RAE | 0 | 9 | 4 | 13 | 26 |
| Nxënësit të komuniteteve të tjera | 1 | 7 | 11 | 11 | 30 |

Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë se sipas nxënësve, djemtë dhe nxënësit me rezultate të ulëta në mësim janë më të atakuar nga keqtrajtimet e mësimdhënësve të tyre, pastaj vijnë vajzat, kurse nxënësit me aftësi të kufizuara më së paku keqtrajtohen prej mësimdhënësve. Përgjigjet e prindërve, mësimdhënësve dhe udhëheqësve të shkollave bien ndesh me përgjigjet e nxënësve sa i përket incidenteve diskriminuese të nxënësve ndaj nxënësve dhe të mësimdhënësve ndaj nxënësve, sepse shumica e tyre thonë se asnjëherë ose rrallë herë ka incidente diskriminuese në shkollë. Përgjigjet e tyre me nxënës përputhen vetëm në atë se djemtë dhe nxënësit me rezultate të ulëta në mësim janë më të atakuar nga keqtrajtimet e mësimdhënësve të tyre, por edhe nga vetë bashkëmoshatarët.

Përfshirja në shkollë e grupeve të pafavorizuara. Analiza e përgjithshme e gjetjeve nga hulumtimi me pyetësor të strukturuar për përfaqësuesit e shkollave të përfshira në studim, si dhe dëshmitë e ofruara nga shkollat tregojnë se disa shkolla për përfshirjen në shkollë të fëmijëve me aftësi të kufizuara, bashkëpunojnë me DKA-të, MASHT-in, OJQ-të – si Hendikos, kanë rregulluar infrastrukturën, dhomat e mësimi, transportin, kanë siguruar mjete mësimore, si dhe kanë themeluar grupin për gjithëpërfshirje, kanë mësimdhënës të trajnuar për gjithëpërfshirjen. Ndërsa shkollat që kanë fëmijë/nxënës të komuniteteve RAE tregojnë shembuj të shumtë se si janë duke bashkëpunuar me këto komunitete me qëllim të përfshirjes në shkollë të të gjithë fëmijëve. Një gjë e tillë nuk është e reflektuar mirë në planet e zhvillimit të shkollave. Prej 14 PZSHSH-ve të analizuar, vetëm gjysma prej tyre kanë aktivitete të planifikuara për të rritur pjesëmarrjen e nxënësve në shkollë, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrjen e fëmijëve të komuniteteve RAE, mirëpo aktiviteteve të planifikuara u mungojnë aspektet të tjera të planifikimit, si bartësit e aktiviteteve, afati kohor i realizimit të aktiviteteve, treguesit që dëshmojnë realizimin e aktiviteteve etj.

Plani individual i arsimit. Përkitazi me zhvillimin e planeve individuale të arsimit (PIA) për fëmijët që kanë nevoja të veçanta në arsim janë pyetur prindërit, mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollave. Rezultatet tregojnë se vetëm prindërit që kanë fëmijë me nevoja të veçanta janë në dijeni për ekzistimin e PIA-s. Rezultatet gjithashtu tregojnë se shumica dërmuese e prindërve që i kanë fëmijët me nevoja të veçanta në shkollat e përfshira në studim nuk kanë marrë pjesë në hartimin e PIA-s dhe nuk e dinë se si punohet me këto plane. Afërsisht të njëjtën gjë e pohojnë edhe mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollave. Kjo vërtetohet edhe me analizën e dëshmimeve (dokumenteve) të shkollave. Kjo analizë tregon se vetëm në shkollat që ka klasë të bashkangjitura hartohen PIA-t në bazë të një modeli/instrumenti të planifikimit të ofruar nga zyra për arsim me nevoja të veçanta në MASHT.

Mësimi alternativ. Mësimi plotësues, mësimi shtues, mësimi kompensues, intensiv dhe aktivitetet jashtëmësimore janë modalitete të mësimi që ofrohen nga shkollat gjithëpërfshirëse. Aspektet e organizimit të këtyre llojeve të mësimi i kemi hulumtuar nëpërmjet pyetësorëve të strukturuar me mësimdhënës, prindër dhe drejtues të shkollave dhe përmes analizës së dokumentacionit shkollor. Analiza e gjetjeve nga hulumtimi me pyetësorë të strukturuar tregon se në shkollat e përfshira në studimin tonë ofrohen kryesisht aktivitetet e lira dhe aktivitetet jashtëmësimore. Vlen të theksohet se ka disa raste ku respondentët tanë kanë theksuar se ofrohet edhe mësim shtues, plotësues dhe kompensues, mirëpo ato raste janë më të vogla në numër dhe nuk janë shumë të argumentuara me dokumente dhe raporte që i kanë ofruar shkollat. Në disa nga planet e shkollave për mësimin plotësues dhe për mësimin shtues nuk gjejmë asnjë dallim si në përmbajtjen që synohet t'u ofrohet nxënësve, ashtu edhe në rezultatet e pritura.

Njëra nga shkollat e përfshira në studim ka ofruar një raport për mësimin intensiv, ku tregon numrin e nxënësve (85 nxënës) nga klasa 1-5 që kanë ndjekur mësimin intensiv. Raporti tregon se nxënësit që kanë ndjekur mësimin intensiv janë të moshave të ndryshme, disa prej tyre janë të moshës 15-vjeçare dhe kanë vijuar mësimin në klasën e parë, disa të tjerë janë të moshës 17-vjeçare dhe kanë vijuar mësimin në klasën e dytë etj. Në raportet e shkollave mungojnë dëshmitë e shkruara se cilat janë praktikatat e menaxhimit të klasave me nxënës të moshave të ndryshme, kur dihen ndikimet veçanërisht në aspektin e shoqërorizimit të fëmijëve.

Drejtorët e shkollave kanë shpjeguar së nuk kanë proceduara të shkruara për ofrimin e mësimit shtesë për nxënësit që kanë munguar për një kohë të gjatë në shkollë për shkak të sëmundjeve kronike apo arsyeve të tjera.

Mbështetja materiale e fëmijëve të familjeve të varfra. Analiza e përgjithshme e gjetjeve nga hulumtimi me pyetësorë të strukturuar me përfaqësuesit e shkollave të përfshirë në studim, si dhe gjetjet nga analiza e dokumenteve dhe e raporteve të punës së shkollës, të analizuar për mbështetjen që u ofrojnë shkollat fëmijëve të familjeve të varfra, tregojnë se në shkolla vazhdon një traditë e mirë e mbështetjes së fëmijëve të familjeve të varfra me materiale mësimore ose me tarifa lehtësuese për ekskursione dhe aktivitete të tjera në të cilat duhet të participojnë familjet, edhe pse raportet e shkollave tregojnë për mundësi të limituara për përkrahje.

4.6. Vlerësimi i nevojave të shkollës për mbështetje/përkrahje në adresimin e fëmijëve jashtë shkollës, parandalimin e braktisjes dhe në rrugën e saj drejt shkollave gjithëpërfshirëse

Drejtorët e shkollave dhe mësime dhënësit u shprehën për nevoja të mëdha për mbështetje/përkrahje në adresimin e fëmijëve jashtë shkollës, parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe gjithëpërfshirës në arsim.

Tabela 18. Vlerësimet e drejtorëve të shkollave dhe të mësime dhënësave për mbështetje/përkrahje në adresimin e fëmijëve jashtë shkollës, parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe gjithëpërfshirës në arsim.

| Vlerësimet | “Jashtëzakonisht e nevojshme dhe shumë e nevojshme” | | Mesatarisht e nevojshme | |
|---|---|-----------------|-------------------------|-----------------|
| | Drejtorët | Mësime dhënësit | Drejtorët | Mësime dhënësit |
| Nevojat e shkollës | | | | |
| 1. Trajnimi i ekipeve shkollore për adresimin e drejtë të fëmijëve jashtë shkollës dhe parandalimin e braktisjes. | 93% | 75% | 7% | 13% |
| 2. Ofrimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave për fëmijët jashtë shkollës | 87% | 83% | 13% | 11% |
| 3. Ofrimi i instrumenteve për identifikimin dhe monitorimin e fëmijëve në rrezik për ta braktisur shkollën | 80% | 71% | 20% | 16% |
| 4. Trajnim/doracak/praktika të mira për zvogëlim të mungesave në shkollë | 73% | 81% | 13% | 16% |
| 5. Trajnimi i ekipeve shkollore për t’iu qasur në mënyrë të drejtë kërkesave të gjithëpërfshirjes dhe efektivitetit të mësime dhënies dhe nxënies | 93% | 78% | 7% | 16% |

| Vlerësimet | “Jashtëzakonisht e nevojshme dhe shumë e nevojshme” | | Mesatarisht e nevojshme | |
|---|---|-----|-------------------------|-----|
| | | | | |
| 6. Shembuj të praktikave të mira se si të përkrahen nxënësit me arritshmëri të ulët | 87% | 88% | 13% | 9% |
| 7. Ofrimi i udhëzuesve dhe i doracakëve për praktikën e përdorimit të standardeve të Shkollave Mike në vetëvlerësimin e punës së shkollës | 86% | 83% | 14% | 13% |
| 8. Ofrimi i udhëzuesve dhe i doracakëve për të ndihmuar hartimin e planeve zhvillimore të shkollës | 67% | 85% | 33% | 7% |

Vlerësimet e mësimit dhe të drejtorëve të shkollave për nevojat më mbështetje/përkrahje dallojnë më së shumti për: Ofrimin e udhëzuesve dhe të doracakëve për të ndihmuar hartimin e planeve zhvillimore të shkollës. Dallimi është evident për faktin se shumica e drejtorëve të shkollave janë përfshirë në programin e trajnimit për udhëheqje arsimore, ku njëri nga seminarët e këtij programi ofron udhëzime dhe shembuj të mjaftueshëm për hartimin e planeve zhvillimore të shkollës, ndërsa shumica e mësimit nuk kanë pasur rastin të ndjekin këtë program dhe t'i shohin udhëzimet e programit për hartimin e PZSHH-së.

Ndërkaq nxënësit me vlerësimin e lartë të nevojave të tyre për mbështetje/përkrahje për integrim më të mirë në shkollë dhe për rezultate më të mira në mësim treguan se kanë nevojë të mbështeten më së shumti në tri aspekte: (I) në informim për mundësitë e arsimimit të mëtejshëm, për zgjedhje të karrierës dhe të profesionit (kërkuan 112 nxënës prej 133 nxënësve); (II) në organizimin e orëve mësimore shtesë për lëndet që kemi vështirësi në të nxënë (kërkuan 98 nxënës prej 133 nxënësve) dhe (III) në mbështetje për të qenë më të pavarur në mësim dhe më të sigurt në shkollë (kërkuan 113 nxënës prej 133).

Me vlerësimet e tyre nxënësit shprehën se kanë nevojë për mbështetje edhe për (I) përfshirjen në aktivitete të lira në shkollë dhe në aktivitete ekstrakurrikulare dhe klube shkollore (kërkuan 72 nxënës prej 133 nxënësve) dhe (II) angazhimin në projekte dhe aktivitete interesante në shkollë (kërkuan 74 nxënës prej 133 nxënësve).

Nxënësve në fund të pyetësorit të strukturuar iu kërkua që të japin ndonjë koment apo sugjerim se çka mund të bëjnë më shumë shkolla dhe mësimit për mbështetje/përkrahje të nxënësve në integrimin më të mirë në shkollë dhe për rezultate më të mira në mësim. Në këtë kërkesë të hapur, nxënësit shtruan kërkesa të ndryshme, të cilat ne i kategorizuar sipas përgjigjeve që kanë adresuar më shpesh elementet e kategorizimit të bërë:

- mësimit cilësor dhe punë/aktivitete praktike;
- mësimit plotësues për nxënësit që kanë vështirësi në mësim;
- disiplinë më të mirë në klasë dhe shkollë;
- aktivitete të lira dhe sportive;
- materiale dhe pajisje mësimore më të mira;
- marrëdhënie më të mira në mes të mësimit dhe nxënësve;
- fëmijët me nevoja të veçanta dhe me probleme sociale e ekonomike të përkrahen nga të gjithë;

- informim për edukim në karrierë;
- përfshirje e prindërve në shkollë dhe
- materiale informative për integrimin e të gjithë fëmijëve në shkollë.

Kutia 3. Sugjerimet e nxënësve për të përmirësuar vijueshmërinë dhe për të parandaluar braktisjen e shkollës

„Çdo mësimit duhet ta trajtojë nxënësin në mënyrën më profesionale, pa marrë parasysh se çfarë komuniteti, feje, race apo gjinie ka“.

„Çdo mësimit duhet të angazhohet më shumë me të gjithë ata nxënës të cilët nuk janë aq të mirë në mësim dhe që bëjnë mungesa në mësim“.

„Mësimit duhet jo vetëm të interesohen për nxënës, por edhe t'i njohin ata dhe t'i kuptojnë problemet e tyre“.

“Fëmijët që janë me nevoja t'u ndihmojmë, t'u ofrojmë dashuri dhe t'i trajtojmë si çdo fëmijë tjetër”.

“Investim në mjete të nevojshme për zhvillim të mësimit, sigurim të kabineteve të ndryshme dhe të sallës sportive”.

“Mendoj që kemi nevojë për mirësjelljen e mësimit dhe përdorimin më pak të fjalëve banale ndaj nxënësve”.

“Mendoj se shkolla jonë duhet të organizojë mësim plotësues, të ketë gjithashtu kabine të nevojshme dhe mjete mësimore, aktivitete të lira dhe disiplinë”.

“Mësimit duhet të jenë më të përgatitur dhe më tolerantë”.

“Një sugjerim për mësimit është të jenë të durueshëm me nxënësit, të mundohen t'i bëjnë nxënësit të lirë në anën e tyre jo në atë masë deri sa nxënësi e prish orën mësimore”.

“Pikë së pari të sigurojë mjete për mësim. Disiplina të jetë në nivel të lartë. Të sigurojë librat, të organizojë gara të diturisë”.

„Shkolla dhe mësimit mund të bëjnë më shumë duke na informuar për mundësitë e arsimimit të mëtejshëm dhe duke organizuar orë shtesë dhe aktivitete jashtëshkollore“.

„Shkolla është mirë t'u ndihmojë të varfërve në mësim, sepse ndoshta ata s'i kanë kushtet të vijin në shkollë“.

“Sipas mendimit tim, mësimit duhet të jenë të përgatitur për orën mësimore, sepse kur ata janë më të përgatitur rritet interesimi i nxënësve për orën mësimore”.

“Të largohen fjalët ofenduese, banale. Të mbajmë orë shtesë. Disiplina në orë etj”.

“Unë kisha kërkuar nga prindërit që për fëmijët e tyre të interesohen më shumë për nga sjellja dhe mësimet, gjithashtu edhe për ata që janë me aftësi të kufizuara”.

“Unë mendoj që shkolla me anë të reklamave, peticioneve të ndryshme mund të ndihmojë më shumë për integrimin e nxënësve në shkollë, gjithashtu mendoj që edhe përkrahja e mësimit dhe e prindërve është e domosdoshme për rezultate më të mira në mësim”.



5. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

Ky kapitull paraqet konkluzione të shkurtra dhe ofron rekomandime të grupuara në tematika të studimit.

5.1. Përkufizimet, rregulloret dhe mekanizmat e ndërhyrjes

Konkluzione

Në infrastrukturën ligjore, dokumentet dhe politikat arsimore në Kosovë nuk përmendet në mënyrë specifike përkufizimi për fëmijët jashtë shkolle. Përkufizimi për braktisjen e shkollës në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011) është i pjesshëm, mirëpo në udhëzimin administrativ (nr.7/2012) Krijimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar është dhënë një përkufizim më gjithëpërfshirës, brenda të cilit identifikohen tri lloje të braktisjes së shkollës me referime përkatëse. Përkufizimi i parë i braktisjes referon ndërprerjen e shkollimit në arsimin e obliguar, përkufizimi i dytë referon ndërprerjen e shkollimit në mesëm të lartë, kurse përkufizimi i tretë referon të gjithë fëmijët që nuk janë regjistruar në shkollë dhe nuk kanë ndjekur arsimin e obliguar me ligj.

Në rregulloret e shkollave nuk ka një përkufizim të qartë të mungesave të arsyeshme dhe të paarsyeshme, si dhe nuk ka portokoll të qartë të menaxhimit të mungesave.

Niveli komunal i arsimit dhe shkollat nuk kanë ndërtuar mekanizma efektivë të ndërhyrjes dhe të llogaridhënies për të monitoruar, për të informuar, për të raportuar për fëmijët jashtë shkolle, për të parandaluar mungesat e nxënësve, braktisjen e shkollës, incidentet diskriminuese.

Rekomandime

- (I) *MASHT-i në legjislacion dhe në kornizën e politikave arsimore të përfshijë termin fëmijë jashtë shkollës dhe të harmonizojë atë dhe përkufizimin e braktisjes së shkollës me përkufizimet e institucionet arsimore ndërkombëtare. Fëmijët jashtë shkolle duhet të përcaktohen në mënyrë adekuate për t'i identifikuar saktë dhe për të siguruar mbledhjen e informacioneve të duhura.*
- (II) *DKA-të dhe Qendra për Punë Sociale duhet të përfshijnë në planin e tyre detyrat, përgjegjësit dhe aktivitetet për identifikimin dhe referimin e fëmijëve të moshës shkollore, të cilët nuk janë të regjistruar në shkollë, të cilët e kanë braktisur shkollën apo që janë në rrezik të lartë për ta braktisur shkollën dhe, varësisht prej rasteve, edhe menaxhimin e tyre.*
- (III) *Rregulloret rreth mungesave në shkollë duhet të plotësohen, veçanërisht në përcaktimin e mungesave të arsyeshme dhe të paarsyeshme dhe protokollit të menaxhimit të mungesave. Rregulloret e shkollave duhet të përfshijnë edhe procedurat e informimit rreth menaxhimit të mungesave.*
- (IV) *Shkollat duhet t'i regjistrojnë saktë mungesat dhe mungesat duhet të përfshihen në sistemin e SMIA-s dhe të analizohen rregullisht në çdo komunë dhe të botohen në nivel kombëtar në buletin e statistikave vjetore të arsimit.*

- (V) Komunat të hartojnë mekanizma efektivë të evidencimit, monitorimit, raportimit, ndërhyrjes dhe të llogaridhënies për identifikimin, referimin dhe për menaxhimin e rasteve të fëmijëve jashtë shkolle, për të parandaluar mungesat e nxënësve, braktisjen e shkollës dhe incidentet diskriminuese.
- (VI) Njësia SMIA në MASHT duhet të sigurojë instrumente të sakta për shkolla dhe DKA për regjistrimin e fëmijëve braktisës – bazuar në definicionin e qartë të braktisjes që nuk përfshijnë fëmijët që migrojnë dhe lëvizin në shkolla të tjera.
- (VII) Shkollat duhet të krijojnë mekanizma për identifikimin e fëmijëve në rrezik për ta braktisur shkollën, me qëllim të zbatimit të ndërhyrjeve të parakohshme të parandalimit të braktisjes. Shkolla duhet t'u kushtojë vëmendje të veçantë braktisjes, mungesave, performancës së ulët akademike, sjelljeve jo të mira dhe rrethanave personale dhe familjare.

5.2. Përfshirja e fëmijëve në edukimin parafillor

Konkluzione

Trendi i përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor (grup moshë 5-6 vjeç) për çdo vit shënon një rritje relativisht të vogël. Në 10 vitet e fundit mesatarja e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor (5-6 vjeç) është rritur 2.5% në vit shkollor. Edhe pse me Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Kosovë (2011), edukimi parafillor bëhet i detyrueshëm në vitin shkollor 2015/2016 (nëse krijohen kushtet financiare), niveli komunal i arsimit nuk ka hartuar plane të veprimit për të jetësuar këtë dispozitë ligjore.

Rekomandime

- (i) Komunat duhet të hartojnë plane specifike me aktivitete konkrete për përfshirjen e të gjithë fëmijëve në edukimin parafillor.

5.3. Regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë

Konkluzione

Shkollat kanë zonën e vet të mbulimit, të cilën e përcakton komuna dhe të gjithë fëmijët që kanë arritur moshën 6 vjeç dhe që banojnë në atë zonë kanë të drejtë të regjistrohen dhe të ndjekin shkollën e nivelit përkatës, mirëpo as zyra e regjistrimit civil dhe as nga DKA-ja nuk i dërgon në shkolla listat e fëmijëve të zonës që janë në moshë për t'u regjistruar në klasën e parë.

Përgatitja e regjistrave për regjistrim në klasën e parë bëhet kryesisht nga vetë shkollat: disa i plotësojnë ato nga klasa parafillore për fëmijët që e vijnë edukimin parafillor dhe nga prindërit që i sjellin të dhënat për regjistrimin e fëmijëve.

Shkollat raportojnë se nuk kanë instrumente të standardizuara për vlerësimin e pjekurisë së fëmijëve për të regjistruar klasën e parë dhe për të matur paranjohuritë e tyre. Vështirësitë më të mëdha në këtë drejtim i kanë shkollat që nuk kanë pedagog dhe psikolog për të bërë diagnostifikimin e fëmijë.

Shkollat ku janë të përfshirë fëmijët e komuniteteve RAE raportojnë për vonesa të fëmijëve në regjistrimin dhe vijimin e klasës së parë. Mësimdhënësit bëjnë me dije se kanë problem në menaxhimin e sjelljeve të fëmijëve që dallojnë në moshë 3-4 vjet, përkundrajt shumicës së fëmijëve që janë 6-vjeçarë.

Rekomandime

- (i) Zyrat e regjistrimit civil në nivel komunal të kontribuojnë në kërkesat e DKA-së dhe të shkollave në dërgimin me kohë të listës së fëmijëve që janë në moshë për t'u regjistruar në klasën e parë. DKA-të duhet të adresojnë me kohë kërkesën në zyrat e regjistrimit civil për të marrë listën e nxënësve që kanë arritur moshën për t'u regjistruar në klasën e parë.

- (ii) DKA-të dhe shkollat të marrin përgjegjësinë për ngritjen e komisioneve (pedagog, psikolog, mësues të mësimdhënës me përvojë) për 3-4 shkolla që kanë afërsi fizike dhe kontekst të përafërt, për hartimin dhe zbatimin e instrumenteve për vlerësimin e pjekurisë së fëmijëve për të regjistruar klasën e parë dhe për të matur paranojësitë e tyre.
- (iii) DKA-të dhe shkollat të sigurojnë përkrahje për integrim të fëmijëve që janë regjistruar me vonesë në shkollë. Të shikohet mundësia e vendosjes në klasë të fëmijëve që kanë moshë të njëjtë.
- (iv) Mësuesdhënësit që punojnë me fëmijët që regjistrohen me vonesë të përkrahen me udhëzues profesionalë, mentorim dhe mekanizma lehtësues për nxenie dhe përkrahje për të siguruar rezultate me këtë grup të fëmijëve.

5.4. Të dhënat për braktisjen e shkollës dhe mundësitë e identifikimit të fëmijëve jashtë shkolle

Konkluzione

Nuk ka një sistem të qëndrueshëm dhe të harmonizuar të mbledhjes së të dhënave për braktisjen e shkollës dhe për fëmijët jashtë shkolle. Gjithashtu nuk ka një sistem të monitorimit të rasteve të nxënësve që janë në rrezik për të braktisur shkollën.

Programi SMIA shihet si një mundësi e mirë për evidentimin e saktë të fëmijëve që kanë braktisur shkollën. Raportet për braktisjen tregojnë se ekziston një rënie e lehtë e numrit të nxënësve që braktisin shkollën, megjithatë braktisja e shkollës vazhdon të shikohet nga i gjithë komuniteti arsimor si një problem për të cilin duhet punuar shumë për të parandaluar dhe për të reaguar drejt ndaj kësaj dukurie.

Nuk ka sistem për identifikimin dhe mbledhjen e të dhënave për fëmijët të cilët nuk janë regjistruar kurrë në shkollë.

Për përgjegjësit që i mbledhin dhe i raportojnë të dhënat për nxënësit që braktisin shkollën nuk është krijuar ndonjë mekanizëm i llogaridhënies. Aktivitetet e nivelit komunal dhe të nivelit të shkollës nuk janë të harmonizuara për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës.

Raportet për mungesat e nxënësve tregojnë se mesatarja e mungesave për një nxënës është relativisht e lartë, sidomos në shkollat ku janë të përfshirë fëmijët e komuniteteve RAE. Nuk ka një sistem të menaxhimit të mungesave të nxënësve në përgjithësi dhe në veçanti të menaxhimit të rasteve të nxënësve që bëjnë mungesa në shkollë dhe që janë në rrezik për ta braktisur shkollën.

Rekomandime

- (i) Të hartohet një pako e instrumenteve të identifikimit dhe sigurimit të të dhënave për fëmijët jashtë shkolle. Pakoja e instrumenteve të përmbajë udhëzime metodologjike për plotësimin e instrumenteve dhe raportimin e të dhënave.
- (ii) SMIA-ja duhet t'i publikojë të dhënat vjetore për braktisjen e shkollës.
- (iii) Komunat duhet t'i publikojnë të dhënat vjetore për nxënësit që kanë braktisur shkollën dhe për fëmijët të cilët janë jashtë shkollës në zonën e tyre.
- (iv) Shkollat duhet të publikojnë të dhënat vjetore për nxënësit që kanë braktisur shkollën, të ndjekin trendin e braktisjes dhe të jenë konsistentë në angazhimet e tyre për të parandaluar braktisjen.
- (v) Të vazhdojë përmbushja e aktiviteteve të parashikuara në objektivat e Planit kombëtar të veprimit kundër braktisjes së shkollës 2009-2014.

5.5. Ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit (EPRBM)

Konkluzione

EPRBM-të nuk janë formuar në të gjitha komunat dhe në të gjitha shkollat e përfshira në studim. EPRBM-të e themeluara nuk kanë plane të veprimit me aktivitete konkrete se çfarë duhet të bëjnë për të përmbushur misionin e tyre.

Rekomandime

- (I) Të funksionalizohen EPRBM-të në nivel komunal dhe në nivel shkolle, duke përfshirë terma të qartë të referencës dhe ofrimin e trajnimeve dhe përgjegjësive, si dhe mundësitë e intervencimit.
- (II) EPRBM-të në nivel komunal të hartojnë plane të veprimit me aktivitete, duke përfshirë edhe planifikimin e buxhetit për aktivitetet e parandalimit dhe të reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit.
- (III) EPRMB-të në nivel të shkollave duhet të zhvillojnë ndërhyrje për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes, veçanërisht identifikimin e fëmijëve në rrezik për ta braktisur, zbatimin e aktiviteteve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes si monitorimin e mungesave, mbështetje profesionale për fëmijët me vështirësi në të nxënë, mbështetje psiko-sociale për fëmijët me rrethana të vështira dhe të angazhohen në bashkëpunim me familjet dhe prindërit.
- (IV) Të shfrytëzohen të gjitha mundësitë që në shkollat ku shkalla e braktisjes është shumë e lartë të plotësohet shërbimi pedagogjik dhe psikologjik.
- (V) Të hartohen doracakë me udhëzime dhe plane të veprimit për menaxhimin e rasteve të nxënësve që bëjnë mungesa në shkollë dhe që janë në rrezik për të braktisur shkollën.

5.6. Bashkëpunimi ndërsektorial dhe bashkëpunimi me OJQ-të

Konkluzione

Edhe pse bashkëpunimi ndërsektorial, sipas të intervistuarve, është rritur në vitet e fundit, megjithatë disa nga të intervistuarit dhe përfaqësuesit e OJQ-ve kanë identifikuar disa mangësi në bashkëpunimin ndërsektorial, si ajo e identifikimit të fëmijëve që nuk janë regjistruar në shkollë, referimit dhe menaxhimit të rasteve, buxhetit, përkrahjes për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes etj. Kjo situatë është e reflektuar në mungesë të mekanizmave të veçantë për bashkëpunim ndërsektorial për çështje me interes të posaçëm, siç është çështja e fëmijëve që nuk janë regjistruar në shkollë, që kanë braktisur shkollën, apo që janë në rrezik për të braktisur shkollën.

Rekomandime

- (I) Të hartohen mekanizma që forcojnë bashkëpunimin ndërsektorial, marrëveshje mirëkuptimi në mes të institucioneve të nivelit komunal, duke përfshirë edhe OJQ-të që merren me fushën e edukimit për identifikimin, raportimin dhe përkrahjen për adresimin ndërsektorial të fëmijëve jashtë shkolle.

5.7. Gjithëpërfshirja në arsim

Konkluzione

Prioritetet e planeve të zhvillimit të arsimit në nivel komunash nuk janë në harmoni me prioritetin e gjithëpërfshirës të përcaktuar nga MASHT-ti.

Niveli komunal nuk ka ndonjë mekanizëm për mbajtjen e evidencave të incidenteve diskriminuese të nxënësve ndaj nxënësve, apo të mësimit të nxënësve dhe, rrjedhimisht, nuk ka dëshmi se ndaj cilave kategori të fëmijëve është i shprehur më shumë diskriminimi. Edhe në nivel shkolle nuk ka evidenca të rasteve të diskriminimit në shkollë, edhe pse nxënësit ofrojnë dëshmi të incidenteve diskriminuese ndërmjet vetë nxënësve dhe, në raste më të rralla, edhe nga ana e mësimit të nxënësve. Sipas nxënësve të përfshirë në hulumtim, djemtë dhe nxënësit me rezultate më të ulëta në mësim janë më të atakuarit nga incidentet diskriminuese

Tri janë problemet e ngritura nga shumica e pjesëmarrësve të intervistuar, për disa probleme të gjithëpërfshirjes në arsim që nuk janë adresuar në mënyrë të drejtë në nivel komune: (I) çështjen e braktisjes së shkollës, të gjithë e shohin si një problem që nuk kanë arritur ta trajtojnë në mënyrë të duhur; (II) puna me fëmijë me nevoja të veçanta është çështje tjetër për të cilën përfaqësuesit e nivelit komunal shprehin se është një nga problemet që nuk kanë arritur ta adresojnë në mënyrë të kënaqshme (III) regjistrimi dhe përfshirja në shkollim e fëmijëve të komuniteteve RAE vazhdon të jetë një sfidë për të gjitha komunat ku jetojnë këto komunitete. Pavarësisht identifikimit të problemeve të gjithëpërfshirjes, në përgjithësi mungojnë planet e veprimit për përfshirjen në shkollë të grupeve të pafavorizuara.

Plani individual i arsimit (PIA) për fëmijët që kanë nevoja të veçanta në arsim hartohet vetëm nga mësimit të nxënësve të shkollave që kanë klasë të bashkangjitura. Shumica e prindërve nuk kanë marrë pjesë në hartimin e PIA-s dhe nuk e dinë se si punohet me këto plane.

Në shkolla nuk ekzistojnë procedura të cilave u përmbahen të gjithë mësimit të nxënësve për organizimin e mësimit plotësues për nxënësit që kanë munguar për një kohë të gjatë për shkak të sëmundjeve kronike apo lëndimeve të ndryshme, apo procedura për organizimin e modaliteteve të tjera të mësimit, si mësimi shtues, mësimi kompensues dhe mësimi intensiv. Për pasojë, këto forma të mësimit janë fare pak prezente në shkollat e përfshira në studim. Kryesisht në shkolla organizohen aktivitete jashtëmësimore, për të cilat në një numër të madh të shkollave mungojnë planet konkrete të veprimit.

Mundësitë e shkollave janë të limituara për përkrahje të fëmijëve të familjeve të varfra, megjithatë në shkolla vazhdon një traditë e mirë e mbështetjes së fëmijëve të familjeve të varfra me materiale mësimore ose me tarifa lehtësuese për ekskursione dhe aktivitete të tjera në të cilat duhet të participojnë familjet.

Rekomandime

- (I) Planet e të zhvillimit të arsimit në nivel komune dhe shkolle të mbështeten në parimin e gjithëpërfshirjes në arsim dhe të përfshijnë aktivitete e projekte që adresojnë problemet e gjithëpërfshirjes në nivel komune dhe shkolle.
- (II) Të hartohen mekanizma të evidencimit, raportimit, trajtimit dhe menaxhimit të incidenteve diskriminuese. Trajnimi i mësimit të nxënësve, prindërve dhe i udhëheqësve të shkollave do të zvogëlojë incidentet e diskriminimit dhe do të krijojë mjedis më të sigurt për nxënësit.
- (III) Për adresimin e drejtë të fëmijëve me nevoja të veçanta kërkohet që (I) të funksionalizohen ekipet për vlerësimin profesional të fëmijëve me nevoja të veçanta edukativo – arsi-

more; (II) të hartohen instrumentet për vlerësimin profesional të fëmijëve me nevoja të veçanta; (III) të trajnohen mësime dhënësit dhe prindërit për hartimin e planit individual të arsimit (PIA) dhe (IV) mësime dhënësit të trajnohen edhe për menaxhimin e klasës, metodologji dhe qasje të reja për nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë ose për nxënësit që kanë talent të veçantë.

(IV) Mësimi plotësues, mësimi shtues, mësimi kompensues, mësimi intensiv dhe aktivitetet jashtëmësimore janë modalitete të mësimin që ofrohen nga shkollat gjithëpërfshirëse. Për të arritur këtë nivel shkollat duhet të hartojnë procedura për planifikimin dhe organizimin e këtyre modaliteteve të mësimin.

(V) Të zhvillohen dhe të zbatohen procedurat e rritjes së qëndrimit ditor në shkollë të mësime dhënëse dhe nxënëse, sepse kërkesat e nxënëse janë për angazhime shtesë në shkollë - jashtë mësimin të rregullt. Procedurat të jenë në përputhje me kushtet që kanë shkollat, se paku një orë në ditë duhet të jetë e dedikuar për modalitetet e ndryshme të mësimin, si mësim plotësues, mësim shtues, mësim kompensues, mësim intensiv dhe aktivitete jashtëmësimore. Rritja e qëndrimit në shkollë të shkollave që punojnë në dy ndërrime mund të bëhet në bazë të parimit të rotacionit.

(VI) Të sigurohet transporti për fëmijët me aftësi të kufizuara, romë, ashkali, egjiptianë dhe për të gjithë fëmijët e tjerë që banojnë larg shkollës – në distancën që ligji për arsim kërkon sigurimin e transportit për fëmijë.

5.8. Përfshirja e prindërve në shkollë

Konkluzione

Përfshirja e prindërve në shkollë është identifikuar si një nga sfidat kryesore të shkollës. Këtë e argumentojnë edhe vetë prindërit në vlerësimet e tyre. Ata mospërfshirjen e prindërve në shkollë e rendisin në faktorin e tretë që ndikon në rezultatet e punës në shkollë dhe, rrjedhimisht, edhe në rezultatet e nxënëseve.

Mospërfshirja e prindërve në shkollë është e lidhur edhe me mungesën e programeve të shkollave për punë me prindër, me mos përfshirjen e prindërve në aktivitete jashtëmësimore dhe në aktivitete me interes të veçantë për shkollën.

Rekomandime

(I) Të funksionalizohen këshillat e prindërve në nivel shkollë dhe komune dhe të përfshihen prindërit aktivisht në ekipet shkollë që parashohin dispozitat ligjore dhe në ekipet me interes për shkollën dhe fëmijët. Prindërit të përfshihen në reformën shkollë dhe në trajnime në tematika shkollë me interes për ta dhe fëmijët e tyre.

(II) Të organizohen fushata të vetëdijesimit të prindërve për rëndësinë e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollë, regjistrimin me kohë në klasën e parë dhe për vijueshmërinë e rregullt në mësim.

(III) Të hartohen dhe të implementohen programe të trajnimit për prindër në tematika shkollë me interes për ta dhe përkrahjen në mësim të fëmijëve të tyre.

5.9. Mbrojtja sociale

Konkluzione

Edhe pse studimi bazë nuk është përqendruar në profilizimin e detajuar të faktorëve të braktisjes së fëmijëve dhe të fëmijëve që nuk janë regjistruar në shkollë, bazuar në përgjigjet e respondentëve, dëshmitë tregojnë se fëmijët e familjeve të varfra janë veçanërisht në rrezik për ta braktisur shkollimin. Transmetimi ndër gjenerata i mangësive është i njohur në rajon. Në shumë vende krijimi i mekanizmeve për mbrojtje sociale ka qenë pjesë e masave të zbatuara për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes së shkollës.

Rekomandime

- (I) Përforcimi i monitorimit të fëmijëve të varfër dhe i mirëqenies në bazë të zërave të treguesve që mbulojnë një sërë sektorësh, duke përfshirë edhe rezultatet e arsimit.*
- (II) Rishikimi i ndikimit të lëvizjeve shoqërore në qasje në arsim dhe rezultatet e arsimit në Kosovë.*
- (III) Shërbimet sociale të sigurojnë mekanizmat e mbrojtjes sociale për fëmijët, që të jenë të barabartë dhe të efektshëm.*



6. PLANI ORIENTUES PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE

Implementimi i rekomandimeve për adresimin e fëmijëve jashtë shkolle dhe për parandalimin e reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës duhet të zhvillohet në bazë të një plani të përbashkët njëvjeçar në mes të Institutit Pedagogjik të Kosovës, UNICEF-it, komunave dhe shkollave të përfshira në studim. Më poshtë është dhënë një plan orientues për implementimin e rekomandimeve të dala në bazë të gjetjeve të studimit dhe të nevojave të komunave dhe të shkollave për mbështetje, në të cilat pritet të kontribuojë Instituti Pedagogjik i Kosovës me mbështetjen e UNICEF-it. Gjithashtu edhe rekomandimet e tjera duhet të merren parasysh dhe duhet të adresohen së bashku me institucionet e tjera që mbështesin komunat dhe shkollat e përfshira në studim.

6.1. Themelimi dhe funksionalizimi i EPRBM-ve

Themelimi i EPRBM-ve është një detyrim ligjor i dalë nga udhëzimi administrativ me qëllim të parandalimit dhe të reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit. Deri në këtë fazë shumica e shkollave dhe e komunave nuk i kanë themeluar EPRBM-të. Disa komuna dhe shkolla i kanë themeluar ekipet, mirëpo nuk janë funksionalizuar si duhet, kur kemi parasysh misionin që kanë këto ekipe. Për të përkrahur këtë proces, deri në dhjetor të vitit 2014 duhet të realizohen aktivitetet në vijim:

- Të hartohet plani dinamik për themelimin e EPRBM-ve në çdo komunë dhe shkollë.
- Të organizohen trajnime për EPRBM-të komunale dhe shkollore.
- Të hartohen planet e veprimit të EPRBM-ve.
- Të implementohen aktivitetet e planit të veprimit.
- Të sigurohet një platformë për EPRBM-të për të ndarë përvojat dhe mësimet e nxjerra.

6.2. Identifikimi i fëmijëve jashtë shkolle

Në përgjithësi, mungojnë të dhënat për fëmijët jashtë shkolle dhe instrumentet për identifikimin e këtyre fëmijëve.

Për identifikimin e të gjithë fëmijëve që janë jashtë shkolle në komunat e përfshira në studim, deri në dhjetor të vitit 2014 duhet të realizohen aktivitetet në vijim:

- Të hartohen instrumentet për identifikimin, regjistrimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve jashtë shkolle.
- Të organizohen trajnime njëditore në çdo komunë.
- Të administrohen instrumentet për identifikimin e fëmijëve jashtë shkolle.
- Të raportohen rastet e identifikuara.
- Të hartohet dhe të implementohet plani i veprimit për mbështetjen e fëmijëve jashtë shkolle për përfshirje në shkollim.

Paketa e instrumenteve për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe sigurimin e të dhënave për fëmijët jashtë shkolle duhet të përfshijë kategoritë e fëmijëve:

- që kanë mbushur moshën, por nuk janë regjistruar në arsimin parafillor 2013/2014;
- që kanë mbushur moshën për t'u regjistruar në arsimin parafillor 2014/2015;
- që kanë mbushur moshën për t'u regjistruar në arsimin fillor 2014/2015;
- që janë regjistruar me vonesë në arsimin fillor (1-5);
- që janë regjistruar me vonesë në arsimin e mesëm të ulët (6-9);
- që nuk janë regjistruar asnjëherë në shkollë në arsimin fillor (1-5);
- që nuk janë regjistruar asnjëherë në shkollë në arsimin e mesëm të ulët (6-9);
- që kanë braktisur shkollën në arsimin fillor (1-5);
- që kanë braktisur shkollën në arsimin e mesëm të ulët (6-9);
- që janë në rrezik për të braktisur shkollën në arsimin fillor (1-5) dhe
- që janë në rrezik për të braktisur shkollën në arsimin e mesëm të ulët (6-9).

Secilit instrument për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe sigurimin e të dhënave për fëmijët jashtë shkolle duhet t'i bashkëngjitet një udhëzues metodologjik për përdorim, në të cilin duhet të përshkruhet metodologjia e plotësimit dhe e raportimit të të dhënave të grumbulluara.

Paketa e instrumenteve duhet të publikohet në ueb faqet e shkollave dhe të komunave, që të jenë në dispozicion të të gjithë akterëve bashkëpunues të përfshirë në adresimin e fëmijëve jashtë shkolle.

6.3. Mekanizmat e ndërhyrjes për fëmijët jashtë shkolle dhe për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes

Me qëllim që të përmirësohet përfshirja e fëmijëve në shkollë, kërkohet hartimi i disa mekanizmave të ndërhyrjes për fëmijët jashtë shkolle dhe për parandalim e reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit. Mekanizmat duhet të jenë në përputhje me kontekstin e komunës, resurset për implementim dhe në mbështetje me dispozitat ligjore. Për hartimin e mekanizmave të ndërhyrjes të specifikuar në pjesën e rekomandimeve të kapitullit pesë të këtij raporti, deri në muajin dhjetor të vitit 2014 duhet të realizohen aktivitetet në vijim:

- Të zhvillohen mjete shkollore të bazuara në profilin e fëmijëve në rrezik për ta braktisur shkollën.
- Të trajnohen ekipet shkollore për parandalimin e braktisjes dhe ndërhyrjes.
- Të organizohen trajnime njëditore me përfaqësues të komunave për metodologjinë e hartimit të mekanizmave të ndërhyrjes në tematikat e rekomandimeve të studimit.
- Të implementohen mekanizmat e ndërhyrjes.
- Të organizohen takime njëditore me përfaqësues të komunave për rezultatet e zbatimit të mekanizmave të ndërhyrjes.

6.4. Trajnimi i ekipeve shkollore për implementimin e standardeve të shkollave mike për fëmijë

Një nga qëllimet e standardeve të shkollave mike për fëmijë është vetëvlerësimi i performancës së punës së shkollës. Meqë shkollat në Kosovë nuk kanë përvojë në vetëvlerësimin e performancës së punës së shkollës, ato duhet të mbështeten me trajnime dhe udhëzues praktikë. Për këtë rekomandim, deri në dhjetor të vitit 2014 duhet të realizohen aktivitetet në vijim:

- Të finalizohen instrumentet e vetëvlerësimit të shkollës në bazë të treguesve të standardeve të SHMF-së dhe të treguesve për çështjen e braktisjes.
- Të hartohet udhëzuesi i zbatimit të instrumenteve të vetëvlerësimit.

- Të hartohet plani dinamik për trajnimin e ekipeve shkollore.
- Të organizohen trajnime dyditore për ekipet shkollore.
- Të organizohen takime njëditore të mentorimit të shkollave për zbatimin e standardeve të SHMF-së.
- Të administrohen instrumentet e vetëvlerësimit të shkollës.
- Të organizohen punëtori njëditore për prezantimin e rezultateve të vetëvlerësimit të shkollës në bazë të treguesve të standardeve të SHMF-së.
- Të hartohen/rishikohen planet e zhvillimit të shkollave në bazë të rezultateve të vetëvlerësimit të shkollës.

6.5. Regjistrimi i fëmijëve në arsimin parafillor dhe fillor

Aktualisht sipas procedurave të shkollave regjistrimi i fëmijëve në klasën parafillore dhe në klasën e parë bëhet në muajt maj dhe qershor, mirëpo shpeshherë bëhen vonesa në regjistrim dhe regjistrimi zgjat edhe gjatë muajt gusht. Për të qenë efektiv në regjistrimin e fëmijëve sipas planifikimit të shkollave dhe për t'u siguruar se regjistrohen të gjithë fëmijët që kanë arritur moshën e regjistrimit, deri në muajin qershor të vitit 2015 duhet të ndërmerren aktivitetet në vijim:

- Të organizohen takime njëditore me DKA-të dhe zyrat e regjistrimit civil në komuna për diskutimin e modaliteteve të raportimit për fëmijët që kanë mbushur moshën për regjistrimin në klasën parafillore dhe në klasën e parë të arsimit fillor.
- Të hartohen marrëveshjet e mirëkuptimit në mes të partnerëve DKA – zyrë e regjistrimit civil – shkollë për ofrimin nga zyrat e regjistrimit civil të listës së fëmijëve që kanë mbushur moshën për regjistrimin në klasën parafillore dhe në klasën e parë të arsimit fillor.
- Zyrat e regjistrimit civil të hartojnë dhe të dërgojnë listat e fëmijëve që kanë mbushur moshën për regjistrimin në klasën parafillore dhe në klasën e parë të arsimit fillor.
- Shkollat të hartojnë planet e veprimit për regjistrimin e fëmijëve në klasën parafillore dhe klasën e parë 2015/2016.

6.6. Rritja e qëndrimit ditor në shkollë

Kërkesat e nxënësve dhe të prindërve janë që shkolla të organizojë mësim shtues, mësim plotësues, aktivitete jashtëmësimore dhe aktivitete të tjera me interes për fëmijë. Në anën tjetër, drejtuesit e shkollave dhe mësimdhënësit shprehen se nuk kanë hapësirë dhe kohë për të realizuar modalitete të tilla të mësimin dhe të aktiviteteve jashtëmësimore, të cilat nuk duhet të pengojnë procesin e rregullt mësimor, por duhet të jenë në funksion të tij. Për realizimin me sukses të këtyre modaliteteve të mësimin kërkohet që shkollat të kenë procedura të miratimit të këtyre formave të mësimin dhe një plan me aktivitete konkrete. Në disa shkolla këto i gjejmë të shkruara, por në praktikë nuk zbatohen. Me qëllim që planet e tilla të zbatohen në praktikë në mënyrë efektive, rekomandohet që shkollat të rrisin qëndrimin ditor në shkollë për nxënës dhe mësimdhënë. Rritja e qëndrimit ditor në shkollën e cila punon me dy ndërrime mund të bëhet në bazë të parimit të rrotacionit. Për zbatimin e këtij rekomandimi, deri në dhjetor të vitit 2014 duhet të realizohen aktivitetet në vijim:

- Të organizohen takime njëditore me të gjithë akterët e shkollës për të shqyrtuar mundësitë dhe modalitetet e rritjes së qëndrimit ditor në shkollë.
- Të hartohen procedurat e miratimit për zbatim të formave alternative të mësimin dhe të aktiviteteve jashtë mësimore.
- Të hartohen dhe të miratohen planet dhe programet e aktiviteteve jashtëmësimore dhe të mësimin në bazë të nevojave dhe të kërkesave të nxënësve dhe të prindërve të tyre.
- Të hartohet plani i veprimit për shfrytëzimin e hapësirës dhe të kohës për mësim në kohën e rritjes së qëndrimit ditor
- Të monitorohet plani i zbatimit.
- Të përgatitet raporti me rezultatet e arritura dhe rekomandimet për vitin shkollor vijues.



REFERENCAT

Antonowicz, Laetitia. (2013). Out-of-school children in Moldova. UNICEF Moldova with Magenta Consulting.

Berisha, A., Najvirtova, A., Darts, R., Boynik, T. (2012) Raport i studimit themelor: Ofrimi i arsimit për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI Kosova), Prishtinë. http://www.ecmikosovo.org/wp-content/Publications/Reports_and_studies/2012_10_ECMI_Kosovo_Baseline_Study_Delivery_of_Education_to_Roma_Ashkali_and_Egyptian_Communities_in_Fushe_KosoveKosovo_Polje/alb.pdf

Buleshkaj, O. & Mehmeti, S. (2012). Raport mbi vlerësimin e nevojave të drejtorëve të shkollave për ngritje të kapaciteteve në udhëheqje arsimore, EU IPA 2009 projekt, Prishtinë.

Grillo, K. (2002). Fjalor Edukimi (Psikologji – Sociologji – Pedagogji), “Drita 2000”, Prishtinë.

Growing, E. & Saqipi, B. (2010). Raport mbi vlerësimin e nevojave për zhvillim të kapacitetit të Drejtorive Komunale të Arsimit në Kosovë, EU Education SWAP projekt, Prishtinë.

Gundara, J., Peffers, J. (2005). Quality Education for All in Kosovo, UNICEF, Prishtinë. http://www.see-educoop.net/education_in/pdf/Unicef-QualityEducationforAllinKosovofinal.pdf

Hyseni, Halim. (2004). Të drejtat e fëmijëve në sytë e nxënësve kosovarë, Refleksione nga një studim, Qendra për Arsim e Kosovës, Prishtinë

Hyseni, Halim. (2011). Parandalimi i dhunës në shkolla, doracak për krijimin e mjedisëve të sigurt jo të dhunshme e humane në shoqëri dhe në shkolla, UNICEF, botimi i dytë, Prishtinë.

Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) (2008). Drejt Lisbonës – Vlerësimi i nevojave për trajnime profesionale, si dhe i krijimit të mundësive për punësimin e femrave në zonat rurale. *UNICEF – zyra në Kosovë*. http://www.unicef.org/kosovoprogramme/Getting_to_lisbon_-_Shqip.pdf

Instituti RINVEST. (2009). Raport e mbi analizën e braktisjes në arsimin e obliguar dhe arsimit mesëm i lartë në Kosovë

Kastrati, V. (2010). Report on promoting inclusion across all components and activities in the EU Education SWAp project (Part B). http://www.eu.eduswap-ks.org/doc/s_eng/expert's%20reports/Vlera%20Kastrati%20-%20Report%20Annexes.pdf

Komuna e Prishtinës. (2012). Plani Zhvillimor i Arsimit të komunës së Prishtinës 2013-2017, Prishtinë.

Krasniqi, Islam & Zuna, Deva, Afërdita.(2012). Një shkollë pa dhunë (Si ta bëjmë?), Libri shkollor, Prishtinë

Kuvendi i Kosovës. (2004). Ligji kundër diskriminimit, Prishtinë. http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_3_al.pdf

Kuvendi i Kosovës. (2004). Ligji për barazi gjinore, Prishtinë. http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_2_al.pdf

Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Ligji Nr.03/L-068 (2008), Prishtinë. http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L068_al.pdf

Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për arsimin parauniversitar në republikën e Kosovës, Ligji Nr.04/L-032 (2011), Prishtinë.

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20arsimin%20parauniversitar.pdf>

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë & Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2012). Standardet e shkollave mikë për fëmijë, Prishtinë. [http://ipk-](http://ipk-rks.net/publikime_me_shume.php?publikimet_id=41)

[rks.net/publikime_me_shume.php?publikimet_id=41](http://ipk-rks.net/publikime_me_shume.php?publikimet_id=41)

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë & UNICEF., (2004). Regjistrimi dhe braktisja e shkollës nga vajzat në Kosovë, Prishtinë.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2011). Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë. <http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Korniza%20e%20Kurrikules11.pdf>

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2009). Plani Kombëtar i Veprimit kundër braktisjes së shkollës 2009-2014.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2010). Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016, Prishtinë. http://www.masht-gov.net/advCms/documents/PSAK_2011-2016.pdf

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Udhëzimi Administrativ (6/2010) Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta. http://www.masht-gov.net/advCms/documents/6_2010_UA_Kodi_i_miresjelljes_l_11_maj_2010.pdf

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Udhëzimi Administrativ (nr.18/2013): Përdorimi i planit individual të arsimit. http://www.masht-gov.net/advCms/documents/18_2013_UA.pdf

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Udhëzimi Administrativ (nr.19/2012): Themelimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar. http://www.masht-gov.net/advCms/documents/UA_19_2012_new.pdf

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Udhëzimi administrativ Nr. [I] 13/2005: Masat ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar apo nuk vijnë në mësimin e obliguar.

[http://www.masht-](http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Masat_ndaj_prinderve_femijeve_per_mosvijimin_e_mesimit.pdf)

[gov.net/advCms/documents/Masat_ndaj_prinderve_femijeve_per_mosvijimin_e_mesimit.pdf](http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Masat_ndaj_prinderve_femijeve_per_mosvijimin_e_mesimit.pdf)

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.(2007).Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë 2007-2017. [http://www.masht-](http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Strategjia_per_zhvillimin_e_arsimit_parauniversitar_ne_Kosove.pdf)

[gov.net/advCms/documents/Strategjia_per_zhvillimin_e_arsimit_parauniversitar_ne_Kosove.pdf](http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Strategjia_per_zhvillimin_e_arsimit_parauniversitar_ne_Kosove.pdf)

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.(2007).Strategjia për Integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, Komponenta e Edukimit 2007-2017, Prishtinë.

http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Strategjia_Shqip_07017.pdf

Morena, A., Najvirtova, A., Boynik, T., Sefaj, E. (2012). Përmirësimi i ofrimit të arsimit për komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptian:Praktikat më të mira dhe Rekomandimet. Doracak për Zyrtarët Komunal. Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI Kosova), Prishtinë.

http://www.ecmikosovo.org/wp-content/Publications/Hand_book_and_manuals/2012-10_ECMI_Kosovo_Manual_on_Improving_the_Delivery_of_Education_for_Roma_Ashkali_and_Egyptian_Communities_Good_Practices_and_Recommendations/alb.pdf

Najvirtova, A., & Ekipi ECMI Kosova. (2011). Broshurë për mësimdhënësit – Informata dhe këshilla praktike për përmirësimin e shkollimit për nxënësit e komunitetit Rome, Ashkali dhe Egjiptian. Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI Kosova), Prishtinë.

Osmanaj, Egzon. (2013). Raport i hulumtimit për dhunën në shkolla. KIPRED dhe Qendra për arsim e Kosovës, Prishtinë.

http://www.kipred.org/advCms/documents/76620_Egzon_Osmanaj_Dhuna_ne_shkolla_2.pdf

Potera, I., Devetaku, H., Mehmeti, S., Bajrami, L., (2012). Dhuna verbale ndaj nxënësve (hulumtim mbi fyerjen e nxënësve), Instituti Pedagogjik të Kosovës, Prishtinë.

Potera, I., Devetaku, H., Mehmeti, S., Zylfiu, H., Gërguri, B., Bajrami, L. (2011). Braktisja e shkollimit në arsimin e mesëm profesional në Kosovë, Instituti Pedagogjik të Kosovës, Prishtinë.

Planet e zhvillimit të arsimit të komunave të përfshira në studim dhe dokumente e raporte të tjera të lidhura me tematikat e studimit (2011 – 2013) (dokumente dhe raporte të papublikuara).

Qendra për Arsim e Kosovës (2012). Politika për parandalimin e braktisjes së shkollimit, KEC, Prishtinë. http://kec-ks.org/document's/Parandalimi_i_braktisjes.pdf

Reçica, Sahare. (2013). Mbështetja e qendrave burimore për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në shkolla të rregullta, Raport hulumtimi. Instituti Pedagogjik të Kosovës, Prishtinë.

Saqipi, B., Dvorski, M., Mikisko, I., Kokollari, J.B.(2008). Braktisja e shkollës nga nxënësit në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë.

Shërbimi Katolik për Ndhimë, (2005): Doracak – pako strategjish. Të gjithë në shkollë... Parandalimi dhe reagimi ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në shkollë, CRS, Prishtinë.

UNICEF (2005). Raport i hulumtimit mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës. UNICEF – zyra në Kosovë.

UNICEF, 2013, Education Equity Now! A regional analysis of the situation of out of school children in Central and Eastern Europe and the Commonwealth of Independent States, Geneva, UNICEF Regional Office for Central and Eastern Europe and the Commonwealth of Independent States (CEE/CIS). <http://www.unicef.org/ceecis/UNI154796.pdf>

Zuna, Deva, Afërdita.(2008). Dhuna në familje nën thjerrën pedagogjike, Libri shkollor, Prishtinë.

Raportet e SMIA-s pranë MASHT-it për statistikat në arsimin parauniversitar (2004-2013)

http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Raporti%20statistikor_shqip.pdf;

http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Arsimi_i_Kosov%C3%ABs_n%C3%AB_shifra.pdf;

http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Treguesit_e_Arsimit_ne%20Kosov%C3%AB.pdf

Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës: <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AConRightsChild.pdf>

Deklarata e Drejtave të Njeriut: <http://www.un.org/en/documents/udhr/>

Out-of-School Children Initiative: http://www.unicef.org/education/bege_61659.html

Education Equity Now: www.education-equity.org

Planet e zhvillimit të shkollave të përfshira në studim (dokumente të papublikuara).



ANEKSET

Aneks 1: Përmbledhje e Rezultateve sipas Komunave

Komuna: FUSHË KOSOVË

| Nr. | I. Treguesit e arsimit në nivel komnal | Numri apo shkalla e % |
|-----|--|-----------------------|
| 1 | % e fëmijëve të përfshirë në edukimin parafillor 2011/2012 | 20.22% |
| 2 | Numri i nxënësve të regjistruar në klasën e parë 2012/2013 | 633 |
| 3 | Numri i nxënësve të regjistruar në arsimin fillor klasa 1-5 (2012/2013) | 3251 |
| 4 | Numri i nxënësve të regjistruar në arsimin e mesëm të ulët klasa 6-9 (2012/2013) | 2483 |
| 5 | Numri i përgjithshëm i nxënësve që kanë braktisur shkollën në vitin 2011/2012 | 22 |
| 6 | Numri i vajzave që kanë braktisur shkollën | 11 |
| 7 | Numri i përgjithshëm i mungesave /orë mësimi/ | 44256 |
| 8 | Numri i mungesave të arsyeshme /orë mësimi/ | 20174 |
| 9 | Numri i mungesave të paarsyeshme /orë mësimi/ | 64430 |
| 10 | Mesatarja e arritshmërisë në testin e klasës 9 (2011/2012) | 63.10% |
| 11 | Norma e kalimit nga klasa e 9-të në arsimin e mesëm të lartë - klasa e 10-të | 87% |
| 12 | Mesatarja e kalueshmërisë në maturë (2012/2013) | 79.5 |
